

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 393 GUSHT 2023



| KAPTINA EL ASR,
RRUGËT E SHPËTIMIT TË NJERIUT

| A ËSHTË KURANI LIBËR I RREZIKSHËM?

| HIXHRETI, RRUGËTIM
NËN PËRKUJDESJEN HYJNORE



**“Nëse ju nuk e ndihmoni
(Pejgamberin), atë e ka ndihmuar
Allahu: kur ata që nuk besuan e
nxorën atë vetë të dytin; kur që të
dy ishin në shpellë, dhe kur po i
thoshte shokut të vet: “Mos u
pikëlllo (frikëso)! Allahu është me
ne.” E Allahu i zbriti qetësi
(shpirtit të) atij, dhe e fuqizoi me
një ushtri që ju nuk e patë; fjalën
e atyre që nuk besuan e bëri më
të ultën, kurse fjala e Allahut
(është) më e larta. Allahu është
më i Fuqishmi, më i Urti”.**

(Et Tevbeh, 40)

EDITORIAL

- 4 "S'ka shpërngulje pas çlirimit"

FETARE


- 5 Myderriz Fahri efendiu, tërë jetën ia kushtoi misionit për të cilin ishte përgatitur
Myftiu Naim ef. Tërnavë
- 7 Hixhreti, rrugëtim nën përkujdesjen hyjnore
Dr. Ajni Sinani
- 10 Komentimi i sures El-Fet'h (7)
Sabri Bajgora
- 13 Kaptina El-Asr, rrugët e shpëtimit të njeriut
Dr. Valmire Batatina-Krasniqi
- 17 A është Kurani një libër i rrezikshëm?
Enes Kariq
- 20 Kultura e të ushqyerit në Islam
Dr. Selatin Mehani
- 24 Kalimi i Imam Tahaviut (v.321/933) nga medhhebi shafi në medhhebin hanefi
Blerton Bahtiri

FAMILJE & EDUKIM

- 27 Familja e shëndoshë dhe tiparet e saj
Nehat Shehu
- 31 Pse nxënësit e shohin si sfidë studimin e shkencave?
Vaxhide Spahiu

KULTURË

- 34 Një trajtesë modeste mbi veprën "Rilindja e shkencave fetare"
Mulaim Shehu



- 38 Një katalizator semantik
Granit SADIKU

- 41 Vakëfet islame dhe roli i tyre qytetërues
P.D Abdurrahman el-Dahjani

- 44 Rëndësia e Imam Maturidiut dhe maturidizmit për një qytetërim të ri islam (2)
Prof. dr. Hasan Onat

HISTORI & CIVILIZIM

- 47 Shkupi në optikën e një udhëpërshkruesi arab
Mahmud Karut
- 49 Pasqyrë e shkurtër e arkivit (fondit arkivor) të Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë (1984-1997)
MSc. Drin Aliu

PERSONALITETE


- 52 Jeta dhe kontributi i mulla Qamil Mehmetit
Miran Mehmeti
- 54 Në kujtim të mualimit tim, Hafëz Maksut ef. Spahiut (1910-1989)
Faik Miftari

REPORTAZH

- 56 Të veshur me ihram
Bajram Zeqiri

AKTIVITETE

- 59 Myftiu Tërnavë priti në takim ambasadorin e Francës, z. Olivier Guérot



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 393 • viti 37 • gusht 2023
• Muharrem 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.

Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Europrint", Prishtinë

“S’ka shpërngulje pas çlirimit”



“S’ka hixhret (dalje dhe emigrim nga Meka), pas çlirimit...”

(Hadith)

Hixhreti-shpërngulja e Muhamedit a.s. nga Meka në Medinë, mbeti ngjarja që bëri kthesën më të madhe në historinë e lavdishme të Islamit. Jo rastësisht, ajo do të shënonte edhe fillimin e kalendarit të ri lunar islam. Aty po bëhej dhe prej aty po fillonte historia. Historia e triumfit dhe e përhapjes së fesë së Zotit. Ajo shpërngulje nuk përbënte vullnet e as lakmi për të Dërguarin tonë. Ishte fati tragjik i një njeriu të dëlirë që flijonte rehatinë e tij për ideale sublime.

Hixhreti, ishte vepër dhe mjet, por jo qëllim në vete. Vetëm duke u shpërngulur, ata pak pasues të Islamit me në krye, të Dërguarin e Zotit, do të arrinin të shpëtonin vetë, si dhe do ta ruanin fenë e Zotit, pa u venitur në thepinat e egra të Mekës së shenjtë. Mirëpo, ai edhe pse u dëbua tinëzisht e padrejtësisht, u kthye pas pak viteve ballëhapur e triumfues.

Mbas kthimit të të Dërguarit të Allahut si triumfues në Mekë, dhe amnestimit të atyre që e nxorën pafajsisht nga Meka e bekuar, ai e anuloi edhe mundësinë e shpërnguljes nga Meka. Që ditën që hyri në Mekë proklamoi: “S’ka hixhret (dalje dhe emigrim nga Meka), pas çlirimit...” Hixhreti që dikur konsiderohej vepra dhe sakrifica më madhore që besimtarët do të mund ta bënin për Islamin para tetë viteve (sepse çlirimi i Mekës ndodhi 8 vite pas hixhretit – daljes prej saj), tanimë u anulua. Hatabiu, si një kolos i komentit të haditheve, duke bërë përpjekje për ta shkoqitur kuptimin e këtij hadithi tha: “Hixhreti-shpërngulja prej Mekës në Medinë ishte farz në fillim të Islamit, për secilin njeri që kishte pranuar Islamin, për shkak të numrit të paktë të besimtarëve në Medinë dhe nevojës së tyre për grumbullim. E kur Zoti, mundësoi çlirimin e Mekës, dhe njerëzit hynin në fenë e Allahut grupe-grupe, u anulua obligueshmëria e shpërnguljes për në Medinë...”.

A thua, një fjalë e bekuar profetike “S’ka shpërngulje pas çlirimit”, e thënë para 14-të shekujve nga udhëzuesi i njerëzimit, a na thotë diç ne shqiptarëve të këtij nënqielli sot?

Arsye për shpërngulje të pjesshme të popullit tonë, para çlirimit nga kthetrat e okupatorit edhe kemi pasur. Një pjesë e jona ishim të përndjekur e të kërcënuar me likuidim, dhe arratisja për shumëkënd prej nesh ishte dera e vetme e shpëtimit. Ne u shpërngulëm e u larguam nga atdheu, aq sa nuk rrezikuam strukturën etnike e demografike të trojeve tona etnike. Ne u larguam, por edhe qëndruam, prandaj mbijetuam.

Dëbimi ynë që i projektuar. Vasa Çubriloviq, akademiku famëkeq serb (1898-1990), thoshte se pasi që “ndjekja e shqiptarëve me kolonizimin tonë gradual është jo efikase, mbetet që shpërngulja e tyre të jetë sa më masive”. Ai nuk qe vetëm dhe projektet e tilla sidomos gjatë shekullit të kaluar jobefasisht u përsëritën. Ata e dëshironin masivizimin e përndjekjes e dëbimit tonë, dhe ëndërronin këtë truall tonin, të boshatisur nga ne. Projektet e tilla, falë Zotit, kanë dështuar, mbase nga mendjet e shkollarëve të këtyre ideve, nuk janë larguar e as nuk ka vdekur kurrë.

E po, meqë projektet për dëbimin tonë me dhunë, tashmë janë pjesë e historisë, megjithatë ato të ikjes në paqe e liri prej atdheut tonë të çliruar janë fakt e aktualitet. Arratisja, rëndom ka qenë dhe mbetet fati i të shtypurve. Por, ne s’jemi të tillë, tash e një çerek shekulli.

Nëse dikur, të shtypur e nën okupim, ditëm dhe arritëm që t’i zmbropsim projektet e armikut për boshatisje të atdheut, atëherë edhe sot duhet të dimë që të shmangim mallkimin e brezave të ardhshëm për arratisje grupe nga atdheu. Slogani “s’ka shpërngulje e s’ka arratisje pas çlirimit” është thënë dikur, dhe sigurisht në rrethana të tjera nga Dërguari i Allahut – paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, porse ai edhe sot do të ishte motoja më e bukur që do të përvijonte projektin për ndaljen e valës së trishtë të shpërnguljes sonë drejt vendeve të tjera në kërkim të një jetese më të mirë e kushteve më komode për jetë. A thua kur do ta jetësojmë këtë moto!?

Mr. Driton Arifi

*Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnavë në Tryezën shkencore "Hfz. Fahri ef. Iljazi (1903 -1985)
– alim dhe udhëheqës i shquar i Bashkësisë Islame të Kosovës", të organizuar nga IHSI, Prishtinë, më 8 qershor 2023.*

Myderriz Fahri efendiu, tërë jetën ia kushtoi misionit për të cilin ishte përgatitur

*E nderuar familje Iljazi,
Të nderuar udhëheqës e drejtues të BIK-ut,
Mysafirë të çmuar,
Studiues e pedagogë,
Të nderuar të pranishëm!*

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot jam i pranishëm në këtë Tryezë shkencore, të organizuar për të vlerësuar jetën, veprën dhe kontributin e njërit prej personaliteteve, myderrizëve, myftinjve e alimëve më të shquar të Bashkësisë Islame në shekullin e kaluar – hafëz Fahri efendi Iljazit.

Përgëzoj nismën e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame që në objektivat e tij të punës ka vënë si primare ndriçimin e kontributit të ulemave tanë të mëhershëm, ndër ta edhe për myderrizin dhe alimin tonë të shquar, hafëz Fahri efendi Iljazin. Prandaj, një nismë të tillë nuk kemi se si të mos e mbështesim dhe ta përkrahim pa asnjë hezitim, sepse ky është misioni dhe detyra e Institutit tonë, por edhe obligim yni në përgjithësi.

Është detyrë dhe obligim yni që të njohim pararendësit tanë dhe t'u shprehim mirënjohjen më të thellë, sepse ata në kohë e ditë të vështira e me shumë sfida e pengesa, arritën që me përkushtim, urtësi, këmbëngulje e vizion të qartë të udhëhiqnin Bashkësinë Islame, të themelonin e të organizonin institucionet e saj dhe t'i vinin në funksion për të mbajtur gjallë dhe për të zhvilluar jetën fetare islame e arsimore në vendin tonë.

Në mesin e kësaj plejade të ulemasë sonë, pa dyshim se meritueshëm zënë vend edhe hafëz Fahri efendi Iljazi, për të cilin sot jemi tubuar këtu në këtë Tryezë shkencore.

Të nderuar të pranishëm,

Myderriz Fahri efendiu, - megjithëqë jetoi e veproi në kohë të vështira, ku ndërrimet e sistemeve shoqërore e ideologjike ishin të shpeshta dhe në të shumtën e rasteve edhe të dëmshme e me pasoja për ne si popull, dhe të cilat nuk ishin aspak dashamirëse për besimet në përgjithësi, e besimin islam në veçanti, - ai falë edukimit të mirë e të drejt që kishte marrë që nga familja disa breza hoxhallarësh dhe i kalitur e





formuar nga qarku i ulemasë së Gjakovës, tërë jetën ia kushtoi misionit për të cilin ishte përgatitur, për din e iman, për fe dhe për të mirën e shoqërisë dhe të vendit, gjithnjë mbi parimet dhe mësimet e Kuranit fisnik, të cilin e kishte mësuar përmendsh që në rininë e tij, tek i ati i tij muhafizi e myderrizi i njohur Iljaz efendiu, tek i cili edhe i nisi edhe studimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, për t'i përfunduar me ixhazet në medresenë e njohur "Mehmet Pasha" të Prizrenit para myderrizit, myftiut e dijetarit hafëz Nysret efendi Galibit.

Pas mbarimit të studimeve në medrese, Fahri efendiu, emërohet myderriz kryesor dhe drejtues i Medresesë së Madhe të Gjakovës, nga ku edhe më pastaj filloi rrugëtimi dhe angazhimi i tij në detyra të ndryshme udhëheqëse e organizative në institucionet e Bashkësisë Islame, qoftë në kuadër të Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, nga i cili emërohet Myfti i Gjakovës, apo qoftë pas Luftës së Dytë Botërore, ku e gjejmë në strukturat e forumet e Bashkësisë Islame, që nga Këshilli i Gjakovës, Myftinia e Dukagjinit, Kryesia e Bashkësisë Islame, e deri te forumet qendrore të Bashkësisë Islame në ish-Jugosllavi.

Myderriz Fahri efendiu në të gjitha detyrat, emërimet e angazhimet që iu besuan, tregoi profesionalizëm, përgatitje e përkushtim të veçantë, dhe kjo dëshmohet me besimin e fituar të kolegëve dhe respektin e besimtarëve në mbarë vendin tonë dhe më gjerë.

Aktivitetin e tij prej udhëheqësi e drejtuesi të Bashkësisë Islame të Kosovës, myderriz Fahri efendi Iljazit, me përjashtim të periudhës kur ishte myfti i Gjakovës në kuadër të Komunitetit Mysliman Shqiptar, e ka zhvilluar gjatë sistemit monist, pra në një periudhë mjaft të ndjeshme e delikate për misionin e hoxhës. Prandaj, puna dhe vepra e ulemave tanë që jetuan e vepruan në këtë periudhë, pra edhe Fahri efendiu, meriton vlerësim, respekt e mirënjohje të veçantë, aq më parë kur ata morën përsipër jo vetëm zhvillimin e jetës fetare

islame, por se edhe konsoliduan, organizuan e themeluan edhe institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës në kuadër të rrethanave dhe kushteve të krijuara në ato kohë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Meqenëse në këtë Tryezë shkencore kemi edhe studiuesit pjesëmarrës me kumtesa, atëherë dhe fjala kryesore u takon atyre për të shpalosur dhe për të dhënë vlerësime më meritore për jetën dhe veprën e hafëz Fahri efendi Iljazit, por, mua më lejoni t'i rikonstrtoj edhe dy-tri gjëra. Organizimi i kësaj Tryeze shkencore për myderriz Fahri efendi Iljazin, edhe njëherë dëshmon vendosmërinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, për të vazhduar traditën e saj të nisur vitet e fundit për ndriçimin e asaj plejade të tërë të ulemave që u shquan ndër vite e dekada për punën e tyre vetëmohuese e këmbëngulëse për të mirën e njerëzimit, të fesë dhe të atdheut tonë.

Kjo Tryezë shkencore, po ashtu dëshmon përmbushjen e premtimit të dhënë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës se vargut të sesioneve e tryezave shkencore të mbajtura për myderrizët: Haxhi Sherif ef. Ahmetin (2010), Hasan ef. Nahin (2012), Sadri ef. Prestreshin (2013) dhe Bajram ef. Aganin (2014), botimit të përmbledhjeve për ta, do t'u bashkohen edhe sesione, tryeza e konferenca edhe për ulema të tjerë të shquar të Kosovës dhe se jeta, veprimtaria dhe kontributi i tyre i gjithmbarshëm e shumëdimensional do të jenë pjesë e interesimeve tona dhe të studiuesve tanë, sepse ata vërtet meritojnë më shumë se kaq dhe se ata prora do të kenë vëmendjen dhe vlerësimin tonë maksimal.

Në fund, edhe një herë përgëzoj Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame për organizimin e kësaj Tryeze shkencore dhe mirënjohje e falënderim gjithë dashamirësve dhe kontribuuesve për ndriçimin dhe vlerësimin e jetës dhe veprës së hafëz Fahri efendi Iljazit, për shpirtin fisnik të të cilit, ju lus të këndojmë bashkërisht një "Fatiha"!

Ju faleminderit dhe punë të mbarë!

Hixhreti, rrugëtim nën përkujdesjen hyjnore

Dr. Ajni Sinani

Mushrikët në Mekë nuk arritën ta ndalonin Pejgamberin, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe thirrjen e tij në fenë që ai solli. Ata e panë veten të dështuar në të gjitha përpjekjet e tyre, pasi mjetet e frikësimit dhe të joshjes nuk funksionuan dhe metodat e tyre të dëmtimit dhe torturës dështuan.¹

Idhujtarët ushtruan dhunë të paparë ndaj myslimanëve në Mekë. Muhamedi a.s. i këshillonte besimtarët të jenë durimtarë ndaj keqtrajtimeve. Mushrikët kur panë se rreth Pejgamberit a.s. janë tubuar edhe njerëz të tjerë, jo vetëm nga vendi i tyre dhe kur panë se shokët e tij po shpërnguleshin, e kuptuan se ata kishin gjetur vendqëndrim dhe mbrojtje të sigurt. Ata

filluan ta vëzhgonin Pejgamberin a.s. dhe shpërnguljen e tij eventuale.²

Tirania e idhujtarëve arriti kulmin kur ata hartuan planin për të vrarë të Dërguarin e Zotit. Ata shqyrtuan planin për atentat, duke qenë të vendosur të realizonin atë që kishin planifikuar.³

Kur armiqtë e humbën shpresën për ta ndërprerë thirrjen, në fund deshën të eliminojnë protagonistin kryesor të kësaj thirrjeje, ngaqë mendonin se, duke e vrarë atë, do t'i jepnin fund thirrjes. Kështu veprojnë arrogantët dhe ata që e përbuzin virtytin.⁴

Prandaj, kurejshitët ishin mbledhur në shtëpinë “Darun-Nedve”, që ishte shtëpia e Kusaj ibën Kulabit, në të cilën kurejshët

Tirania e idhujtarëve arriti kulmin kur ata hartuan planin për të vrarë të Dërguarin e Zotit. Ata shqyrtuan planin për atentat, duke qenë të vendosur të realizonin atë që kishin planifikuar.



merrnin të gjitha vendimet e rëndësishme. Ata do të konsultoheshin se çfarë do të bënin me Muhamedin a.s.. Njëri propozoi ta mbyllnin e ta pengonin Pejgamberin a.s. që të kishte kontakt me njerëzit, tjetri propozoi ta dëbonin diku larg, ndërsa Ebu Xhehli tha: “Konsideroj se duhet të zgjedhim nga një të ri të fuqishëm prej çdo fisi që të na përfaqësojë, të cilëve do t’u japim nga një shpatë vdekjeprurëse, që të shkojnë ta vrasin. Nëse veprojmë kështu, gjaku i tij do të shpërndahet në të gjitha fiset dhe Benu Menafët nuk do të mund të hakmerren ndaj të gjithëve.”⁵

Vendimi që u arrit, ishte pikëpamja e propozuar nga Ebu Xhehli. Shtëpinë e Pejgamberit a.s. e rrethuan një grup atentatorësh që vinin nga të gjitha fiset, në mënyrë që në aktin e vrasjes së tij të jenë pjesëmarrës të gjitha fiset.⁶ Në këtë mënyrë, Benu Hashimët nuk do të ishin në gjendje të hakmerreshin ndaj kurejshëve për gjakun e tij të ndershëm, meqë të gjitha fiset do të ishin të implikuara dhe nëse do të kërkonin para gjaku atëherë kjo do të paguhej.⁷

Por planet e tyre u mposhtën nga ajo që planifikoi Allahu i Madhërishëm për të Dërguarin e Tij. Me urdhrin e Zotit, Muhamedit a.s. i vjen Xhibrili, i cili thotë të mos flinte në shtratin e tij dhe atij i jepet leja për shpërngulje. Këtë mirësi, Zoti ia rikujtoi Muhamedit a.s. pasi kishte shkuar në Medinë: “Kujto kur mohuesit komplotonin kundër teje:

Planet e tyre u
mposhtën nga
ajo që
planifikoi
Allahu i
Madhërishëm
për të
Dërguarin e
Tij. Me
urdhrin e
Zotit,
Muhamedit
a.s. i vjen
Xhibrili, i cili
thotë të mos
flinte në
shtratin e tij
dhe atij i jepet
leja për
shpërngulje.

për të të burgosur, vrarë ose dëbuar. Ata bënin kurthe, por edhe Allahu ngrinte kurthe (kundër tyre). Allahu është planifikuesi më i mirë”. (El Enfal, 30); “Po nëse refuzojnë, ta dini se Allahu është Mbrojtës i juaji. E sa Mbikëqyrës e Ndhmës i mirë është Ai.” (El Enfal, 40).

Atë natë kur Pejgamberi a.s. do të bënte hixhret nga Meka për në Medinë, politeistët kishin rrethuar shtëpinë e tij për t’i bërë atentat. Por Pejgamberi a.s., dorëzimi dhe nënshtrimi i të cilit ndaj Zotit ishte i pafundmë, nuk tregoi asnjë shenjë shqetësimi e lëkundjeje. Pejgamberi, pasi e vuri hazreti Aliun në shtratin e tij, doli nga shtëpia dhe me duart e bekuara mori një grusht dhe, e hodhi në drejtim të politeistëve dhe kaloi lirshëm mes tyre⁸ duke kënduar nga surja Ja Sin: “Ne iu kemi varur në qafat e tyre pranga e ato iu arrijnë deri në nofulla, prandaj ata mbesin me kokat lart. Ne iu kemi vënë edhe para tyre pengesë, edhe mbrapa tyre pengesë, dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin.” (Ja Sin, 8-9).

Ata nuk shihnin sepse verbëria e zemrave ua kishte verbëruar sytë! Kurse ai që po kalonte mes tyre, ishte Krenaria e Gjithësisë, Zotëria i Botëve, Drita e Qenies a.s.. Natyrisht që ishte e pamundur që zemrat dhe sytë e verbër të idhujtarëve ta shihnin Dritën!⁹





Dikush u afrua te politeistët dhe i pyeti: “Çfarë po prisni ju këtu?” Ata thanë: “Muhamedin!” Ai tha: “Allahu jua shkatërroftë shpresat! Vallahi, Muhamedi ka dalë, madje secilit prej jush ju ka hedhur dhe mbi kokë dhe ka shkuar!” Kur politeistët fërkuan kokat me duar, panë se i kishin kokat tërë dhe.¹⁰

Kur shikuan brenda, panë se dikush po flinte në shtratin e Pejgamberit a.s.. “Ja, Muhamedi është mbuluar e po fle!” - thanë ata. Ecën drejt shtratit, por personi i shtrirë nuk ishte i Dërguari i Allahut, por Aliu r.a.! Idhujtarët kurejshë të zemëruar i bërtitën Aliut r.a.: “Ku është biri i tët ungji, o Ali?” Aliu r.a. u tha: “Nuk e di dhe as që kam ide për këtë! Pastaj, unë s’jam vëzhguesi i tij! Ju i thatë të dilte nga Meka e të largohej! I thatë: “Largohu prej nesh!” Politeistët e shanë dhe e goditën hz. Aliun, madje e çuan në Qabe dhe, pasi e mbyllën për një farë kohe atje, e lëshuan.¹¹

Prej mrekullive më të mëdha në tregimin mbi emigrimin e Pejgamberit a.s. është moment i daljes së tij nga shtëpia, ndërkohë që mushrikët e kishin rrethuar dhe e pritnin për ta likuiduar.¹²

Allahu i Madhërishëm e shpëtoi duke i mundësuar Muhamedit a.s. të kalojë pranë vrasësve pa u vërejtur fare prej tyre, edhe pse syhapur. Zoti bëri që sytë e tyre të mos e shohin

atë dhe për largimin e tij kuptuan në agimin e mëngjesit të ardhshëm.¹³

Ishte e mundur që i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, të dilte para se të vinin politeistët, por kjo që ndodhi ishte për të vërtetuar se e gjithë çështja është në dorën e Zotit të Madhëruar dhe se pa suksesin e Zotit të Madhëruar, asnjë çështje nuk do të përfundojë dhe mrekullia e dukshme u shfaq në fitoren e Zotit për të Dërguarin e Tij, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.¹⁴

Kulminacion i nënçmimit të tyre, pas gjithë asaj që e kishin planifikuar si komplot për jetën e Pejgamberit a.s., ishte momenti kur kokat e tyre ishin mbushur me rërë, të cilën e kishte hedhur i Dërguari a.s. mbi ta, kur doli krejt afër tyre, duke e lexuar fjalën e Allahut xh.sh.: “*Ne u kemi vënë edhe para tyre pendë edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin.*” (Ja Sin, 9).

Pejgamberi a.s. vazhdoi udhëtimin e tij së bashku me Ebu Bekrin për në Jethrib (Medine). Kjo mrekulli ishte një lloj apeli për ata mushrikë dhe të tjerë të çdo epoke dhe kohe. Ajo të cilën e ka përjetuar i Dërguari dhe shokët e tij prej persekutimeve dhe mundimeve të ndryshme për një periudhë kohore, edhe atë për hir të fesë së tij, nuk nënkupton faktin se Allahu i ka braktisur ata dhe se fitorja është e paarritshme.¹⁵

A do të dilte Muhamedi a.s. pa asnjë shenjë shqetësimi, duke lexuar me aq siguri ajetet kuranore, sikur vërtet të mos ishte i Dërguari i Allahut?!

1 Mawmura Quraysh l'قتل النبي قبل الهجرة النبوية <https://www.islamweb.net/ar/> Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan ISM Shkup 2013, f. 175.

4 Dr. Mustafa Sibai, Profeti Muhamed - Vlera dhe urtësi, SHB Nektari, Tiranë, 2005, f. 78.

5 Biografia e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve selem, op. cit. f. 129.

6 Ebu Zehra, op. cit. f. 175.

7 Muhamed Gazali, Fikhu Sira, analizë e jetës së Profetit a.s., Furkan ISM, Shkup 2011, f. 197.

8 Kadir Misirogllu, Botëkuptimi Islam, f. 442.

9 Ibni Hisham, II, 96; Ahmed, I, 348; Jakubi, II, 39, sipas Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 407.

10 Biografia e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve selem, op. cit. f. 130.

11 Ibni Hisham, II, 96; Ahmed, I, 348; Jakubi, II, 39, sipas Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 407.

12 Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, Fikhu Sire, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit alejhi selam, Shkup, 2018, f. 189.

13 Ebu Zehra, op. cit. f. 175.

14 Shih: حصار المشركين لبيت الرسول صلى الله عليه وسلم ليلة الهجرة وخروجه من بينهم سالمًا <https://al-maktaba.org/book>

15 Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op cit., f. 189.

Komentimi i sures El-Fet'h (7)

SHPËRBLIMI I ATYRE QË U BESATUAN NË BEJ'ATU RIDVAN

Sabri Bajgora

لَقَدْ رَضِيَ اللَّهُ عَنِ الْمُؤْمِنِينَ إِذْ يُبَايِعُونَكَ تَحْتَ الشَّجَرَةِ فَعَلِمَ مَا فِي قُلُوبِهِمْ فَأَنْزَلَ السَّكِينَةَ عَلَيْهِمْ وَأَثَابَهُمْ فَتْحًا قَرِيبًا ﴿١٨﴾ وَمَعَائِمٌ كَثِيرَةً يَأْخُذُونَهَا ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿١٩﴾

“Vërtet Allahu qe i kënaqur me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën. Ai e dinte mirë se çfarë kishin në zemrat e tyre, prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt (çlirimin e Hajberit). Edhe me pre të tjera (luftë) të mëdha që do t'i fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” - (El-Fet'h, 18-19).

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, Allahu xh.sh. na tregoi për grupin e beduinëve arabë, që nuk iu bashkuan të Dërguarit a.s. në umren e Hudejbijes, duke gjetur arsye time banale për mospjesëmarrjen e tyre. Por i Madhërishmi ua qet në shesh imanin e tyre të dobët, dhe i sanksionon në një mënyrë që të mos jenë pjesëmarrës në çlirimin e Hajberit, që do të ndodhte pas pak muajsh. Megjithatë, Allahu xh.sh. ua dha rastin që të dëshmoreshin në betejat e tjera të ardhshme, nëse dëshironi ta arrinin kënaqësinë e Tij, të cilën gjë e dëshmuar në vepër në luftën e Hunejn, pastaj kundër Musejlmee Kedhabit, kundër Bizantit, persianëve etj., ndërkohë që tash në këto dy ajete, sërish flet për besimtarët që iu besatuan Pejgamberit a.s. për besnikëri deri në vdekje, nën hijen e pemës në Hudejbije. Pikërisht, për hir të këtij besatimi, Allahu xh.sh i përgëzoi besimtarët me një fitore të afërt-Hajberin, po edhe me fitore të tjera të mëdha, të cilat nuk do të kishin të ndalur më deri në Ditën e Gjykimit.

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT 18

Transmetojnë Ibn Ebi Hatimi dhe Ibn Xheriri nga Ibn Merduvejhi e ky nga Seleme ibn Ekvaë të ketë thënë: “Përderisa ishim në dremitjen e mesditës (kajlule), e dëguam lajmëtarin e Resulullahut s.a.v.s. duke na thirrur. “O ju njerëz, besatimi besatimi”. Tashmë kishte zbritur Shpirti i shenjtë (Xhibrili a.s.), dhe ne të gjithë ngarendëm tek i Dërguari i Allahut, që po qëndronte nën hijen e pemës, dhe ia dhamë besën. Pas kësaj zbriti ajeti: “Vërtet Allahu qe i kënaqur me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën...”¹

KOMENT:

18. Vërtet Allahu qe i kënaqur me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën. Ai e dinte mirë se çfarë kishin në zemrat e tyre, prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt (çlirimin e Hajberit).

Arritja e kënaqësisë së Allahut është qëllimi dhe synimi final i të gjithë besimtarëve të sinqertë në këtë botë. Zaten, edhe qëllimi i krijimit tonë është adhurimi i Allahut dhe arritja e kënaqësisë së Tij. Allahu i Madhërishëm në suren Et-Tevbe, ajeti 72 thotë: “Besimtarëve dhe besimtareve Allahu u ka premtuar kopshte nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë, dhe vendbanime të bukura, në Xhenetin e Adnit, por lumturia më e madhe është kënaqësia e Allahut. Kjo është fitorja e madhe”.

Ndërsa në një hadith, të cilin e transmeton Ebu Seid el-Hudrij nga i Dërguari i Allahut, citohet të ketë thënë: “Allahu i Madhëruar do t'iu drejtohet banorëve të Xhenetit:

- “O banorë të Xhenetit!”

- “Urdhëro o Zoti ynë! E mira është në duart e Tua” - do të përgjigjen ata.

- “A jeni të kënaqur?” - i pyet Allahu.

- “E si mos të jemi të kënaqur, o Zot, kur na ke dhënë atë që askujt prej krijesave të Tua nuk ia ke dhënë?” - i përgjigjen.

- “Do t'ju jap diçka edhe më të vlefshme se kjo” - iu thotë Allahu i Madhëruar.

- “O Zoti ynë, po çgjë është më e vlefshme se sa kjo?” - do të pyesin ata.

- “Do t’ju përshkoj me kënaqësinë Time dhe kurrë më nuk do të hidhërohem në ju” - iu thotë Allahu i Madhëruar”²

Pikërisht për këtë arsye, ajeti i 18-të i sures El-Fet’h, , është ajet përgëzues për të gjitha ata që u besatuan në Hudejbije, sepse i ka përshkuar mëshira dhe kënaqësia e të Madhit Zot, kur ata ia jepnin besën të Dërguarit a.s., se nuk do të ktheheshin në Medinë, pa e marrë hakun e Uthmanit r.a., dhe nesër në Ahiret, do të jenë njerëzit më fatlumë, duke qenë nën hijen e mëshirës dhe kënaqësisë së Allahut ndaj tyre. Allahu xh.sh. i ka përgëzuar këta njerëz, sepse e dinte se zemrat e tyre vlonin nga imani i pastër, andaj zbriti qetësi në zemrat e tyre dhe i forcoi edhe më tepër në besim, duke iu premtuar fitore të reja kundër armiqve, së pari në Hajber,³ e pastaj edhe shpërblimin me xhenet në Ahiret.

Në lidhje me këta sahabinj të singertë në besimin e tyre, numri i të cilëve ishte afërsisht 1400, i Dërguari i Allahut s.a.v.s., në një transmetim që e përcjell Xhabiri r.a. ka thënë: “Ju jeni njerëzit më të mirë në Tokë.”⁴, ndërsa në një hadith tjetër, po për këta njerëz besnikë, i Dërguari a.s. ka thënë: “Në dashtë Allahu, askush prej këtyre që u besatuan nën pemë, nuk do të hyjë në Xhehenem.”⁵

Teksa i rikthehemi sërish kujtesës historike, sikur na dalin para syve ato pamje madhështore të besatimit të sahabëve, pamje që ta ngrenë moralin dhe të japin motiv për të vazhduar tutje në rrugën e Thirrjes.

Teksa i rikthehemi sërish kujtesës historike, sikur na dalin para syve ato pamje madhështore të besatimit të sahabëve, pamje që ta ngrenë moralin dhe të japin motiv për të vazhduar tutje në rrugën e Thirrjes. Ky qëndrim stoik i sahabëve të “Bej’atu-r-Rridvan”, dhe radhët e ngjeshura të luftëtarëve sypatrembur myslimanë, që i dhanë siguri të plotë të Dërguarit a.s., që t’ia mësynte Mekës për ta nënshtruar, duhet të na shërbejë të gjithë neve si thirrës në rrugën e Allahut, që ta stolisim veten me këto parime të larta të altruizmit e të sakrificës, për ta formuar një personalitet të pathyeshëm te brezi i ri, që kur udhëheqësi kërkon të mbrohet besimi, atdheu dhe nderi i nëpërkëmbur, të mbrohet edhe me forcë, por kur prijësi kërkon që armët të heshtin për t’i lënë vend negociatave dhe arritjes së paqes, ata të jenë të dëgjueshëm dhe t’i nënshtrohen urdhrit të tij.

19. edhe me pre të tjera (luftë) të mëdha që do t’i fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.

I Lartmadhërishmi, u premtoi atyre që u besatuan në Hudejbije, pasuri të mëdha lufte, të cilat do t’i fitonin së shpejti, pas kthimit në Medinë. Atë që Allahu ua ka premtuar besimtarëve, gjithmonë e ka realizuar, dhe



Çlirimi i Hajberit, ishte vetëm fillimi i çlirimeve të mëdha islame që do të pasonin, e prej atyre çlirimeve më madhështore do të ishte çlirimi i Mekës

vërtet, pa kaluar as disa muaj, ushtria myslimane ia mësyu fortifikatave të hebrenjve në Hajber, duke i marrë dhe çliruar ato, dhe i Dërguari i Allahut, ashtu siç e kishte porositur e urdhëruar Allahu Fuqiplotë, këtë pre të luftës ua ndau vetëm atyre që ishin me të në Hudejbije. Kalorësve ua ndau nga dy hise, e këmbësorëve nga një.⁶

Çlirimi i Hajberit, ishte vetëm fillimi i çlirimeve të mëdha islame që do të pasonin, e prej atyre çlirimeve më madhështore do të ishte çlirimi i Mekës, pa luftë, me se iu hap rruga thirrjes islame, që të depërtonte me shpejtësi në tërë Gadishullin Arabik. Allahu është i Urtë në përcaktimet e Tij, dhe i Plotfuqishëm që ta realizojë çdo premtim apo kërcënim të Tij.

POROSIA E KËTYRE AJETEVE

- Allahu i Madhërishëm, u premtoi shpërblime të mëdha të gjithë atyre që u besatuan në Hudejbije. Shpërblimi më i madh për besimtarët, ishte se Allahu që i kënaqur ndaj tyre, kur u besatuan nën hijen e pemës, duke zbritur prehje e qetësi në zemrat e tyre dhe duke i fuqizuar moralisht me një forcë dhe elan të madh imanor. Ai e kishte parë në zemrat e tyre sinqeritetin dhe besnikërinë që e kishin shprehur ndaj të Dërguarit a.s., ndërkohë që pas këtij besatimi, i Madhërishmi ua kishte premtuar edhe çlirimin e Hajberit, menjëherë pas disa muajsh, në pasuritë e të cilës luftë i kishte vënë hisedar vetëm ata që kishin qenë në besatimin e Be'atu-Rridvan në Hudejbije, e pas Hajberit, do të pasonte çlirimi i Mekës, e më vonë edhe shumë e shumë beteja të lavdishme kundër romakëve dhe persianëve.

- vijon -

1 *Lubabu-n-nukul fi esbabi-n-nuzul*, f. 236.

2 Sahihu-l Buhariu, (nr. 7518); Muslimi (nr. 2829); Sahih Ibn Hibban, nr. 7440. (Hadithi është i kategorisë 'sahih').

3 Shih më gjerësisht tefsirin e Taberit, *Xhamiu-l Bejan an te'vili ajil Kuran*, Kajro, 2001, vëll. 21, f. 27^h, (redaktuar nga dr. Abdullah Turki).

4 Sahihul Buhari (*El-Fet'h*, nr. 4145); Imam Shemsuddin edh-Dhehebi, *Sijer a'elami-n-nubelai (es-Siretu-n-nebevijeh-2)*, Bejrut, 1996, ff. 29-30.

5 Sahihu Muslim (*Kreu: Vlera e sahabëve 4/1942, hadithi nr. 2496*).

6 Grup dijetarësh nga Az'hari i ndershëm, *Et-Tefsiru-l Vesit li-l Kurani-l Kerim*, Kajro, 1992, vëll. 9, f. 1003.



Kaptina El-Asr, rrugët e shpëtimit të njeriut

Dr. Valmire Batatina-Krasniqi

Kurani është një udhërrëfyes hyjnor që përfshin tërë jetën e njeriut, duke e udhëzuar atë për në rrugën e vërtetë. Ai është një sistem i përsosur, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet Allahut të Madhëruar dhe njerëzve, si dhe njerëzve ndërmjet vete, i disiplinon ata me rregulla hyjnore, i lartëson duke i këshilluar për të mirë dhe duke ndaluar nga të ligat. Një ndër kaptinat që flet mbi këto virtyte të larta morale është edhe ajo El Asr, e zbritur në Meke me vetëm tre ajete. Edhe pse është e shkurtër, me përmbajtjen e vet sqaron shumë mirë virtytet thelbësore dhe jetike, të cilat janë faktor i fatbardhësisë së njeriut në të dy jetët, e në anën tjetër shpjegon edhe se jeta e njeriut është dështim nëse nuk posedohen cilësitë e përmendura: besimi, vepra e mirë, këshillimi i njëri-tjetrit me të vërtetën, të drejtën dhe këshillimin e njëri-tjetrit për durim e qëndrim të fortë.

LIDHSHMËRIA E KAPTINËS ASR ME KAPTINAT E TJERA

Kjo sure ka lidhshmëri të ngushtë me kaptinën paraprake Tekathur, duke u nisur nga fakti se në kaptinën Tekathur bëhet fjalë për angazhimin dhe përpjekjen e njerëzve të mashtruar me pasurinë e kësaj bote deri në çastin kur befaz vdekja ua ndërpret atë përjetim dhe prej pallateve i sjell në varre. Përfundon me shpjegimin rreth trishtimit, të cilin do të ndiejnë njerëzit, pos atyre që përveç besimit kanë bërë edhe vepra të mira. Shikuar nga ky këndvështrim, kaptina Asr, ka

një lidhshmëri të fortë me atë paraprake, sepse në këtë kaptinë rrëfimi fillon me faktin se njeriu është në një humbje të sigurt dhe se ekziston vetëm një rrugë që mund ta shpëtojë atë nga kjo humbje.¹

Sa i përket përmbajtjes shihet se kaptina Asr ka lidhshmëri edhe me kaptinën që zë vend pas saj në radhitjen kuranore, atë Humezeh. Sepse në këtë kaptinë bëhet fjalë për njerëzit, të cilët në vend që të bëhen këshillues, ata ofendojnë, përqeshin, nënçmojnë, tallen me të tjerët. Janë të mashtruar pas pasurisë së madhe dhe mendojnë se do të jenë përgjithmonë në këtë botë. Kjo sure u tregon atyre se fundi i rebelëve të tillë do të jetë zjarri, që kurrë nuk ftohet, zjarri që bën copë e thërrime çka të hidhet në të dhe që është i mbyllur. Si rrjedhojë, kaptina Asr, ka një lidhshmëri të ngushtë dhe të pathyeshme me atë Humezeh, ngase në këtë kaptinë bëhet e qartë se humbja e sigurt e njeriut e përmendur në kaptinën Asr është vendqëndrimi i shëmtuar i tij në Ahiret.²

SHPREHJA “ASR” DHE KUPTIMI I SAJ

Zoti i Madhëruar betohet në krijesat e Tij në shumë ajete kuranore. Këto betime ndonjëherë realizohen në formë pohore, si në kaptinat Duha dhe Asr, e herë-herë në atë mohore, si në kaptinat Beled dhe Kijame. Këto dhe betime të ngjashme në Kuran, janë

Zoti i Madhëruar betohet në krijesat e Tij në shumë ajete kuranore. Këto betime ndonjëherë realizohen në formë pohore, si në kaptinat Duha dhe Asr, e herë-herë në atë mohore, si në kaptinat Beled dhe Kijame.

për shkak se Allahu i Lartmadhëruar është Krijuesi i universit dhe të gjitha krijesave në të, ndaj për Të është e denjë të betohet në çdo krijesë që Ai do, pasi çdo gjë është nën urdhrin e Tij dhe është subjekt që dëshmon madhërinë e Tij. Si rrjedhojë, me betimin e Allahut të Madhëruar në krijesat e Tij, assesi nuk nënkuptohet shenjtërimi (hyjnizimi) dhe madhërimi i tyre, por me të synohet dëshmia, argumenti dhe ftesa e mendarëve për meditim dhe për të nxjerrë mësim, gjë që në fakt është vërtetuar të ketë gjetur përdorim në të folurin origjinal të arabëve, në gjuhën e të cilëve zbriti Kurani fisnik. Ndërsa shprehja “asr” e përmendur në ajetin e parë të kësaj kaptine ka kuptimin leksikor të kohës, kohës në të cilën jetojmë ose shekull, namazi i ikindisë, koha e ikindisë, koha e ditës dhe e natës.³ Ndërsa në kuptimin e përgjithshëm, Zoti i Madhërishëm betohet në kohën “Betohem në kohën!”⁴, për të theksuar që ajo është gjëja më e çmueshme për njeriun, nëse e shfrytëzon atë si duhet. Është këshilluesi më i mirë që të jep mësim se si i dobëti dhe i ligu me angazhimin e tij në punë, në dituri arrin të bëhet më i fortë dhe më i lartë, ndërsa ai që ishte i fortë e i lartë me përtacinë e tij bëhet më i dobëti. Koha është përplot ndodhi e ngjarje të çuditshme; njerëz të mëdhenj humbin vlerën, njerëz të panjohur arrijnë famë, pasanikët varfërohen, të varfrit pasurohen, e kështu me radhë në të gjitha fushat e jetës, prandaj duhet marrë mësim, që të mos humbim e të dështojmë në jetë.

Kapitali më i çmuar i njeriut është jeta e tij, e që megjithatë është e limituar, fundi i së cilës afrohet me marrjen e çdo frymëmarrjeje, kalimin e çdo ore, dite, jave, muaji, dhe kështu afrohet dhënia e llogarisë.

RRUGËT E SHPËTIMIT NË KËNDVËSHTRIMIN E KAPTINËS EL ASR

Rrëfimi në kaptinën El Asr, pas betimit vazhdon me dëshminë “Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.”⁵ Me këtë koncept vihet në mendje se nëse njeriu i cili nuk i përgjigjet urdhrave të Zotit dhe nuk e përdor mendjen, do të privohet nga lumturia e kësaj bote dhe e Ahiretit.⁶ Ngase zhgënjim dhe humbje e vërtetë nuk do të thotë vetëm privimi nga lumturia në botën e përkohshme, por është në Ahiretin e përjetshëm. Shikuar në këndvështrimin kuranor, marrëdhënia midis Krijuesit dhe rob-it i ngjan një marrëdhënieje tregtare, në të cilën Zoti i Lartësuar ka blerë jetën e besimtarëve dhe pasurinë e tyre në këmbim të Xhenetit,⁷ dhe se ekziston një tregti e bujshme që do t'i shpëtojë ata nga dënimi i dhembshëm.⁸ Këtë lloj të tregtisë nuk mund ta dëmtojë asgjë tjetër përveç “humbjes së vërtetë”, ndërsa përfituesit e saj janë ata që besuan Zotin dhe ndoqën urdhrat e Tij. Sipas interpretuesve të Kuranit, shprehja “el-insan” në këtë ajet kuranor nuk nënkupton thjesht vetëm një njeri, por me këtë nënkuptohet një qenie njerëzore e përgjegjshme që ka arritur moshën madhore dhe që mund të dallojë të mirën nga e keqja.⁹ Si rrjedhojë, përveç fëmijëve që nuk janë përgjegjës, që nuk mund të dallojnë të mirën nga e keqja dhe të paafteve, të gjithë njerëzit janë në zhgënjim



dhe humbje të vërtetë, me përjashtim të atyre që përmenden në ajetet vijuese të kësaj kaptine. Sepse kapitali më i çmuar i njeriut është jeta e tij, e që megjithatë është e limituar, fundi i së cilës afrohet me marrjen e çdo frymëmarrjeje, kalimin e çdo ore, dite, jave, muaji, dhe kështu afrohet dhënia e llogarisë. Meqenëse njeriu nuk është shpikësi dhe as pronari i jetës së tij, por atë e pranoi në besë nga Allahu i Madhërishëm që ta përdorë në formën më të bukur në kuadër të vullnetit të Tij për një periudhë kohore të kufizuar, atëherë shpëtimi dhe përfitimi i njeriut varet nga forma e përdorimit të kohës që i është dhënë atij.¹⁰ Në këtë mënyrë, pasi njeriu t'ia kthejë këtë pasuri pronarit që e ka dhënë në amanet, ose do ta shpëtojë veten e tij në ditën e llogaritjes sipas fitimit të mirë ose do të jetë i zhgënjyer dhe i humbur. Ata që pësojnë humbjen më të madhe janë ata që në ditën e Gjykimit e çojnë veten dhe familjet e tyre në humbje dhe zhgënjim. Mehmet Akifi thekson dëmet e kohës që njerëzit kalojnë me shkujdesje duke thënë: “Ai nuk i dëgjon zhgënjimet që vuan sepse shumica prej nesh...”¹¹

Nga kjo humbje mund të shpëtojnë vetëm ata që kanë këto cilësi: *“Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrit t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrit të jenë të durueshëm.”*¹²

Në ajet vihet në theks se kushti i parë për të shpëtuar nga humbja është imani. Shprehja “iman” e cila në Kuranin fisnik është përmendur në më shumë se tetëqind vende, në aspektin leksikor ka kuptimin e “vërtetësisë, besimit”, kurse në aspektin e përgjithshëm paraqet besimin në Zotin e Madhëruar, në melaqet e Tij, në librat e Tij, në të Dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit, në vendimin dhe caktimin e Tij, bindjen dhe nënshtrimin e robit ndaj Zotit të Tij.¹³

Në këtë kaptinë, pas besimit, si kushti i parë që njeriu të shpëtojë nga humbja dhe të arrijë lumturinë dhe shpërblimin e përjetshëm, si kusht i dytë përmenden veprat e mira, të cilat janë të domosdoshme pas besimit. Sepse edhe pse besimi është një veprim që i atribuohet zemrës,¹⁴ ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis tij dhe veprave të mira. Pra, besimi nuk duhet të mbetet vetëm në zemrat dhe gjuhët e njerëzve, por duhet reflektuar edhe në punët e tyre. Punët i kryejnë në përshtatje me besimin e tyre, për kënaqësinë e Allahut xh.sh. në përshtatje me urdhrat e zbritura nga Ai. Interpretuesit e Kuranit në sqarimin e ajetit në fjalë, theksojnë se shprehja “amilu's-saliha” ashtu siç paraqet të gjitha veprat

Në këtë kaptinë, pas besimit, si kushti i parë që njeriu të shpëtojë nga humbja dhe të arrijë lumturinë dhe shpërblimin e përjetshëm, si kusht i dytë përmenden veprat e mira, të cilat janë të domosdoshme pas besimit.

e urdhëruara dhe të miratuara nga Allahu i Lartësuar dhe Pejgamberi a.s., dhe shmangia nga ndalesat, po ashtu paraqet të gjitha veprat e mira të miratuara nga mendja, Kurani dhe Suneti dhe të cilat vërtetohen me prova racionale dhe tradicionale, si dhe me këtë shprehje nënkuptohen të gjitha veprimet që përfshijnë sjelljet e mira që lidhen me adhurimin dhe moralin.¹⁵ Në Kuranin fisnik, në kuadër të veprave të mira përmenden disa veprime si adhurimi i Zotit të Madhëruar dhe pasimi i të dërguarit të Tij,¹⁶ ndihma ndaj nevojtarëve dhe të varfërve,¹⁷ lufta në rrugën e Zotit për të fituar kënaqësinë e Tij,¹⁸ drejtësia, ndihma e njëri-tjetrit në devotshmëri¹⁹ etj.. Megjithatë, ka një pikë që nuk duhet anashkaluar, se për të qenë të vlefshme veprat e mira, duhet të janë të mbështetura me iman-besim, sepse pa besim, vepra e bërë nuk ka kuptim. Prandaj në Kuran kudo që është përmendur vepra e mirë, së bashku me të, në të njëjtin kuadër është përmendur edhe besimi.

Përveç besimit në Allahun dhe veprave të mira në kaptinë El Asr si parim i tretë që njeriu të arrijë vërtet shpëtimin në dynja dhe në Ahiret, përmendet “*këshillimi ndaj njëri-tjetrit t'i përmbahen të vërtetës*”.²⁰ Folia në kohën e shkruar “et-teuasau” e përmendur në ajet nënkupton dy individ që këshillojnë njëri-tjetrin ndërsjellas. Duke u nisur nga ky

fakt, kuptimi i ajetit mund të jetë: “Ata që besuan, bënë vepra të mira dhe këshilluan njëri-tjetrin për të vërtetën, janë të shpëtuar”. Shprehja “hak”, e cila në Kuran përmendet në 247 vende, përgjithësisht përdoret në kuptimin e të “vërtetës” dhe është e kundërta e fjalës “**batil**” e shtrembër. Ndërsa në aspektin e përgjithshëm, kjo shprehje ka dy kuptime: E para, fjalë e përshtatshme me drejtësinë dhe të vërtetën. E dyta, e vërteta që duhet sjellë në vend.²¹ Nga e gjithë kjo mund të thuhet se meqenëse njeriu është anëtar i shoqërisë në të cilën jeton, ai ka disa përgjegjësi dhe detyrime ndaj tyre. Si rrjedhojë, së pari, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira nuk duhet të mjaftohen me kaq, në të njëjtën kohë duhet të përpiqen të formojnë një shoqëri besimtare dhe të drejtë. E dyta, që kjo shoqëri të ruhet nga shthurja çdo person duhet ta dijë përgjegjësinë që i takon, ngase në një shoqëri ku nuk ka paqe dhe lumturi, asnjëherë nuk do të jetë e mundur që njeriu të ketë rehati dhe përparim. Pra, çdo individ ashtu siç beson në Allahun dhe bën vepra të mira për të arritur kënaqësinë e Zotit të tij, ai duhet t'i këshillojë të tjerët për në rrugën e vërtetë. Nëse në shoqëri nuk ekziston një frymë e



Durimi është thelbësor përballë stresit, fatkeqësisë dhe vështirësive. Shpresa, vendosmëria dhe durimi janë gjithashtu çelësat e transformimit të stresit në lumturi.

tillë, ajo nuk mund të shpëtojë nga humbja. Ata që janë të drejtë e të vërtetë për veten e tyre, nëse nuk përpiqen që shoqëria të mos shkatërrohet, nuk mund të vazhdojnë të jenë të drejtë dhe nuk mund të shpëtojnë nga humbja.

Parimi i katërt, i përmendur në kaptinën El Asr për shpëtimin e njerëzve në këtë botë dhe në Ahiret është *“këshillimi i njërit-tjetrit në durim”*.²² Shprehja “sabër” që në aspektin leksikor do të thotë “të parandalosh, të ndalosh, të jesh i fortë dhe rezistent”, në kuptim të përgjithshëm paraqet rezistencën ndaj presionit të epsheve dhe pasioneve,²³ apo rezistencën e treguar për të mënjanuar trishtimin,

dhimbjen, vështirësitë, brengat dhe telashtet, ose për të ndryshuar gjërat e liga në të mirë, për të bërë një vepër të mirë ose për të shmangur të keqen. Nisur nga ky fakt, paralelisht me këshillimin në rrugë të drejtë, duhet të jetë edhe këshillimi për të qenë i durueshëm në këtë rrugë që të shpëtojnë besimtarët dhe të gjithë anëtarët e shoqërisë. Pra, duhet t'i këshillojnë durimin njëri-tjetrit përballë çdo vështirësie që mund të përballen në këtë rrugë, përballë fatkeqësive dhe dëmeve të ndryshme. Mund të thuhet se durimi për ngjarjet që ndodhin në jetën e individit dhe shoqërisë dhe rekomandimi i tjetrit për durim është një nga sjelljet e virtytshme që vlerësohet në Islam. Ngase mbi të gjitha durimi nënkupton mbrojtjen e shpirtit nga ankthi,

ruajtjen e gjuhës dhe mbrojtjen e organeve nga sjelljet e shëmtuara, ruajtjen e qetësisë në çdo gjendje, mos dallimin në mes të bekimit dhe zemërimit dhe mos drejtimin me lutje te dikush tjetër, përveçse tek Allahu i Madhëruar. Durimi është thelbësor përballë stresit, fatkeqësisë dhe vështirësive. Shpresa, vendosmëria dhe durimi janë gjithashtu çelësat e transformimit të stresit në lumturi. Zoti i Lartë, ashtu siç e sprovov Ademin duke mos iu afruar pemës, po ashtu sprovon njerëzit për durim dhe mirënjohje në çdo gjendje dhe situatë. Kjo sprovë mund të kalohet me durim ndaj telasheve dhe fatkeqësive dhe me falënderim për çdo mirësi. Ata që duan të shpëtojnë nga fatkeqësitë, të cilat i kaplojnë individët apo shoqëritë, duhet të punojnë në përputhje me tekstin kuranor dhe të lidhen fortë me katër parimet e përsëhruara në këtë kaptinë, ngase këto katër parime janë të mjaftueshme për të siguruar shpëtimin dhe lumturinë e njerëzve si në këtë botë po ashtu dhe në atë të mëtejme.

1 Es Sekafi, El Burhan fi Tenasubi Suveri'l-Kur'an, fq. 2017.

2 Es Sekafi, El Burhan fi Tenasubi Suveri'l-Kur'an, fq. 2018.

3 Isfehiani, Mufredat, fq.569.

4 Asr, 103/1.

5 Asr 103/2.

6 Isfehiani, Mufredat, fq. 230. Maturidi, Te'vilatüül-Kur'an, XVII, 317.

7 Tevbe, 9/111.

8 Saf, 61/10.

9 Razi, Mefatihü'l-Gajb, XXXII, 278.

10 Nexhm, 53/39.

11 Ersoj, Safahat, “Sulejmanije Kursusunde”, fq.387.

12 Asr, 103/3.

13 Taberi, Xhamiu'l-Bejan, XXIV, 590; Ibn kethir, Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim, VIII, 480.

14 Huxhurat 49/14; Mücadele 58/22

15 Taberi, Xhamiu'l-Bejan, II, 287; Zemahsheri, Keshshaf, I, 125.

16 Nisa, 4/59; Enfal, 8/20.

17 Tevbe, 9/60; Isra, 17/26.

18 Bekare, 2/190; Nisa, 4/59, 84.

19 Bekare, 2/241, 281; Araf, 7/29, Maide, 5/2.

20 Asr, 103/3.

21 Ibën Manzur, Lisanu'l-Arab, II, 230.

22 Asr, 103/3.

23 Gazali, IV, 63.

A është Kurani një libër i rrezikshëm?¹

Enes Kariq

Ky tekst yni ka për qëllim kryesor të vetin që nga ata që janë të arsimuar në kulturë të tillë të eliminojë ose të paktën të zbut, sa të jetë e mundur, “shkëndijat kulturore”, të cilat sot shfaqen, sa herë që në shoqëritë laike ose shekullare Kurani interpretohet me arrogancë dhe lexohet kuturu, ose kur vetë myslimanët citojnë nga rreshtat e faqeve të tij rreshtat (*ajat*), alinetë dhe pjesët si shkronja të rëndomta të ligjit ose, në rastet edhe më të rënda, si nene të kushtetutës shtetërore ose thirrjeve luftarake!

TË FOLURIT RRETH KURANIT

Para të të folurit për Kuranin, të cilin myslimanët tradicionalë nga besimi i tyre islam, katërmbëdhjetë shekuj e pranojnë për Shpallje të Zotit², dhe në të besojnë si të Folur i Zotit dhe Fjalë e Zotit, dhe me këtë e konsiderojnë atë si burimin e tyre fetar të parë dhe kryesor, sot janë paraqitur shumë pengesa të tmerrshme në pranimin, madje edhe injorancë e pafytyrë që e pengon të kuptuarit korrekt të Librit të shenjtë islam.

Pengesa dhe vështirësia e rëndësishme në moskuptimin e Kuranit është në atë se shumë myslimanë të sotëm, të kapluar nga luftërat e egra të llojeve të ndryshme, i shtrembërojnë mesazhet dhe zotimet e shenjta të të folurit kuranor të cilat i zbuloi tradita islame brenda rrjedhave kryesore dhe shkollave të themeluara të tyre. Arsytet e këtij shtrembërimi të mesazhit kuranor zënë fill në situatat përbuzëse ekzistenciale (shoqërore, politike, ekonomike...) të myslimanëve sot, kurse ato situata dhe mundësi në masë të madhe e bashkëpërcaktojnë interpretimin e sotëm të Kuranit të shumicës prej tyre. Por edhe shumë

njerëzve të tjerë jashtë orbitës religjioze, kulturore dhe qytetëruese të cilat i bashkëpërcaktojnë vetë myslimanët.

Myslimanët që vdesin nën armë, në qytete ose krahina të rrethuara, që pësojnë në marshutat tokësore prej refugjatësh ose nëpër dete të trazuara, edhe ashtu të përgjakur me njëri-tjetrin, qartë të përcaktuara sipas linjave ndarëse sektare apo të tjera, të rraskapitur nga çdo mjerim dhe idhtësi, në faqet e Kuranit, para çdo kërkimi për rehati dhe paqe, i kërkojnë ato fragmente të Kuranit, kuptimin e të cilit e shtrijnë ashtu që zëri i Kuranit të duket sa më fuqishëm e sa më *vrazhdë*, që të flasë si rebelim kundër rendit të sotëm botëror, dhe kundër “armiqve myslimanë në të gjitha anët e botës”.

Gjendja është edhe më e vështirë në thirrjen këmbëngulëse në Kuran, në mesin e atyre myslimanëve që janë të orientuar ideologjikisht me fanatizëm kundër Perëndimit, atë pjesë të botës që ata fajësojnë si hemisferën armiqësore për të gjitha problemet, fatkeqësitë, rrëzimet dhe katastrofat e veta.

Myslimanët e fyer të proveniencave të ndryshme, disa milion prej tyre, kanë zëdhënësit e tyre të pacenueshëm, në fakt skajshmërisht të radikalizuar, të cilët, në mijëra faqe interneti, ata ofrojnë interpretimet e tyre të Kuranit, të zhvendosur jashtë traditës së Islamit, jashtë tërësisë së Kuranit të cilën myslimanët tradicionalë gjithnjë e gjenin në Kuran dhe në historinë e Kuranit. Të ashtuquajturat “qarqet ekstreme myslimane” dhe “ideologët radikalë myslimanë” ofrojnë proklamata të zhveshura kuranore, më së shpeshti dhunshëm të shpërndara dhe të

Të ashtuquajturat “qarqet ekstreme myslimane” dhe “ideologët radikalë myslimanë” ofrojnë proklamata të zhveshura kuranore, më së shpeshti dhunshëm të shpërndara dhe të shkëputura rëndë nga tërësia e Kuranit dhe nga tërësia e historisë së Kuranit, në mënyrë që t’u shërbejnë atyre si thirrje më të zakonshme të luftës dhe parulla sulmuese.

shkëputura rëndë nga tërësia e Kuranit dhe nga tërësia e historisë së Kuranit, në mënyrë që t'u shërbejnë atyre si thirrje më të zakonshme të luftës dhe parulla sulmuese. (p.sh.: 2:191; 4:89; 47:4).

Në të vërtetë, ai i cili has në fletëpalosje, broshura dhe libërtha, me një përzgjedhje të tillë të shkëputur nga konteksti kuranor dhe historik, të alineve dhe fragmenteve pikërisht në mënyrën e përmendur, ai për Kuranin do të gjykojë dhe përfundojë se bëhet fjalë për një libër luftarak, të vrazhdë dhe apatik.

Njeriu me informacione të tilla mbi Kuranin do të bartë një imazh të gabuar për këtë libër, dhe do të jetë i privuar nga njohja që pikërisht tre tërësi të përmendura të Kuranit e bartin vulën e një situatë të rëndë historike në të cilën jetuan myslimanët në Mekë dhe Medinë. Prandaj, citatet e përmendura kuranore: 2:191; 4:89; 47:4, janë të shënuara me rrethana të veçanta të mbrojtjes së drejtpërdrejtë për vetë mbijetesën e komunitetit mysliman në Mekë dhe Medinë, dhe nuk reflektojnë në asnjë mënyrë qëndrimin e përgjithshëm të Kuranit ndaj jomyslimanëve, as nuk ofrojnë parime të përcaktuara ose të përhershme për qëndrimin e Kuranit ndaj feve dhe njerëzve të tjerë.

PËRMBAJTJA PAQËSORE E TEKSTIT KURANOR

Nga ana tjetër, konsiderojmë se nuk është mënyra më e mirë për të mbrojtur Kuranin ajo kur, me citatet e përmendura kuranore 2:191; 4:89; 47:4, abrogohen *ajetet* dhe citatet kuranore me “përmbajtje paqësore”. Sigurisht, ka shumë pasazhe të Kuranit që ofrojnë qëndrimin e përgjithshëm të këtij libri të shenjtë për njerëzit dhe religjionet tjera (p.sh.: 2:190; 2:208; 9:4; 16:125).

Pasazhe të tilla të Kuranit, të cilat kultivojnë një mesazh të durueshëm ose *tolerant*, ka akoma, do të gjenden si filigran përgjatë shumë kapitujve të Librit të shenjtë islam. Por, sikur që thamë për pasazhet 47:4; 4:89; 2:191, që janë nxjerrë si nga konteksti kuranor ashtu edhe nga konteksti historik, dhe për këto pasazhe të Kuranit (2:208; 16:125; 2:190; 9:4 etj.), kur i krahasojmë si një tabelë më vete, mund të thuhet se janë nxjerrë edhe nga konteksti kuranor, por edhe nga konteksti historik.

Edhe njëra edhe mënyra tjetër (e para që pohon se Kurani është një libër me mesazhe armiqësore, e dyta që e përfaqëson Kuranin në mënyrën e sloganeve të shkruara me shkronja të

Për fat të keq, të dy drejtimet në “shtrembërimin e Kuranit” sot, edhe ai i myslimanëve të radikalizuar, sikur edhe ai që pason mijëra media të krahut të djathtë në Perëndim, shfaqen si një pengesë e tmerrshme për të folur për Kuranin në mënyrë të arsyeshme sipas traditës mijëvjeçare islame, e cila ishte në kërkim të kompaktësisë kuranore.

mëdha, të ngritura lart në demonstrata në mbështetje në përkrahje të paqes në botë) nuk ofrojnë atë që ofron tërësia e Kuranit kur bëhet fjalë për tematizimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve kuranore për bashkëpunimin e njerëzimit të feve të ndryshme, ngjyrave, gjuhëve, pjesëve të botës.

Sigurisht, Kurani është shpallur në shekullin VII sipas Isait a.s. (Jezu Krishtit), pas Islamit nuk u shfaq asnjë religjion i ri të formatit botëror. U shfaqen sekte të reja (protestantizmi, për shembull), por ato nuk u treguan si një shtyllë e religjionit të re. Kurani në shekullin VII kishte obligim të trajtonte skenën religjioze të njerëzimit.

Këtë edhe e bëri në mënyrë të *detektimit të dallimeve dogmatike* midis Islamit dhe tyre, por edhe në mënyrë të proklamimit të përgjithshëm se *Zoti është - një Zot dhe i vetëm, Zoti i të gjithë njerëzve, i të gjithë besimtarëve, drejtimeve dhe rrugëve*. Kurani me angazhim u tërhoq vërejtjen të gjithë atyre besimtarëve të ndryshëm, u propozon që të mendojnë nëse besimet e tyre, të cilat për pasojë kanë bërje të shumta, me të vërtetë i çojnë kah Zoti, a i çojnë ata drejt përhapjes së të mirave në këtë botë. Sigurisht, sipas shkronjës së Kuranit, shpesh edhe vetë myslimanët, nuk janë përjashtuar nga këto paralajmërime kuranore.

Kurani pohon qartë se njerëzimi i një feje nuk është projekti i tij (krahaso: *El Maide*, 5:48).³ Aq më i gabueshëm është klasifikoni i alineve të Kuranit në mënyrën e dualizmit të kulluar (“për” dhe “kundër”). Kurani nuk është një libër kundërthënës. Është shumë më e këshillueshme që të trajtohen vende të shumta të Kuranit dhe të ndjehet kudo qoftë ato libra në faqe të ndryshme, në tema, hollësi, detaje të botëve të shumta e të mëdha për të cilat libri i Kuranit flet në shpërthimet e qarta të fjalëve të veta karakteristike për stilin e tij.

E megjithatë, pasazhet dhe citatet e Kuranit që thërresin për luftë në traditën islame të interpretimit të Kuranit gjithmonë janë trajtuar si mesazhe specifike për rrethana e kohë të caktuara, dhe assesi si parime të përhershme, dhe as si një mesazh i pakushtëzuar përhershëm i Kuranit.

Me fjalë të tjera, Kurani duhet të lexohet nga tërësia e tij. Kurse tërësia e Kuranit rekomandon paqen (p.sh. 2:208), pagja është baza dhe parimi, kurse lufta është përjashtim.⁴ Gjatë kësaj kohe duhet pasur parasysh se as Bibla, as Kurani

nuk e “shpikën” luftën; përkundrazi, lufta është aty, përbri njeriut, si dukuri e shëmtuar dhe e neveritshme e ekzistencës njerëzore. Kjo duhet të kihet parasysh sa herë që ne në Kuran lexojmë pasazhe dhe aline për mizoritë e luftës dhe luftimit, por edhe për zbutjen e vështirësive luftarake dhe fatit të keq të robërve që rrjedhin prej tyre. Sikur në shumë faqe të Kuranit e gjejmë atë paralajmëruese Hyjnore “por”. Sikur mbi një shumësi faqesh të Kuranit gjejmë atë “por” qortuese hyjnore. Te këto “por” duhet ndalur dhe të mendohet për to. Për shembull, do të mendonim se Kurani vetëm i mbron dhe i ruan xhamitë dhe Tempullin e Shenjtë mekas. Dhe pastaj papritmas hasim në atë “por” Hyjnor, pas të cilit shohim se Zoti i mbron edhe kishat, edhe sinagogat, edhe manastiret dhe edhe xhamitë. Për shembull: “...Sikur Allahu të mos i luftonte njerëzit me njëri tjetrin, do të rrëzoheshim ne themel manastiret, edhe kishat, edhe sinagogat, edhe xhamitë në të cilat përmendet shumë emri i Allahut!”⁵

Prandaj, nga mesazhi kuranor se “Zoti është krijues i të gjitha krijesave dhe i gjithë njerëzve” (*rabbu l-‘alemin* krah. suren e parë të Kuranit ose *El Fatiha*, 1:1-3), nxirret parimi kuranor për Zotin si një shpresë e përgjithshme për të gjithë njerëzit (krah. p.sh. 2:62), e jo vetëm për myslimanët. Në fakt, në Kuran, mëshira e Zotit është përmendur në dhjetëra herë. Përveç kësaj, Kurani në rreth njëzet vende i drejtohet tërë njerëzimit (*ja ejjuhe ‘n-nasu - o ju njerëz, o njerëzim!*), dhe kjo është dëshmi e aspiratës së fortë të porosisë së tij për të afirmuar thirrjet universale të njerëzimit dhe bashkëpunimin midis segmenteve të tij të larmishme.

KURANI ËSHTË PROVË PËR JU DHE KUNDËR JUSH

Nëse, shkurtimisht, do të kthehemi te ndërhyrjet e fuqishme tejet të angazhuara, luftarake, madje edhe të luftës për fjalitë (*ajat*), pasazhet dhe faqet kuranore, duhet përsëri të rikujtojmë se për to ne sot dimë si nga myslimanët ashtu edhe nga jomyslimanët dhe mediat e tyre djathtiste.

Sado që lëvizjet antikolonialiste, si dhe njerëzit që i drejtuan ato, nuk u kujdesën sa duhet të shpjegojnë kontekstin teorik dhe historik të “vendeve militante” nga Kurani (2:191; 4:89; 47:4), ashtu as mediat djathtiste sot nuk po tregojnë as qëllimin më të vogël që lexuesve të tyre të shumtë shumë milionësh t’ua shpjegojnë që Kurani përmban një numër shumë më të madh të teksteve, të cilat në mënyrë ekzegjetike dhe hermeneutike, i bashkëpërcaktojnë ato maksima nga Kurani të cilat ata i përdoren në mënyrë abuzive mediatikisht, në mënyrë të pamundësimit të përhershëm të çfarëdo dialogu të arsyeshëm me myslimanët dhe Islamin.

Për fat të keq, të dy drejtimet në “shtrembërimin e Kuranit” sot, edhe ai i myslimanëve të radikalizuar, sikur edhe ai që pason mijëra media të krahut të djathtë në Perëndim, shfaqen si një pengesë e tmerrshme për të folur për Kurantin



në mënyrë të arsyeshme sipas traditës mijëvjeçare islame, e cila ishte në kërkim të kompaktësisë kuranore.

Në fund, t’i themi dy-tre fjalë për atë sa çka nënkuptojmë ne me “tërësinë e Kuranit” për të cilën mendojmë që sot është aq shumë e lënë pas dore, e pothuajse edhe e harruar nga shumë myslimanë dhe jomyslimanë në mënyrë të padrejtë. Kurani është prej pjesëve që e përbëjnë tërësinë. Është vetëm tërësia ajo që u jep pjesëve kuptimin, tonalitetin. Por, tërësisë gjithmonë i drejtohem përmes pjesëve të veçanta, përmes detajeve, përmes hollësive. Derisa kalojmë nëpër pjesë, detaje dhe hollësi, na duhet sa më shpesh që të jetë e mundur të shikojmë këndvështrimet dhe horizontet kuranore “atje lart”, “atje poshtë”, “atje mbrapa”. Kurani, në ndonjë mënyrë, me gjithë përfshirjen e tij, na “përfshin” edhe neve dhe atë që lexojmë prej tij. Sikur kur udhëtojmë nëpër botë, kudo që të vijmë, përsëri e gjejmë qiellin sipër kokës sonë! Pikërisht kështu është edhe rasti me leximin e Kuranit: pas çdo detaji të adresuar, më lart është gjithë përfshirja kuranore, ajo tërësi kuranore, e cila kontekstualizon gjithçka, që sjell gjithçka në Kuran në një marrëdhënie reciproke.

Nga gjuha boshnjake përktheu e përshtati:

Dr. Azmir Jusufi

1 Enes Karić, *Kako čitati Kur'an*, (Sarajevë, 2009), 9-21.

2 Për vendin e Kuranit në islam krah.: Seyyed Hossein Nasr, *Srce islama*, (Sarajevë, El-Kalem, 2002).

3 Për këtë krah. Kuran (١٠:٩٩): “E sikur të donte Zoti yt, në Tokë të gjithë do të ishin besimtarë! Mos dëshiron ti me dhunë t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”

4 Për këtë krahaso, p.sh., pjesën e Kuranit (*E pyetura/El Mumtahine*, 60:8): “Allahu nuk ua ndalon të jeni bamirës dhe të jeni të drejtë me ata të cilët nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë, as u dëbojnë ju nga vendbanimet tuaja! Allahu, me të vërtetë, i do të drejtët!”

5 *Pelegrinazhi/El Haxh*, 22:40.

Kultura e të ushqyerit në Islam

Dr. Selatin Mehani

Konsumimi i produkteve të natyrës është lidhja më e drejtpërdrejt që kemi me tokën. Ajo është burimi i vetëm i ushqimit. Por shpeshherë njeriu kur ushqehet vetë, e harron urinë e banorëve tjerë të kësaj toke.

Të ushqyerit nga begatitë e Zotit, të nxjerra nga toka, është prej begative më të mëdha që i janë dhënë njeriut, në këtë tokë të të gjithëve. Lidhur me këtë, Kurani fisnik, në suren Nahl (Bleta), ajeti 18, thotë: “E nëse do t’i numëronit dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t’i përkufizonit ato.” Si dhe: “O ju njerëz, hani nga ajo që është e lejuar dhe e mirë në tokë...” (El Bekare, 168).

Konsumimi i produkteve të natyrës është lidhja më e drejtpërdrejt që kemi me tokën. Ajo është burimi i vetëm i ushqimit. Por shpeshherë njeriu kur ushqehet vetë, e harron urinë e banorëve tjerë të kësaj toke. Këtë dukuri të frikshme e dëshmon numri alarmant i të vuajturve për bukë e ujë nëpër botë, që mbërrijnë shifrën me miliona, sipas statistikave zyrtare të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, Kurani thekson se: “Ushqimi është një bekim prej Zotit që duhet shijuar dhe ndarë.” (24:61).

Të ushqehesh me këto begati, duke qenë mirënjohës dhe falënderues i Zotit, është po aq e rëndësishme sa edhe të agjërosh duke qenë durimtar. Lidhur me këtë, i Dërguari i Zotit thotë: “I ushqyeri falënderues është në gradën e agjëruarit durimtar.”¹

Nevoja e njeriut për të ngrënë dhe për marrjen e ushqimit është nevoja e tij më e rëndësishme ditore, e cila e shoqëron atë që nga lindja deri në vdekje, madje në këtë, edhe profetët nuk bëjnë përjashtim. Në këtë kontekst Pejgamberit a.s. ka thënë: “O njerëz, Allahu është i mirë (Tajjib) dhe nuk pranon jetët përveç të mirës. Allahu i ka urdhëruar

besimtarët me atë që i ka urdhëruar edhe pejgamberët. Prandaj ka thënë: “O të dërguar, hani nga të lejuarat e mira (tajjibatet) dhe bëni punë që vlejnë! Vërtet Unë e di mirë çfarë bëni.” Dhe ka thënë: “O besimtarë, hani nga ushqimet e lejuara (tajjibatet) me të cilat ju kemi furnizuar, dhe nëse jeni adhures të Allahut, falënderojeni Atë!” Pastaj, i Dërguari alejhi selam, përmendi njeriun që ka marr udhë të gjatë, i cili me flokët e shprishura dhe trupin e pluhurosor nga udhëtimi, zgjatë duart kah qielli me lutje duke thënë: “O Zot, o Zot! Por meqë ushqimin e ka haram, pijen e ka haram, veshjen e ka haram, dhe është ushqyer me haram, si ka për të marr dot përgjigje në lutjen e tij?!”

Sipas dijetarëve “çdo mundësi që Zoti i Plotfuqishëm u jep gjallesave, në mënyrë që ato të vazhdojnë të jetojnë” quhet furnizim, dhe ky përkufizim thekson se të ushqehesh është domosdoshmëri, por të ushqehesh shëndetshëm me hallall është fe.

Thirrja e Kuranit drejtuar besimtarëve për të “ngrënë nga të gjitha gjërat e shëndetshme që janë të lejuara për ju” që përsëritet në disa sure bazohet në dy metoda:

- E para: Urdhërimi për shfrytëzimin e të mirave që i ka dhënë Zoti.

- E dyta: Mospranimi i ndalimit të këtyre të mirave pa argument prej Zotit.

Në suren El Bekare, ajetet 168-169 shkruan: “O ju njerëz, hani nga ajo që është e lejuar dhe e mirë në tokë dhe mos ndiqni gjurmët e shejtanit, se ai është armik i hapur për ju. Ai

vetëm ju urdhëron për punë të liga e të pahijshme, dhe të thoni për Zotin çfarë nuk e dini.”

Dhe në suren El A'raf, ajeti 32, thotë: “Thuaj: “Kush i ka ndaluar stolitë e Perëndisë, të cilat, Ai i ka krijuar për robërit e vet, dhe ushqimet e këndshme?!”

Ndërkaq, në suren e sofrës, El Maide, ku janë diktuar çështjet themelore lidhur me ushqimin, ajeti 87, thekson: “Mos ia ndaloni vetes ushqimet e pastra dhe të shijshme që Allahu ju ka lejuar.”

Kushdo që i shqyrton ajetet që flasin për ushqimet, do të zbulojë se Kurani famëlartë ka marrë dy rezerva të rrepta në lidhje me përdorimin e të mirave të jetës:

- E para: ushqimi të jetë i lejuar (hallall) dhe i mirëfituar (tajjib).³ Kjo karakteristikë kryesore që kërkohet tek ushqimet, e ndërlidh parimin hallall me sigurinë ushqimore dhe i bën të pandashëm. Kështu që, në përcaktimin e sigurisë, higjiena dhe cilësia e ushqimit në konceptin *Halalen Tajjiben* (hallall i këndshëm dhe i mirëfituar) bëhet pikë referimi kryesor.

Ragib el Asfahani, në leksikon El Mufredât e përkufizon “ushqimin tajjib” në kuptimin e tij fetar, si “ushqim i marrë në mënyrë të ligjshme dhe i konsumuar brenda kufijve të lejuar”, dhe në mënyrë metaforike e përshkruan “personin tajjib” si “një individ që pastrohet nga injoranca e vesi dhe është i stolisur me dituri, besim dhe sjellje të virtytshme.”

- E dyta: Ushqimi të konsumohet me masë. Pasi Islami e thekson maturinë në çdo aspekt të jetës, është thelbësore që ky koncept të jetë i pranishëm edhe gjatë ngrënies, pasi e mban trupin më të shëndetshëm, intelektin më të freskët dhe natyrën e njeriut më të butë. Kjo nënkupton se nga myslimanët pritet që të hanë për të jetuar me shëndet të mirë, dhe jo të jetojnë për të ngrënë. Hulumtimet bashkëkohore kanë

vërtetuar se, ushqimi i tepërt dhe dieta e pahijshme mund të rrisin mundësinë e sëmundjeve të tilla si; obeziteti, kolesterolit i lartë, sëmundjet e zemrës dhe diabeti.

Meqë parandalimi është më i mirë se kurimi, ngrënia e tepërt është dekurajuar fuqimisht në Kuranin famëlartë, ku në ajetin 31 të sures El A'raf thuhet: “...hani dhe pini e mos e teproni! Vërtet Allahu nuk i do shpërdoruesit.”

Përveç Kuranit, shumë hadithe inkurajojnë maturinë në të ushqyer dhe ka të tilla që nxisin për rregullin 1 me 3. Profeti a.s., ka thënë: “Askush nuk e mbush një enë më keq se barkun e tij. Njeriut i mjaftojnë disa kafshatë për ta mbajtur shpinën drejt. Por nëse duhet të hajë më shumë, atëherë ta mbushë me ushqim një të tretën (e barkut), një të tretën me pije, dhe një të tretën ta lërë për frymëmarrje.”⁴

Një e treta e ushqimit që hamë na bën mirë për të jetuar shëndetshëm, kurse dy të tretat e tjera u shërbejnë mjekëve për të jetuar nëpërmjet mjekimit.

Realiteti ynë i sotëm ka nxjerr në pah se më e vështirë është të hash i kufizuar, se të agjërosh krejtësisht. Ngase, kufizimi kërkon vetëdijesim, ndërsa agjërimi kërkon vullnet. Ushqyerja në mënyrën e duhur jo vetëm që parandalon sëmundjet, por edhe jep shëndet dhe mirëqenie fizike e shpirtërore.

Sigurisht se, populli ka të drejtë kur thotë: Njeriu që jepet pas ushqimeve të tepërta, i prish shëndetin vetes me dhëmbët e veta.

Islami ka një pikëpamje pozitive për jetën. Ai e trajton njeriun si një mëkëmbës i Zotit, nën shfrytëzimin e të cilit është vënë gjithçka në tokë, e nuk synon t'i privojë myslimanët nga “gjërat e mira që u ka dhënë Zoti”, dhe as nuk e konsideron virtyt shmangien nga dhuntitë e Tij. Kurani e thotë qartë: “Ai (Allahu) për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë...” (El Bekare, 29); “A nuk e dini ju se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në Tokë, dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta...?” (Lukman, 20). Me këtë përmbajtje ka edhe shumë ajete tjera.

Kurani madje e barazon përpjekjen për mirëqenie ekonomike me një veprim të virtytshëm, kur thotë: “E kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkon begatitë e Allahut, por edhe përmendeni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim.” (Xhumua, 10).

Ky kuptim theksohet qartë edhe në thëniet e Profetit a.s., kur thotë: “Ai që kërkon të mirat e botës në mënyrë të ligjshme, për t'iu shmangur lypjes e për të furnizuar familjen e tij dhe për të qenë i mirë me fqinjët, do ta takojë Zotin duke i shndritur fytyra e tij si Hëna e plotë.”

Thelbi i Islamit qëndron në marrëdhëniet ndërmjet qenies njerëzore dhe Krijuesit të saj, prandaj ai i parashtrohet njeriut sugjerime dhe rregulla për të jetuar në mënyrën që arrin rezultatet më të mira për këtë marrëdhënie. Sepse, besohet





se shëndeti shpirtëror optimal mund të arrihet vetëm nëse dikush është fizikisht i shëndoshë. Islami e ka mision të shërbejë si 'mëshirë' për njerëzimin, dhe synon ta bëjë jetën më të pasur dhe më të vlefshme për ta jetuar, e jo më të varfër e të vështirë. Kurani thotë: "E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (El Enbija, 107); "Allahu dëshiron lehtësim për ju, e nuk e dëshiron vështirësimin (për ju)." (El Bekare, 185).

Njeriu duhet të lidhet për të mirat që mund të fitohen në mënyrë të drejtë, edhe në qoftë se ai fitim mund të jetë i vogël, ashtu siç e sqaron Kurani në suren e Sofrës: "Thuaj: "Nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira, edhe nëse të mahnit ty shumimi i së keqes, pra kini frikë Allahun (e mos pranoni të keqen) o ju të zotët e mendjes, ashtu që të shpëtoni." (El Maide, 100).

Kurani i obligon myslimanët me fjalët: "Dhe mos lini mangët sendet e njerëzve" (Shuara, 183), duke nënkuptuar që çdo individ duhet të marrë atë që është vërtetë e tij duke mos privuar të tjerët nga kjo e drejtë. I Dërguari a.s., na ka paralajmëruar: "Ruaju padrejtësisë, sepse ajo do të jetë errësirë në Ditën e Gjykimit."⁵ Kjo vërejtje ndaj padrejtësisë dhe shfrytëzimit pa të drejtë ka për qëllim të mbrojë të drejtat e të gjithë njerëzve në shoqëri, pavarësisht a janë ata konsumatorë, prodhues, distributorë, punëtorë apo punëdhënës.

Kjo shpjegon mënyrën me të cilën Islami krijon harmoni ndërmjet ushqimit material dhe atij shpirtëror, duke i obliguar myslimanët të punojnë për mirëqenie ekonomike mbi baza morale për të shijuar një përvojë të qëndrueshme shpirtërore. "Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangët atë që të takon nga kjo botë dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të keqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit." (El Kasas,

77); "O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete." (Nisa, 29).

I Dërguari a.s., ka thënë: "Kjo pasuri është vërtetë e këndshme dhe e ëmbël; por ai i cili e fiton dhe e shpenzon atë në mënyrë të drejtë, për të ajo është një ndihmesë e shkëlqyeshme, ndërkohë që ai i cili e fiton atë pa të drejtë, është si ai i cili ha, por kurrë nuk ngopet."⁶

Ushqimi që ne hamë është një dhuratë prej Zotit po aq sa mana në shkretëtirë për israilitët, frutat josezonale në dhomën e Merjemes, dhe tryeza mrekulluese dhënë Isait alejhi salam. Ushqimi meriton vëmendjen tonë, që të falënderojmë Zotin për këtë të mirë që na ka dhënë, me të cilin mbajmë shëndetin të fortë për të kryer detyrat e jetës, dhe lumturohemi me njerëzit e ulur rreth një sofre.

Ai shërben edhe si stacion meditimi dhe përsiatjeje, të cilat qojnë te Krijuesi i vërtet, nëse njeriu ndalet për një çast e mendon në periudhat e formimit të ushqimit, duke filluar nga esenca, pra uji, pastaj çarja e tokës dhe dalja e bimës, deri te finalizimi i krijimit dhe marrjes së formës, të bukur, me shije dhe përplot me ngjyra të ndryshme, të cilat vënë në pah shumëllojshmërinë e dhuntive të Zotit...

Kurani nxit të meditojmë për këtë fenomen të jetës kur në suren Abese, ajeti 32, thotë: "Le të shoh njeriu në ushqimin e tij! Se si Ne e zbritëm ujin mjaftueshëm. Pastaj me çarje çamë tokën. Dhe në të bëmë të mbin bimët, rrushi e perimet, ullinjtë e hurmat, pemishte të dendura, fruta e barishte. Furnizim për ju dhe bagëtitë tuaja".

Në rrafshin praktik, i Dërguari a.s., ka sqaruar rëndësinë e kujdesit për prodhimin dhe kultivimin e ushqimit, kur ka thënë: "Nëse ndokush prej jush ka në dorën e tij një fidanë, në ndërkohë që sheh Kiametin tek afrohet, le ta mbjell atë!"⁷

Sipas kuptimit islam, secili duhet së pari të përpiqet që me mundin e tij t'i plotësojë nevojat e tij dhe të atyre që ka nën përgjegjësi. Në një hadith thuhet: "Njeriu nuk ka ngrënë asgjë më të mirë sesa nga ajo që ka fituar me mundin e duarve të tij."⁸

Parimi ushqimor "Hallall i mirë" është një koncept që përbën standardin më të lartë të cilësisë dhe sigurisë së produktit, i cili kryesisht bazohet në tre kritere:

1. Kriteri i komponentëve - Ky kriter përfshin kushtet e therjes së shpendëve dhe kafshëve, përcaktimi i përbërësve hallall dhe haram në produkte dhe nëse është natyral apo i prodhuar, bazë apo i shtuar. Në mënyrë që të përjashtojë çdo substancë të ndaluar ose të dëmshme që klasifikohet si e papastër (si vera, mishi i derrit, gjaku e të tjera). Brenda rrethanave emergjente, ka disa përjashtime që lejojnë përdorimin e asaj që nuk lejohet në radhë të parë, me kusht që të mos ketë alternativë tjetër.

2. Kriteri i dobisë - Ky standard garanton që përbërësit e të gjitha llojeve janë të padëmshëm në vetvete dhe nuk

rezultojnë në dëm. Ky standard trajton shumë substanca të shtuara në ushqim dhe pije për të rregulluar proporcionet e tyre për të qëndruar brenda kufirit të lejuar. Ai gjithashtu ka të bëjë me verifikimin që produkti të jetë pa asnjë ndotës apo mbetje pesticidesh apo metalesh. Produkti mund të ketë aditivë në përmasa të pranueshme (jo të dëmshme), por konsumimi i shpeshtë i materialeve të tilla çojnë në dëme që rrjedhin nga natyra e konsumit jo të mirë.

3. Kriteri i pastërtisë - Të cilit ne i referohemi si ndjekja e metodave që arrijnë pastërtinë e produktit përfundimtar, dhe kjo përfshin pastërtinë e përbërësve dhe mjeteve të përdorura në prodhim, dhe atmosferën e përgjithshme në të cilën përgatitet produkti.

Në ajete të ndryshme theksohen parime në lidhje me konsumin e ushqimit.

- Pikë së pari, kërkohet që besimtari të jetë i matur në ngrënie e pirje dhe t'i shmanget shpërdorimit.

- Burimet ushqimore të trajtohen me respekt. Kafshët nuk gjuhen për sport apo kënaqësi. Si në gjueti, ashtu edhe në therjen e kafshëve shtëpiake, kafsha trajtohet me mirësi. I Dërguari a.s., ka thënë: "Zoti e ka bërë mirësinë të obligueshme për ju në çdo gjë."⁹

- Në përdorimin e begative të tokës merret parasysh edhe nevoja e brezave të ardhshëm që do të përfitojnë nga këto të mira.

- Nuk ulemi në tavolinë pa qenë të uritur, dhe të ngrihemi para se të ngopemi.

- Para dhe pas vaktit lahen duart. Ulemi dhe fillojmë vaktin me Bismilah, hamë me dorën e djathtë, nuk lihet asnjë mbetje, dhe në përfundim e falënderojmë Allahun për begatitë e ushqimit dhe pijeve.

- Bollëku i tavolinës shtohet duke ngrënë me të tjerët dhe duke mirëpritur mysafirë. I Dërguari i Allahut thotë: "Ushqimi për një person është i mjaftueshëm për dy, dhe ai për dy persona është i mjaftueshëm për katër". Mikpritja kryesisht përben marrëdhënien midis ushqimit dhe kulturës, por në kulturën islame, mikpritja është edhe adhurim që synon të fitojë kënaqësinë e Allahut nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të dashurisë dhe miqësisë mes njerëzve. Hadithi deklaron: "Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit duhet ta nderojë mysafirin e tij."¹⁰ Ndërsa populli me të drejtë thotë: Sa herë çilet dera, rritet ndera.

Megjithatë, kur jemi te konsumimi i mishit, si një prej burimeve kryesore të ushqimit, trajtimi i mirë i kafshëve është një e drejtë që nuk duhet neglizhuar. Kjo nënkupton se sjellja njerëzore është në thelb normative. Prandaj, Islami jep detyrën e "dhënies së të drejtës çdo gjëje që ka të drejtë", se vetë Zoti krijoi universin dhe çdo gjë brenda tij "bil-hak", pra me anë dhe nëpërmjet së drejtës. Ekziston një metodë e përcaktuar fetarisht për therjen e kafshëve, ku përmendet se

tehu i përdorur duhet të mprehet deri në atë pikë sa kafsha të mos ndjejë dhimbje.

Uria në një botë me bollëk, nuk është më shumë se një zgjedhje e padrejtë. Siguria e ushqimit synon të ruajë gjendjen dhe cilësinë e ushqimit nga kontaminimi dhe sëmundjet. Shumica e sëmundjeve të lidhura me ushqimin janë shkaktarë të viruseve, baktereve dhe parazitëve, por edhe rezultat i helmimit nga substancat toksike dhe kimike që transferohen nga ushqimi në trup. Siguria ushqimore përcaktohet në 4 dimensione: disponueshmëria e ushqimit, qasja në ushqim, shfrytëzimi dhe stabiliteti. Zvogëlimi i numrit të të paushqyerve është një objektiv kyç. Ka shumë transmetime të Profetit a.s., në të cilat ai urdhëron dhe nxit myslimanët që t'u japin ushqim të varfërve, në njërin prej tyre ai thotë: "Personi që fle i ngopur ndërsa fqinji i tij fle i uritur, nuk është besimtar i vërtetë."

Në Haxhin e Lamtumirës, i kthyer në nënën e qyteteve "ummul kura", Muhamedi a.s., shpalli se "koha është kthyer në gjendjen e saj fillestare, ashtu siç ishte në ditën kur Zoti krijoi qiejt dhe tokën." Me këtë duhet kuptuar se Islami rivendosi rendin origjinal, "ed-din el-kajjim", si formë përfundimtare në agimin e fundit të kohës. Ky riintegrim e rikthen njeriun në shtatin e tij më të mirë, "fi ahseni takvim", të cilën ai e kishte përpara rënies së tij në më të ulët nivel, "esfele safilin".

Myslmanët me vendosmëri të kapen për litarin e Zotit, Kuranin, si një burim i pashtershëm i të gjitha dobive, bukurive dhe virtyeteve të qytetërimit me të cilat njeriu lartësohet në dynja dhe ahiret.

Të mirat e Zotit dhe dhuntitë e Tij, të krijuara për të gjithë, kanë shije dhe kuptim kur njerëzimi, i zhveshur nga paragjykimet, të hedhë shikimin drejt horizontit të besimit në njëshmërinë e Zotit, për të gjetur kthjelltësinë shpirtërore, duke harmonizuar marrëdhëniet me njerëzit në saje të një dashurie të thellë ndaj gjithë ekzistencës!

* Ligjëratë e mbajtur me rastin e manifestimit të festës së Kurbanit të Bajramit, në Xhaminë e Madhe (Sulltan Fatih), në Prishtinë, më 28.06.2023.

- 1 Tirmidhi, Muhamed bin Isa, *el xhami el kebir*, dar el garb el islamij, 4/265, nr.2486.
- 2 Muslim bin el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, pranimi i sadakasë prej fitimit të mirë (tajib), nr. 1015.
- 3 Shih: el Bekare: 168; el Maide: 88; el Enfal: 69; en Nahl: 114. Shih: el Gazali, Rīgiallërimi i shkencave fetare, 3/13.
- 4 Tirmidhi, Muhamed bin Isa, *el xhami el kebir*, dar el garb el islamij, 4/188, nr.2380, dhe të tjerë.
- 5 Muslim bin el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, kapitulli i ndalimit të padrejtësisë, nr. 2587.
- 6 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (dar iben Kethir, Damask, 2002), nr. 2750.
- 7 Ahmed bin Hanbel, *Musned Ahmed*, (i recensuar nën mbikëqyrjen e hoxhës Shuaib Arnauti), (muesseset er risale, 2001), nr.12902.
- 8 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, kapitulli fitimi i njeriut dhe puna me duart e tij, nr.2072.
- 9 Muslim bin el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, nr. 1955.
- 10 Muslim bin el Haxhaxh, *Sahih Muslim*, kapitulli i Imanit, nr. 47

Kalimi i Imam Tahaviut (v.321/933) nga medhhebi shafi në medhhebin hanefi

Blerton Bahtiri

Meqenëse Imam Tahaviu kishte lexuar dhe mësuar fikhun shafi dhe hanefi, kjo i dha atij lirinë e kritikës. Ai i studioi të dy medhhebet dhe vendosi t'i miratoj mendimet e medhhebit hanefi dhe si përfundim kaloi në medhhebin hanefi.

Imam Tahaviu r.a. i përkiste një familje që i përkiste medhhebit shafi. Babai i tij ishte dijetar, kurse nëna e tij merrte pjesë në ligjëratat e Imam Shafiut r.a.. Imam Muzeniu r.a., ishte daja i tij, por edhe mësuesi i parë nga i cili mësoi fikhun, ky i fundit ishte një nga nxënësit e veçantë të Imam Shafiut r.a..

Në kohën e Imam Tahaviut r.a. nuk ishte shumë e nevojshme të imitohej një medhhebi i caktuar, por rekomandohej që të shmangej imitimi, në mënyrë që të bëhej përpjekje për të gjetur atë më të saktën dhe të praktikohet më tepër ixhtihadi. Andaj, i gjen dijetarët në kohën e tij si muxhtehidë të vërtetë.

Ka pasur shumë dijetarë që kanë ndërruar medhhebin, ndërsa i përkisnin një medhhebi. Këtu dëshirojmë të përmendim disa prej tyre: Abdulaziz b. Imran el-Huzai (v. 234/848) dhe Ibën Dekik el-Ijd (v. 702/1302) ishin maliki, ata kaluan në medhhebin shafi. Muhamed b. Abdullah b. Abdilhakemi (v. 268/881) kaloi në medhhebin shafi derisa ishte maliki, por më vonë iu rikthye medhhebit maliki. Ebu Xhafer Muhamed b. Ahmed b. Nasr et-Tirmidhiu (v. 295/907) ishte hanefi, ai kaloi në medhehebin shafi. Po kështu, Hatib el-Bagdadi (v. 463/1070) kaloi në medhhebin shafi derisa më parë ishte hanbeli.¹

Në këtë kontekst, fakti që familja e tij ishte pjesëtare e medhebit shafi dhe se ai kishte ndryshuar medhhebin e tij edhe pse kishte studiuar medhhebin shafi deri në të njëzetat e tij dhe nga daja i tij, i cili ishte student i një juristi si Imam Shafi r.a., nuk është një situatë

e çuditshme duke marrë parasysh pikëpamjet medhhebore të asaj periudhe.

Në burime janë përmendur transmetime dhe interpretime të ndryshme lidhur me arsyet e kalimit të Imam Tahaviut r.a. nga medhebi shafi në medhhebin hanefi. Ne mund t'i rendisim këto transmetime si më poshtë:

1. Zemërimi i dajës së tij, Imam Muzeniut r.a. ndaj imam Tahaviut r.a. e zemëroi atë (Imam Tahaviun r.a.) dhe si pasojë kaloi në medhhebin hanefi.

Sipas Shirazit, Imam Tahaviu r.a. ishte nga medhhebi shafi dhe studioi te daja i tij, pra tek Imam Muzeniu r.a.. Një ditë, daja i tij u zemërua me të duke i thënë: “Të betohem që nuk doli asgjë nga ti”. I inatosur nga qortimi i dajës së tij, Imam Tahaviu r.a. la rrethin e tij të ligjëratave dhe kaloi në medhhebin hanefi. Imam Tahaviu r.a. ka marrë dituri edhe nga Kadi Ebu Hazim dhe Ebu Xhafer b. Ebi Imran. Kur mbaroi veprën “El-Muhtasar”, tha: “Allahu e mëshiroftë dajën tim! Nëse do të ishte gjallë, duhet të kishte dhënë shlyerjen për betimin që bëri (keffaret)”. Në disa burime thuhet gjithashtu se këtë e ka thënë kur është ngritur në nivelin e imamet në medhhebin hanefi dhe ka mbajtur ligjëratat ose ka zgjidhur një çështje të ndërlikuar.

Shirazi e ka transmetuar këtë ngjarje nga Ebu Abdullah el-Hasan b. Ali es-Sajmeri dhe ky nga Ebu Bekr Muhamed b. Musa el-Harezmi (v. 403/1012). Nëse e shikojmë në

detaje këtë transmetim do të konkludojmë se Harezmi nuk ka arritur ta mbërrijë Imam Tahaviun. Prandaj, ky tregim i transmetuar është një transmetim munkati.² Të njëjtën ngjarje e ka transmetuar edhe Silefi (v. 1180/576) nga Kuduri (v. 1036/428) me fjalët “Pasha Zotin, nuk ke përparuar”. Por edhe ky transmetim është mursel.³ Sepse ka një shkëputje mes Kudurit dhe Tahaviut për sa i përket senedit.⁴

Sipas Imam Kevtheriut r.a., i cili i vlerësoi transmetimet se Imam Tahaviu r.a. u largua nga rrethi i mësimave i zemëruar me thënien e Imam Muzeniut r.a.. “Betohem se nuk ka ardhur asgjë prej teje” ose “Betohem se nuk ke përparuar”: Deklarata e Imam Tahaviut r.a. “Po të ishte gjallë Muzeniu, do të duhej të bëhej shlyerja për betimin e tij” është një betim i përdorur në kohën e kaluar. Një betim i tillë përfshihet në pjesën jemini gamus⁵ ose jemini lagv⁶ të betimit, i cili nuk kërkon shlyerje. Nuk është e mundur që një person si Imam Tahaviu r.a. të mos i dijë kushtet e betimit të tij. Kjo tregon se këto transmetime nuk janë të sakta.⁷

2. Imam Tahaviu r.a. pa se Imam Muzeniu r.a. shpesh i shikonte veprat e Ebu Hanifes r.a. në çështje të vështira dhe ishte i ndikuar nga kjo dhe kaloi në medhhebin hanefi.

Ndërsa Ebu Ja’la el-Khalili foli për jetën e Imam Muzeniut r.a. në veprën e tij të quajtur “*El-Irshad*”, Muhamed b. Ahmed el-Shuruti e pyet Imam Tahaviun r.a. dhe i tha: “Pse e kundërshtove medhhebin e dajës tënd?”. Imam Tahaviu r.a. i tha: “E shihja vazhdimisht duke shikuar veprat e Ebu Hanifes r.a. dhe për këtë arsye kalova në medhhebin hanefi”⁸

Pëlqeva medhhebin dhe metodën e fukahave të Kufes. Dhe prej mendimeve të para që i kisha në lidhje me medhhebin shafi i lashë me një anë dhe kalova në medhhebin hanefi.

Pas rrëfimit të kësaj ngjarjeje, Temimi komenton se Imam Tahaviu r.a. nuk e ndërroi medhhebin e tij duke u inatosur me fjalën e mësuesit (dajës) të tij, përkundrazi, ai ndryshoi emërtimin e tij sepse ishte ndikuar nga fakti se ai preferonte herë pas here veprat dhe pikëpamjet e Ebu Hanifes r.a. pavarësisht nga fuqia shkencore si një studiues që ishte.⁹

3. Imam Tahaviu r.a. ishte prezent në mexhliset e fukahave hanefi në Egjipt dhe për këtë arsye ai filloi ta pëlqente medhhebin hanefi.

Meqenëse Imam Tahaviu kishte lexuar dhe mësuar fikhun shafi dhe hanefi, kjo i dha atij lirinë e kritikës. Ai i studioi të dy medhhebet dhe vendosi t’i miratoj mendimet e medhhebit hanefi dhe si përfundim kaloi në medhhebin hanefi.¹⁰

Jakut el-Hamavi citon fjalët e mëposhtme të Imam Tahaviut r.a. nga Ibën Junusi në veprën e tij “*Mu’xhemu-l-Buldan*” ku thotë: “Mësuesi im i parë nga i cili mora njohuri ishte Muzeniu. Prej tij mësova pikëpamjet e Imam Shafiut. Më vonë, Ibën Ebi Imran u emërua si gjykatës në Egjipt. Mësova njohuri

prej tij duke vazhduar në mësimet e tij. Pëlqeva medhhebin dhe metodën e fukahave të Kufes. Dhe prej mendimeve të para që i kisha në lidhje me medhhebin shafi i lashë me një anë dhe kalova në medhhebin hanefi.”¹¹

Ibën Ebi Imran ishte një person i virtytshëm. Kishte mësimet e fikhut dhe hadithit. Në këtë mexhli, çështjet e fikhut trajtoheshin sipas metodës hanefite, ku ai theksonte edhe pikëpamjet e medhhebeve dhe muxhtehidëve të tjerë. Ibën Ebi Imran, pas Hanefi Kadi Bekkar b. Kutejbe u emërua



gjykatës (kadi) i Egjiptit. Dija, morali, mirësjellja e Kadi Bekarit ishin në një nivel të lartë, saqë shumë njerëz u ndikuan nga ai, dhe kjo ndikoi shumë edhe tek Imam Tahaviu r.a.. Pra Kadi Bekkar ndikoi që Imam Tahaviu r.a. ta ndërroi edhe medhhebin. Për më tepër, Imam Tahaviu r.a. ka transmetuar edhe shumë hadithe prej tij. Prandaj, dituria, morali, devotshmëria dhe mirësia e këtyre dy dijetarëve mund të kenë ndikuar tek Imam Tahaviu r.a., ngase këta dy dijetarë patën një ndikim të madh në formimin e personalitetit shkencor të Imam Tahaviut r.a..¹²

4. Imam Tahaviu r.a. kishte vështirësi në kuptimin e medhhebit shafi dhe për shkak se e kishte më të lehtë medhhebin hanefi, kaloi në të.

Ibën Haxheri r.a. në librin e tij të titulluar “*Lisanu'l-Mizan*”, transmeton se Imam Muzeniu r.a. u zemërua me Imam Tahaviun r.a. sepse ai nuk kuptonte një çështje delikate, megjithëse e shpjegoi atë shumë herë, dhe si rrjedhojë Imam Tahaviu r.a. u zemërua dhe u largua nga rrethi i tij i ligjëratave.¹³

Imam Tahaviu r.a. ishte një student i njohur për inteligjencën, kuptimin e çështjeve dhe njohuritë e tij. Në këtë kontekst, nuk duket e mundur që Imam Tahaviu r.a. të mos e kuptojë çështjen pavarësisht se e ka përsëritur shumë herë hoxha i tij. Për më tepër, Imam Muzeniu r.a. ishte një person durimtar dhe studiues që mund t'i shpjegojë të njëjtën çështje një studenti inteligjent pa pushim.¹⁴

Imam Sujuti deklaroi se vështirësia e të kuptuarit të medhhebit të vjetër të një emërtimi mund të jetë një faktor kyç në kalimin e tij në medhhebin tjetër.¹⁵

Fakti që Ibën Haxheri dhe Sujuti i përkasin medhhebit shafi mendohet se një vlerësim i tillë i tyre mund të jetë më tepër emocional sesa bazik e real. Andaj, mendojmë se kanë shfaqur një kundërshtim medhhebor. Megjithatë Imam Muzeniu, vlerësohet dhe përmendet shumë në burimet hanefite, ai thuhet se shpeshherë i ka shikuar veprat e Ebu Hanifes, apo edhe të hanefive në përgjithësi, ndoshta në çështjet që kanë pasur mungesë trajtimesh brenda shkollës shafite, e kjo ndoshta ka ndikuar që edhe Tahaviu nuk ka mundur të marrë përgjigje adekuate nga hoxha i tij, Imam Muzeniu.

VLERËSIMI I TRANSMETIMEVE

Imam Tahaviu ishte jurist në nivelin e një “muxhtehidi në medhheb”. Deri në të njëzetat kishte studiuar nga babai dhe shumë mësues si Imam Muzeniu r.a. dhe kishte arritur një nivel të caktuar shkencor. Mirëpo, dashuria dhe vendosmëria e tij për të mësuar shkencën po shtohet dita-ditës dhe donte të mësonte diçka nga mësuesit që ndiqnin metoda të tjera. Pastaj filloi të përfshihej në rrethet e ligjëratave të juristëve hanefi. Këta mësues ishin studiues shumë kompetentë. Ata shpjegonin fikhun hanefi në krahasim me medhhebet etjera.

Me kalimin e kohës, edhe Imam Tahaviu r.a. kaloi në medhhebin hanefi.

Gjatë periudhës së Imam Tahaviut r.a., kalimi nga njëri medhheb në tjetrin konsiderohej krejt normale. Edhe në atë kohë kishte juristë që formuan medhhebin e tyre pa u lidhur me ndonjë imam dhe medhheb të caktuar. Po kështu, dihet se ka shumë çështje të fikhut në të cilat Ebu Jusufi r.a. dhe Imam Muhamedi r.a. kundërshtojnë Imam Ebu Hanifen r.a.. Në fakt, secili nga imamët e medhhebit themelues rekomandonin fuqishëm që ata të mos imitohen dhe të bëjnë ixhtihad nga dy burimet kryesore prej Kuranit dhe Sunetit.

Ne e shohim të dobishme të analizojmë transmetimet në lidhje me kalimin e Imam Tahaviut r.a. për shkak të zemërimit të hoxhës së tij Imam Muzeniut r.a.. Imam Tahaviu në atë kohë nuk ishte një djalë 5-6 vjeç, por një i ri rreth të njëzetave që mund t'i vlerësonte çështjet fikhere. Për këtë arsye, Imam Tahaviu r.a., për shkak të një fjale t'i reagoonte hoxhallarëve të tij është e pakuptimtë. Këto transmetime kanë ardhur nga rrugë të ndryshme. Nëse i bashkojmë të gjitha këto transmetime mund të hasim në një përfundim si ky: Mund të thuhet se Imam Tahaviu r.a. filloi të interesohej për medhhebin hanefi, për shkak se nuk mund të merrte përgjigje adekuate nga hoxha i tij në lidhje me medhhebin shafi. Filloi të merrte pjesë edhe në mexhliset e juristëve hanefi dhe në fund zemërimi i hoxhës së tij erdhi si përfundim deri te këputja e perit. Ndërrimi i medhhebit të Imam Tahaviut r.a. nuk qonte edhe shumë peshë, sepse kur ishte pyetur pse je ndarë nga hoxha yt, ai pyetjen e tillë e mori me rezerva. Realiteti është se ai ishte i fokusuar më tepër në kërkime shkencore e argumentuese, andaj përzgjedhja mes dy medhhebeve dhe vendimi për të kaluar në medhhebin hanefi ishte më tepër si rezultat i kërkimit të tij.

1 Karaman, Hayrettin, *İslam Hukukunda İctihad*, fq. 218-219.

2 Munkati: Me kuptimin i “ndërprerë”, që realisht përshkruan një hadith zinxhiri i transmetimit të të cilit është i ndërprerë në një pike. Nëse një rrëfyes në zinxhirin e transmetimit dihet se nuk ka dëgjuar kurrë rrëfime nga rrëfyesi tjetër në zinxhir, edhe pse ishin bashkë kohanik, hadithi në fjalë është quajtur munkati.

3 Mursel: Një mbiemëror i përdorur për të përshkruar një hadith zinxhiri i transmetimit të të cilit shkon deri te një tabiin.

4 Hadithi ka dy pjesë kryesore: senedi (lidhja e zinxhirit të transmetuesve) dhe metni (teksti, përmbajtja).

5 Jemini Gamus: “Një betim i qëllimshëm për dëshmi të rreme në lidhje me një ngjarje të kaluar.”

6 Jemini Lagv: “Një betim i bërë gabimisht ose duke menduar se është i/saktë dhe bën betimin.”

7 Kevtheri, *el-Havi*, fq. 16.

8 Ebu Ja'la el-Halili, *el-İrshad*, fq. 431.

9 Temimi, *Tabakatu's-Senijje*, fq. 50-51.

10 Keskioglu, Osman, *Fikih Tarihi ve İslam Hukuku*, fq. 119.

11 Hamevi, *Mu'xhemu'l-Buldan*, fq. 22.

12 Nezir Ahmed, Abdullah, *Ebu Xha'fer et-Tahvi*, fq. 82-83.

13 Ibën Haxher, *Lisanu'l-Mizan*, vëll. I, fq. ٢٢١-٢٢٠.

14 Nezir Ahmed, Abdullah, *Ebu Xha'fer et-Tahvi*, fq. 88-89.

15 Nezir Ahmed, Abdullah, *Ebu Xha'fer et-Tahvi*, fq. 86.

Familja e shëndoshë dhe tiparet e saj

Nehat Shehu

Familja është shpirti i shoqërisë, e cila na mban gjallë, ajo që ngërthen në vete dashurinë, përkrahjen dhe forcën për të vazhduar tutje. Andaj ne jemi të urdhëruar që këtë familje ta mbajmë të shëndoshë dhe të pastër nga çdo virus i cili i kanoset e që e rrezikon ekzistencën e saj, qoftë ai virus nga jashtë qoftë nga brenda vendit tonë. Ne në këtë shkrim do të mundohemi të tregojmë diçka lidhur me familjen e shëndoshë dhe tiparet e saj.

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME FAMILJA?

Familja me të drejtë konsiderohet thelbi i shoqërisë. Nga synimet kryesore të Islamit është edhe formimi i familjes së shëndoshë dhe të lumtur, e cila ngritët mbi parimet e pastra islame e të cilat burime kanë kuptimet kuranore dhe kuptimet e haditheve të profetit Muhamed a.s.. Nën ombrellën e kësaj familjeje

arrihen të gjitha synimet e jetës e që janë: qetësia shpirtërore, dashuria, mëshira e harmonia e ndërsjellë. Lidhur me këtë na informon Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë ku na thotë: “Dhe nga faktet e (madhërisë së) Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoj nga ju gratë tuaja, ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe krijoj mes jush dashuri dhe mëshirë.”¹

Pra, ato janë krijuar nga ne për ne, në mënyrë që të gjejmë prehje tek ato, prandaj dhe familja e shëndoshë është burimi i qetësisë shpirtërore, qetësi e cila po na mungon shumë kohëve të fundit, e që mungesa e kësaj qetësie manifestohet me këtë kaos moral e njerëzor, të cilin e kemi të pranishëm në shoqëri dhe i cili medoemos duhet të largohet.

I Gjithëdijsmi në ajetin 187 të sures El Bekare thotë: “Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato”², ajet që ilustron marrëdhëniet në relacionin bashkëshortor dhe përdorë

Si familje e shëndoshë, sipas Islamit, konsiderohet ajo familje, anëtarët e së cilës janë të lidhur për vlerat dhe parimet e larta të Islamit. Nën ombrellën e kësaj familjeje arrihen të gjitha synimet e jetës e që janë: qetësia shpirtërore, dashuria, mëshira e harmonia e ndërsjellë.



fjalën “libas”(petk), e cila fjalë përmendet në këtë ajet e që sipas komentatorëve të Kuranit ka kuptimin e mbrojtjes, bashkimit, afërsisë, ngrohtësisë, mbulojës dhe stolisë.

Si familje e shëndoshë, sipas Islamit, konsiderohet ajo familje, anëtarët e së cilës janë të lidhur për vlerat dhe parimet e larta të Islamit, vlera këto të cilat i kanë të mishëruara në veten e tyre, si dhe parimet të cilat i kanë pranuar si boshtin e tyre të ekzistencës dhe misionin e tyre jetik të cilin duhet ta përmbushin dhe duhet të jetojnë sipas tij. Ky mision dallohet me metodologjinë e tij të kthjelltë dhe rrugët e qarta, në sajë të së cilave synon arritjen deri te shembujt më të lartë dhe me anë të kësaj arritjeje, ai e mbanë gjithmonë familjen të shëndoshë dhe shembull se si duhet të jetë ajo.

Përveç atyre që i përmendëm më lartë, familja gjithashtu është edhe ai institucioni apo ajo medreseja, e cila sjell gjeneratën e re, aty fillon edukimi i një brezi të rinj, i cili është e ardhmja e shoqërisë dhe po ky brez është ai i cili do të udhëheqë nesër me shoqërinë tonë. Ky fakt i rëndësishëm, i cili u përmend, përveç se ka lidhje me familjen e shëndoshë është i ndërlidhur ngushtë edhe me shoqërinë e së nesërme, andaj rreziku i dështimit në këtë pikë na bën shumë skeptik lidhur me ardhmërinë tonë, sepse nëse ne

**Me anë të
familjes gjejmë
prehjen tonë,
mëshirën,
strehimin, e
mbështetjen
dhe ruajmë
shtimin e
popullsisë.**

dështojmë këtu atëherë kemi dështuar në zhvillimin dhe formimin e gjeneratës së re në të cilën është ardhmëria jonë. Për këtë arsye ne duhet të kujdesemi vazhdimisht për familjen tonë e të mos e lëmë atë të përfundojë në humnerat e epsheve dhe në ujërat e thella të injorancës.

Kjo familje e shëndoshë ka edhe tiparet e saja me anë të së cilave mund të kuptohet më lehtë formimi i saj, tipare të cilat duhet të synohen dhe të praktikohen nga të gjithë, në mënyrë që të arrijmë te një rezultat i nevojshëm e i shumë dëshiruar. Ndër to mund të përmendim:

1. Kuptimi i drejtë i martesës;
2. Njohja e të drejtave dhe obligimeve bashkëshortore;
3. Kuptimi i të drejtave të fëmijëve dhe obligimeve të prindërve ndaj tyre;
4. Komunikimi me anëtarët e familjes;
5. Praktimi i shembullit të Pejgamberit a.s. si bash-këshort dhe baba.

KUPTIMI I DREJTË I MARTESËS

Martesa në Islam ka rëndësi të veçantë, e cila ngërthen në vete natyrshmërinë me të cilën Allahu e ka krijuar njeriun. Ai në shpirtin e burrit ka krijuar nevojën për grua dhe në



shpirtin e gruas ka krijuar nevojën për burrë, pra kjo lidhje buron nga realiteti dhe nevoja, me të cilin njeriu përshtatet në mënyrë të përsosur dhe njëri-tjetri e gjejnë prehjen që Allahu e përmendi në ajetin e mësipërm. Gjithashtu rëndësia e martesës është edhe në faktin e ruajtjes dhe mbajtjes gjallë të njeriut si qenie. Prandaj si e tillë, familja bashkon këto dy tipare dhe me anë të familjes gjejmë prehjen tonë, mëshirën, strehimin, e mbështetjen dhe ruajmë shtimin e popullsisë.³

Islami me dritën e argumentit të tij largoi të gjitha kuptimet e gabuara të martesës, aty ku gruaja konsiderohej thjesht si një mjet kënaqësie për burrin e saj apo vetëm një shërbëtore në shtëpinë e tij, si dhe mendimin e gabuar të murgërisë, duke treguar që kjo nuk ka lidhje me natyrshmërinë e njeriut. Në anën tjetër, Islami nxiti me ngulm për martesë, sepse ai e konsideron atë si një nga faktet dhe argumentet e Allahut në gjithësi. Kur jemi në këtë temë, nuk mundemi të mos e përmendim shembullin e disa sahabëve, të cilët deshën të privoheshin nga martesa e t'i përkustoheshin totalisht adhurimit, duke agjëruar ditën, e falur gjithë natën. Për këtë qëllim shkuan dhe e pyetën Pejgamberin a.s., e ai u përgjigj duke thënë: “Për sa më përket mua, unë agjëroj dhe ha, falem dhe fle, si dhe martohem. Kush e refuzon rrugën time ai nuk është prej meje.”⁴ Pra Pejgamberi a.s. e refuzoi një mendim të tillë.⁵ Ky pra mund të thuhet se është kuptimi i drejtë i martesës sipas Islamit.

NJOHJA E TË DREJTAVE DHE OBLIGIMEVE BASHKËSHORTORE

Edhe ky tipar është ndër më të rëndësishmit për një familje të shëndoshë.

Ndër këto të drejta dhe obligime mund të përmendim:

a) Detyrimi i parë ndaj bashkëshortes është dhënia e mehrit (dhuratës) si shenjë për dëshirën konkrete për martesë. Këtë dhuratë Islami ia ka garantuar gruas si të drejtë të saj, të cilën nuk ia cenon askush. Lidhur me këtë, Allahu në Kuranin e madhëruar thotë: “Dhe jepuni me gjithë zemër grave tuaja dhuratën e kurorëzimit.”⁶

b) Detyrimi i dytë është shpenzimi për bashkëshorten. Burri ka për detyrë të sigurojë ushqimin, veshjen, banimin dhe mjekimin për ato. Lidhur me këtë, Allahu në Kuran thotë: “Pasaniku le të shpenzojë sipas pasurisë që ka, ndërsa i varfëri le të shpenzojë sipas asaj që i ka dhënë Allahu; Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive që i ka dhënë.”⁷

Mos të harrojmë që familja është shpresa e cila na mbanë gjallë, andaj duhet që me të gjitha forcat të mos e lejojmë që kjo shpresë të shuhet.

c) Detyrimi i tretë është bashkëjetesa e mirë, lidhur me të cilën Islami ka urdhëruar e për të cilën Allahu ka thënë: “Jetoni e silluni mirë me to (gratë).”⁸

ç) Detyrimi i katërt është bindja ndaj bashkëshortit, ashtu siç burri ka detyrimet ndaj gruas së tij, edhe bindja e gruas ndaj tij është njëra nga detyrimet që i ka ajo.⁹

d) Detyrimi i pestë është se nuk i lejohet gruas që ta fus në shtëpi dikë që burri e urren.

e) Detyrimi i gjashtë është ndalimi i dhunës së gruas dhe mbrojtjes së nderit dhe dinjitetit të saj.¹⁰

f) Detyrimi i shtatë është njohja e atësisë së fëmijëve dhe trashëgimi i ndërsjellët.¹¹

KUPTIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE DHE OBLIGIMET E PRINDËRVE NDAJ TYRE

Do të ishte më në interes që të flasim më tepër për të drejtat dhe obligimet të cilat ndoshta shpesh nuk diskutohen, e të cilat

janë:

a) Trajtimi i tyre me butësi;

b) Dhurimi i një shembulli të mirë për ta;

c) Ruajtja e natyrshmërisë dhe ndërgjegjes së pastër të fëmijës;¹²

ç) Trajtimi i barabartë i fëmijëve, të cilën prindërit duhet ta kenë patjetër posaçërisht kur bëhet fjalë për dhënien e dhuratave, ngase kjo lind xheloz, e cila mund të shkaktojë armiqësi dhe urrejtje midis tyre.¹³

Mbi të gjitha këto në rend të parë është edukimi i tyre në frymën islame, duke mos anashkaluar edhe obligimet e vendbanimit, ushqimit, veshmbathjes, të cilat veçse i dimë.

KOMUNIKIMI ME ANËTARËT E FAMILJES

Ky komunikim është çelësi i një marrëdhënie të shëndoshë mes prindërve në njërin anë dhe fëmijëve në anën tjetër, prandaj ne si prindër pos që duhet të komunikojmë mes vete për t'i zgjidhur problemet tona, duhet të kemi konsideratën dhe mirëkuptimin që të flasim edhe me fëmijët tanë, sepse fjalët e tyre janë të vërteta dhe të sinqerta edhe pse shpeshherë neve na duken se këto fjalë janë të pa baza dhe të kota. Prandaj në momentin që i dëgjojmë dhe komunikojmë me ata, ne jo vetëm që e zgjidhim problemin brenda familjes, mirëpo kontribuojmë në rritjen e personalitetit të fëmijëve tanë, sepse me dëgjimin dhe komunikimin me ata, ne i bëjmë të besojnë se ata janë të rëndësishëm dhe të vlefshëm në perceptimet e tyre. Në vazhdim do t'i përmendim disa fakte të cilat na ndihmojnë në këtë aspekt:

- T'ua rikujtojmë fëmijëve se Zoti ua ka dhuruar dy vesh dhe një gjuhë, pra duhet të dëgjojnë dy herë para se të flasin një herë;
- Të flasim me fëmijët dhe t'u kushtojmë vëmendjen e duhur gjatë diskutimit;
- Të jemi më durimtarë e mos t'ia ndërprejmë fjalën;
- Kur të flasim me ta, ta shikojmë drejt në sy;
- Të mos e qortojmë për gabimet që i bën, mirëpo gabimet t'i rregullojmë së bashku me ta;
- Ta bëjmë fëmijën pjesë të një problemi që kemi dhe të kërkojmë mendim prej tij për zgjidhjen e atij problemi;
- Të interesohemi më tepër për fëmijët, se si i ka punët në shkollë me shokët, mësuesit dhe rrethin në të cilin gjenden;
- Lënia e të gjitha punëve anash përderisa flasim me fëmijët.

Këto janë disa nga ato që mund të na ndihmojnë në lidhje me komunikimin tonë me fëmijët e po ashtu shumica prej tyre vlejnë edhe për qiftin bashkëshortor. Në momentin e përmbushjes së tyre, ne sigurojmë një komunikim të mirëfilltë, i cili është çelësi për një familje të shëndoshë.

PRAKTIKI I SHEMBULLIT TË PEJGAMBERIT A.S. SI BASHKËSHORT DHE BABA

Nga të gjitha këto tipare të cilat u sqaruan më lartë, profetin Muhamed a.s. e kemi shembullin më të mirë me të cilin e ndriçojmë rrugën tonë. Ai është shëmbëlltyrë dhe model në familje. Ai ishte që e kuptoi në mënyrë perfekte kuptimin e fjalës martesë, ndonëse ishte shumë i zënë me të gjitha aktivitetet e tij të panumërta, ishte ai i cili më së miri e jetësonte atë që quhej jetë bashkëshortore duke i ditur dhe praktikuar të drejtat dhe obligimet bashkëshortore. Ishte pikërisht ky profet i cili u dërgua si mëshirë për gjithë botët, që kishte kuptuar më së miri kuptimin e të qenët prind, duke i respektuar në përpikëri të drejtat e fëmijëve dhe duke i kryer obligimet e tij si prind ndaj tyre. Ky Pejgamber, i cili ishte edhe udhëheqës shteti në të njëjtën kohë, ndalej dhe komunikonte në mënyrën më serioze të mundshme me një fëmijë, pavarësisht moshës së tij që kishte. Shembull për këtë është biseda e tij me një fëmijë të cilit i kishte ngordhur bilbili i tij. Kjo sa i përket marrëdhënies së tij me fëmijët, mirëpo nuk duhet lënë pa përmendur edhe sjelljen e tij karshi bashkëshortes, ku ai bënte gara vrapimi me Aishen r.a., e që

Suksesi nuk mund të jetë sukses nëse nuk është gjithëpërfshirës, sepse njeriu mund të jetë i suksesshëm në famë, pushtet apo pasuri, mirëpo kjo nuk është asgjë nëse ka dështuar në atë që quhet familje.

kur kjo e fundit e pyeste atë se çfarë dashurie ndjen ndaj meje, Pejgamberi a.s. i thoshte se është sikurse nyja e litarit, një nyje e cila nuk zgjidhet. Ndonëse kalonte kohë, Aisheja r.a. prapë e pyeste cila është gjendja e nyjës, duke aluduar në dashurinë e tij ndaj saj. Pejgamberi a.s. përgjigjej duke thënë se nyja është në gjendjen e njëjtë. Ky ishte shembulli i Pejgamberit a.s., i cili edhe pse ishte profet i një populli dhe thirrësi më i rëndësishëm në jetë, ai ishte një bashkëshort i suksesshëm dhe një baba shembullor.

Ky Pejgamber me veprimet e tij na tregoi që miqësia dhe dashuria mes tij dhe bashkëshorteve, po ashtu edhe fëmijëve, janë në nivelin më të lartë dhe se me mirëkuptim, miqësi, dashuri e prehje njeriu jeton një jetë të mirë.

Jeta është e shkurtër andaj nuk ia vlen ta kalojmë atë duke u grindur e hidhëruar mes vete, ngase kjo lirisht mund të konsiderohet si nëpërkëmbje e një mirësie, të cilën Allahu na ka dhënë e që quhet familje.

Në fund themi që suksesi nuk mund të jetë sukses nëse nuk është gjithëpërfshirës, sepse njeriu mund të jetë i suksesshëm në famë, pushtet apo pasuri, mirëpo kjo nuk është asgjë nëse ka dështuar në atë që quhet familje. Prandaj them me bindje që suksesi

nuk mund të quhet i tillë nëse nuk e përfshinë këtë thesar që Allahu e la si amanet për ne. Mos të harrojmë që familja është shpresa e cila na mbanë gjallë, andaj duhet që me të gjitha forcat të mos e lejojmë që kjo shpresë të shuhet. Jemi të vetëdijshëm që rrethanat janë të vështira e pengesat të shumta, mirëpo ndriçimi i argumenteve të Islamit e bën rrugën të lehtë për ta kaluar, mjafton që vetëm të mos largohemi nga kjo fe.

1 Err Rrum, 21, përkthimi i Hasan Nahit.

2 El Bekare, 187.

3 Ahmed Umer Hashim, *El Usra Fi El Islam*, fq. 54.

4 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih i Buhari* (50631)| Muslim bin Haxhaxh, *Sahih el Muslim* (1401)

5 Jusuf el Kardavi, *Melami El Muxhteme El Muslimu El-ledhi Nunshiduhu*, fq. 331.

6 En Nisa, 4.

7 Et Talak, 7.

8 En Nisa, 19.

9 Talat Abdul Gafur Hasen, *Ahval Shahsije lil Muslimin*, fq. 202.

10 Dr. Zekeriya Guler, *40 Hadiste Kadin ve Aile*, fq. 39.

11 Talat Abdul Gafur Hasen, *Ahval Shahsije lil Muslimin*, fq. 216.

12 Huda Mahmud Nashid, *El Usra we terbijetu et-tifl*, fq. 44-45.

13 Jusuf el Kardavi, *El Halalu wel Haramu fil Islam*, fq. 262-263.

Pse nxënësit e shohin si sfidë studimin e shkencave?

Vaxhide Spahiu

Agravimi aktual në çdo sferë të jetës është shqetësues, në të vërtetë duhet të përbëjë shqetësim për çdo person që di të ndalojë shapin nga sheqeri. Personalisht do të ndaloj në pikën që mendoj se e sjell agravimin e fushës të cilën e konsideroj timen, edukimi. Dhe kjo jo vetëm për faktin që është fusha ime, por e konsideroj si fushë kyçe, përgjegjëse për mbarë ose mosmbarëvajtjen e fushave të tjera.

Jam një partizane e mendimit që një situatë e tillë mund të korrigjohet, por si fillim na duhet të identifikojmë “fajtorët”. Ky është qëllimi për të cilin unë vendosa ta strukturoj këtë punim, në të cilin shpalosen disa fakte konkrete se pse nxënësit nuk janë dashamirës të shkencave, si dhe kush janë disa nga përgjegjësit për këtë jo dashamirësi.

Do të ndaj me juve po ashtu disa eksperiencat personale, një studim të bërë mbi rezultatet e binjakëve të shkollës “International Maarif Schools of Kosova”¹. Gjithashtu do të shpalos shkurtimisht një analizë të një ankete të bërë me nxënësit nga klasa VI deri XII të po kësaj shkolle. Si dhe në fund fare do të përpiqem të vë pikat mbi i, nëse përgjegjës për nivelin tonë akademik janë gjenet apo faktorët mjedisorë.

1. Eksperiencat dhe pengesat e mia si mësimdhënëse e fizikës në këto kohë vërtet spekulatore, ku qëllimi më madhor i secilit prej nesh është të bëjmë një status të denjë i cili thyen rekordin e pëlqimeve.

Me dëshirën e madhe që të qartësoj disa nga pikëpyetjet e shumta që më mundojnë prej që jam pjesë aktive e sistemit edukativo - arsimor do të bëj një përpjekje për t'i vënë

disa konture logjike pyetjes se: Pse nxënësit e shohin si sfidë studimin e shkencave?

Një e vërtetë jo fort e këndshme më kthen mbrapsht në retrospektivë dhe në sekuenca të ndryshme e shoh veten në situata që i konsideroj dështim. Qoftë ky i fundit imi, i politikave të shkollave në të cilat kam qenë pjesë apo i sistemeve dhe strategjive të ministrive përkatëse.

Konkretisht ja disa prej këtyre situatave:

- “Arsimtare hiç s'ma kap fizikën”; - “Fjala shkencë nuk më shkon për shtat”; - “Për çfarë do të më shërbejë ligji i Bernulit në të ardhmen?” - “Mos më mundo arsimtare, thjesht nuk e kuptoj dhe sado që të përpiqem përsëri nuk e kuptoj.”

Këto sentenca të dala me shumë sinjeritet nga goja e nxënësve të mi të dashur vërtetë më ngufatin...


Këtë çështje dëshiroj ta kanalizoj në tri drejtime:

Së pari: nxënësit kanë një tendencë, sigurisht të kultivuar jo të natyrshme, për t'u marrë me atë çfarë ato e konsiderojnë si më të lehtë. Në perceptimin e tyre termi “shkencë” nuk konsiderohet i tillë, përkundrazi i bën ato të zbrapsen dhe të druhen. Është fakt se shkencat nuk futen në kategorinë e disiplinave të “lehta”, e kjo është arsyeja kryesore pse nxënësit e shohin si sfidë studimin e tyre. Ato vështirësohen akoma më shumë nëse njohuritë në disiplinat fqinje janë të dobëta.

Së dyti, lind pyetja: Si t'ua shpjegojmë atyre se shkencat nuk janë të vështira, përkundrazi. Shumë do të doja që të kuptonin

Nxënësit kanë një tendencë, sigurisht të kultivuar jo të natyrshme, për t'u marrë me atë çfarë ato e konsiderojnë si më të lehtë. Në perceptimin e tyre termi “shkencë” nuk konsiderohet i tillë, përkundrazi i bën ato të zbrapsen dhe të druhen.

SA JU PELQEN FIZIKA



se, njëra nga mënyrat për të larguar ndryshkun nga ingranazhet e trurit është pikërisht, studimi i shkencave. Në momentin që arrihet një gjë e tillë, rrjedhojë e padiskutueshme është, se çdo gjë bëhet lehtësisht e kapshme dhe e perceptueshme.

Dhe së fundi, në të vërtetë një tendencë e këtij lloji shfaqet edhe te të rriturit të cilët kanë një pjekuri më të madhe dhe dinë të dallojnë gjërat që vërtetë çojnë peshë. E gjitha kjo për arsyen e thjeshtë se jetojmë në një periudhë kur çdo gjë duhet të merret e gatshme, në formën më të lehtë të mundshme. E përgjigja e pyetjes nëse ajo vlen diçka, nuk i intereson askujt. Pra ne i mohojmë vetes kënaqësinë e të shijuarit gjërat e “vështira” dhe hamë sapunin për djathë me vetë dëshirë, duke shijuar pseudo arritjet me gjëra gjysmë të gatshme të servuara në format më të lehta të mundshme, e thënë ndryshe të servuara nga rrugë “qorre”.

2. A janë gjenet tona përgjegjëse për arritjet tona akademike?

Sigurisht, për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje nuk mund të mjaftohem me faktin se mua si pedagoge më pëlqejnë shkencat, sepse babai im është shumë i mirë në matematikë, në kohë rekord konverton një monedhë në një tjetër dhe atë me qindarka.

Në mënyrë që të jemi sa më koncizë, ne duhet të deklarojmë një fitues në betejën e

pashmangshme “Nature vs Nurture”. Sa e lehtë është një gjë e tillë? Aspak! Pra, dilema nëse gjenet tona kanë ndikim në arritjet tona akademike me shumë gjasa do të vazhdojë të mbetet një dilemë. Kjo për arsyen e thjeshtë se për secilin faktor ne mund të japim një pafundësi argumentesh bindëse. Që do të thotë se asnjërin prej tyre nuk e hedhim dot poshtë, për sa kohë ekziston qoftë edhe një kundër – argument. Një gjë e tillë e përforcon edhe fakti se: Në matematikë, për të hedhur poshtë një teori mjafton një kundër shembull.

Shumë prej nesh janë dëshmitarë të rasteve kur familje të caktuara brez pas brezi kanë nxjerrë kuadro të larta, që i kanë kontribuar vendit në fusha të ndryshme, në formën më exemplare. E në raste të tilla, na duhet të “falënderojmë” gjenet për këtë. Ana tjetër e së njëjtës medalje dëshmon se mund të “bashkëpunojmë” me gjenet si dhe t'i “mposhtim” ato edhe nëse janë në kundërvajtje me qëllimin tonë. Një gjë e tillë mund të mbajë emrin, teknikën e duhura, punë e palodhshme, stil i duhur jetese, ambient favorizues për punë, qëllime të qarta, ambicie, këmbëngulje, qoftë edhe prindër ose edukatorë rigorozë.

3. Shpalosje dhe analizë e çështjes në fjalë në nivel botëror

Në vitin 2015 janë dhënë rezultatet e 61 studimeve të bëra në lidhje me këtë çështje në 7 shtete të ndryshme: ShBA, Skandinavi, Angli, Australi, Kinë, Holandë, Zelandë e Re. Në këto studime ku u përfshinë 5330 palë binjakë monozygotë dhe 7084 palë binjakë dyzygotë u konkludua se: %66 e arritjeve akademike ishin falë gjeneve dhe pjesa tjetër prej %34 ishin falë faktorëve të mjedisit. Prej këtyre të fundit, %12 ishin efekte mjedisore gjenerale ose të përgjithshme dhe %22 kishin shkak faktorë specifik mjedisorë.²

4. Analizë e “Twin method” në shkollën “International Maarif Schools of Kosova”

Nga një analizë e hollësishme e nivelit të performancës së binjakëve në shkollën IMSK, vihet re se niveli i arritjeve të binjakëve qofshin ato mono apo dyzygotë të së njëjtës gjini është shumë i përafërt. Veçanërisht nëse fëmijët i përkasin nivelit fillor, rezultatet e tyre janë thuajse identike. Diferenca ndërmjet tyre është e papërfillshme, 2-5 pikë në teste dhe çuditërisht kjo diferencë është e alternuar, herë njëri dhe herë tjetri janë në avancë ndaj njëri – tjetrit me një numër të vogël pikësh. Në binjakët e gjinive të ndryshme, diferenca në rezultate është më e ndjeshme, ajo thellohet më tej nëse bëhet fjalë për

Nga një analizë e hollësishme e nivelit të performancës së binjakëve në shkollën IMSK, vihet re se niveli i arritjeve të binjakëve qofshin ato mono apo dyzygotë të së njëjtës gjini është shumë i përafërt. Veçanërisht nëse fëmijët i përkasin nivelit fillor, rezultatet e tyre janë thuajse identike.

gjimnazistë. Në ciklin fillor, gjinia mashkullore kanë një performancë më të lartë, totalisht e kundërta ndodh në ciklin e mesëm të ulët dhe të lartë. Në këto cikle, gjinia mashkullore ndajnë rezultate shumë më të dobëta se binjakja e tyre. Ky fakt më nxit të gjykoj se vërtet efekti i faktorëve mjedisorë jo vetëm që është i paneglizhueshëm, por bëhet determinant në nivelin e mesëm të lartë. Pra kur nxënësit janë të një moshe të vogël, faktorët gjenetikë e tregojnë lirshëm potencën e tyre, por në momentin e parë që faktorët mjedisorë depërtojnë mjaftueshëm situata konvertohet në favor të këtyre të fundit. Si rrjedhojë triumfi ju mbetet atyre. E nëse analiza bëhet mbi ciklin e plotë të historisë akademike të binjakëve, të dy këto faktorë i ndërrojnë rolet mes veti ashtu sikurse dhe binjakët sjelljet e tyre.

5. Paraqitje e rezultateve të një ankete në të cilën nxënësit tregojnë arsyet pse nuk ju pëlqejnë shkencat, nëse i përkasin kësaj kategorie

Nga të dhënat e marra nga një anketë e realizuar në shkollën “International Maarif Schools of Kosova” vihet re një fakt interesant, më shumë se 50% e nxënësve të anketuar deklarojnë se ata janë mesatarisht të kënaqur me rezultatet e tyre, ndërsa për çudi prindërit janë shumë të kënaqur me po të njëjtat rezultate. Kjo na shpalos një tjetër kontradiktë po interesante. Cila është arsyeja për të cilën një i rritur (prindi) qenka më i kënaqur se sa një fëmijë (nxënësi) me arritjet e këtij të fundit?

Kjo gjë na lë hapësira për dy ide të qëndrueshme:

- Prindi është aq shumë i angazhuar dhe i përfshirë në dallgët e përpjekjeve që arritjet e tij të jenë maksimale sa që nuk po mundet as të analizojë dhe as të evokojë saktë arritjet e fëmijës.

- Për shkak të rrethanave në të cilat po jetojmë dhe trendëve të fundit, niveli i pritshmërisë së prindit ndaj nxënësit ka rënë më poshtë se sa pritshmëritë e vetë nxënësit për veten. Cilado që të jetë arsyeja ky fakt na ekspozon drejt një situatë jostabile. Këtë jostabilitet e krijon “kulmi” me emrin prind në këto kushte i paqëndrueshëm, i trekëndëshit prind-nxënë-mësues.

Në të njëjtën anketë pyetjes: Si e shikoni ju lëndën e fizikës?

23% e nxënësve përgjigjen se lënda e fizikës për ta është e pakapshme, pra shumë e vështirë, 56% si lëndë interesante

Nga studimi i
bërë në shkollë
mes binjakëve
vihet re se
binjakët identikë
kanë rezultate
më të përafërta
se sa ato
joidenetikë, kjo e
dhënë na
detyron të
konkludojmë se
gjenet janë ato që
i vënë “vulën”
shkallës sonë të
performancës në
aspektin
akademik.

dhe 17% si lëndë e bezdisshme. Në këto kushte nëse 56% të nxënësve një lëndë shkencore e shikojnë si lëndë interesante, përse atëherë rezultatet nuk janë të kënaqshme? Në perspektivën e mësimdhënësës së fizikës e shtroj këtë pyetje. Konstatohet se në raste të tilla, një pjesë të nxënësve gjenet po ju likan hapësira të kuptojnë se fizika si lëndë shkencore qenka interesante, por vetëm kaq ama ...

Më duhet të ndaj edhe një detaj tjetër që evidentohet nga anketa, 17% të nxënësve të mi nuk denjojnë të shprehin sinqerisht faktin se nuk ju pëlqen fizika aspak, 46% pohojnë se ju pëlqen mesatarisht dhe 37% shumë. Në të vërtetë entuziazmin e fillimit të orës së fizikës nuk e shoh në sytë e 37% të nxënësve të mi. Mos vallë këta nxënës “çalojnë” edhe në një pikë tjetër, duhet të mësojnë të kenë një raport përgjegjshmërie ndaj asaj çfarë duan, si ta arrijnë atë dhe si ta shprehin pëlqimin ose mospëlqimin ndaj saj. Nëse vlen një gjë e tillë pse ekziston ky 37%?

6. Rezultati i studimit

Nga studimi i bërë në shkollë mes binjakëve vihet re se binjakët identikë kanë rezultate më të përafërta se sa ato joidenetikë, kjo e dhënë na detyron të konkludojmë se gjenet janë ato që i vënë “vulën” shkallës sonë të performancës në aspektin akademik. Po ashtu duke qenë se

edhe ajo pjesa gjenetike përgjegjëse ndryshon nga binjakët e një familje në të një familje tjetër, do të thotë se gjenet nuk e kanë totalisht të lirë terrenin për të vepruar mbi arritjet tona. Pa dyshim oponenca i servohet nga faktorët mjedisorë.

Nëse binjakët monozigotë tregojnë më shumë ngjashmëri në një tipar të caktuar në krahasim me binjakët dyzigotë, kjo siguron dëshmi se gjenet janë përgjegjës për atë tipar. Sidoqoftë, nëse binjakët monozigotë dhe dyzigotë ndajnë një tipar në një masë të barabartë, ka të ngjarë që mjedisi të ndikojë në këtë tipar më shumë sesa faktorët gjenetikë.

Përfundimisht mendimet dhe gjykimet e mia vazhdojnë të mbeten në një rreth vicioz dhe përsëri më lind pyetja këtë dilemë po ma shkaktojnë rrethanat në të cilat ndodhem apo gjenet e mia?!

1 Kolegj turk me një kredibilitet të padiskutueshëm, i cili prej vitit 2017 kontribuon në edukimin e të rinjve në Kosovë.

2 <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fgene.2017.00160/full>

Një trajtesë modeste mbi veprën “Rilindja e shkencave fetare”¹

Mulaim Shehu

“Rilindja e shkencave fetare”, është vepra më e vëllimshme dhe më e rëndësishme e Gazaliut, që përfshin analiza të përkryera të tekstit kuranor dhe të hadithit si dhe dituritë fetare-shkencore, veçmas nga periudha e hershme islame.

Autor i kësaj vepre të vëllimshme është Ebu Hamid el Gazaliu, i cili ka shkruar mbi 200 libra, përkundër se ai kishte një jetë të shkurtër (450-501h.) (1059-1111), që dëshmon se ai kishte prirje veçmas në shkrime të tematikave të llojllojshme! Andaj, këtu duam të theksojmë, se atëbotë kur ai ishte student në vitin e parë të dijetari i famshëm El Xhujeni (419-478 h. 1028-1085), të cilit ia dorëzon një libër të shkruar, e kur profesori e merr librin, fillon të shikojë titullin dhe përmbajtjen e tij me një kureshtje të madhe, më pas duke e shikuar Gazaliun, i thotë me mirëkuptim: “Po, ç’u desh pikërisht tash ta shkruash këtë libër, sepse ti kështu më mbyte mua, para se unë të vdes?!” Prandaj, kjo ishte një dëshmi se Gazaliu, atëbotë, më pas ishte asistent i tij në atë Akademi! Mirëpo, ne tani do të shkruajmë në mënyrë koncize, meqë vepra “Rilindja e shkencave fetare”² me nëntë vëllimet e saj përfshin 4286 faqe, të autorit Ebu Hamid el Gazali, e përkthyer prej gjuhës boshnjake nga dr. Ali Iljazi (r.p.). Këtu, po ashtu duam të theksojmë mendimin e dr. Enes Kariq³, ligjërues në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, kur thotë: “Falënderimi i qoftë Allahut, që Gazaliu nuk e ka titulluar këtë vepër “Rilindja e fesë”, por e ka titulluar “Rilindja e shkencave fetare”. Kështu “Rilindja e shkencave fetare”, është vepra më e vëllimshme dhe më e rëndësishme e tij, që përfshin analiza të përkryera të tekstit kuranor dhe të hadithit si dhe dituritë fetare-shkencore, veçmas nga periudha e hershme islame, shkollat e para fetare-akaidike, sheriatiko-juridike, si dhe drejtimit e themeluesve të tyre.



Mirëpo, para se të shkruajmë për “Rilindjen e shkencave fetare” duam të theksojmë shkurt nga disa vepra të Gazaliut lidhur me tri llojet e diturisë sipas tij:

- a - Dituria apo shkenca, që mund të fitohet vetëm nëpërmjet dëgjimit dhe mësimi;
- b - Dituritë apo shkencat intelektuale, spekulative;
- c - Dituritë, njohuritë fetare dhe juridike.

Duke shpjeguar llojin e parë të diturive dhe shkencave, Gazaliu pohon se këto arrihen vetëm duke dëgjuar dhe duke mësuar tregime për ngjarjet e kaluara, mrekullitë e të dërguarve, ngjarjet në Ditën e Gjykimit dhe jetën në Botën e Përtejme. Gazaliu shton se këtë lloj të diturisë e kuptojmë ekskluzivisht nga të dërguarit e pagabueshëm.

Sipas Gazaliut, lloji i dytë i diturive dhe shkencës janë teorike dhe spekulative. Në vetë natyrën e njeriut për këto lloje të diturive nuk ekzistojnë prova, “por këto shkenca-kjo dituri, patjetër duhet mësuar, jo për atë që verbërisht të imitojë mësuesin, por duhet që mësuesi të tregojë rrugën e sigurt deri në ato shkenca...” Me këtë Gazaliu dëshiron të tregojë se shkencat teorike-spekulative nuk janë kushtimisht etike apo morale. Ndaj, ai tekstualisht thotë se ky lloj i shkencës është jorelativ...

Më pas, Gazaliu shpjegon llojin e tretë të diturisë dhe shkencës, dhe thotë se ato janë “shkenca fetare-juridike; që merren me njohuri lidhur me të lejuarat dhe të ndaluarat, obligimet e prera dhe detyrat rekomanduese, meqë burim i këtyre diturive është Ligdhënësi”.

Mirëpo në “El Munkidh mined-dalal”⁴, Gazaliu tregon diçka më gjerë në ndarjen e shkencës. Ai pohon se këtë ndarje të shkencës në grupe e mbështetin filozofët siç vijon:

a. matematikë, b. logjikë, c. natyrë, d. metafizikë, e. politikë, dhe f. etikë.

Në vepra të tjera të tij, mësojmë nga Gazaliu edhe disa dituri dhe shkenca të tjera të përgjithshme si p.sh. në veprën “Er Risaletul-ledunijet”, ai thotë se dituria njerëzore arrihet në dy mënyra; “Mësimi njerëzor dhe mësimi hyjnor”. Kështu, nëse ky pohim i Gazaliut qartësohet në kontekstin e “Rilindja e shkencave fetare”, atëherë duhet të themi se gjithë atë që ka trajtuar dhe ka prezantuar Gazaliu në kryeveprën e tij shkon sipas “Mësimi njerëzor dhe mësimi hyjnor”. Kështu, lexuesi i aftë, i shkathët dhe vizionar i këtij opusi përherë është në gjendje të zbulojë se cila pjesë nga kjo vepër është shkruar me të parën dhe cila është shkruar me të dytën. Megjithatë, të shtojmë se “Rilindja e shkencave fetare”, është një shkrim i ndërtimit tok të të dyjave. Gazaliu në shumë vepra të tij e përmend “Rilindja e shkencave fetare” dhe ka dëshiruar që kjo vepër të jetë indikator impulsiv i rilindjes fetare, gjegjësisht i rilindjes së shkencave islame për mbarë myslimanët, në të katër anët e botës. Andaj, nuk njohim ndonjë mendimtar që ka lënë aq ndikim të thellë te myslimanët, ashtu siç ka bërë Gazaliu, përkundër asaj që nuk ishte themelues i ndonjë medhhebi-shkolle të caktuar! Kështu, veprat e tij të tjera dhe vepra “Rilindja e shkencave fetare” kanë bërë një kthesë të madhe, dhe, pikërisht për këtë ndihmesë kolosale të tij, shumica dërrmuese e dijetarëve ia kanë dhënë epitetin “Rilindës i shekullit të pestë”, sipas hadithit, ku thuhet se

Gazaliu në shumë vepra të tij e përmend “Rilindja e shkencave fetare” dhe ka dëshiruar që kjo vepër të jetë indikator impulsiv i rilindjes fetare, gjegjësisht i rilindjes së shkencave islame për mbarë myslimanët, në të katër anët e botës.

“Vërtet Allahu në krye të çdo shekulli do të dërgojë ndonjë rilindës të fesë.” Prandaj, Gazaliu përveç që dëshiroi t’i përtërijë shkencat fetare, ai po ashtu në këtë vepër i sistematizoi ato, i bërë të efektshme dhe të ndërlydhura njëra me tjetrën. Kështu, “Rilindja e shkencave fetare” është e ndarë në dyzet libra, kurse këto dyzet libra janë të radhitura brenda katër vëllimesh në tërësi. Thuajse çdo libër i “Rilindjes së shkencave fetare” ka formën e veçantë, që është e ndarë në kapituj, ku Gazaliu i quan “s qarime”. Pikërisht për këtë Gazaliu ka dëshiruar që kjo vepër të jetë libër i lexueshëm, i kapshëm dhe i qartë, me një klasifikim të mrekullueshëm, që Tim Winter-i pohon se “Eruditët bashkëkohorë rëndom i japin komplimente stilit të qartë të ‘Ihja-it’, saktësisht të logjikshme të ndarjes së tij dhe mënyrën e shpjegimit të përmbajtjes!” Kështu, çdo të katërtën pjesë të ‘Ihja-it’ Gazaliu e quan rub’ (çerek), dhe këto katër pjesë janë:

a – dhjetë libra të para të ‘Ihja-it’ i kushtohet diturive, shkencave dhe adhurimeve (ربيع العبادات);

b – dhjetë libra të dytat të ‘Ihja-it’ i kushtohet etikës dhe traditave të jetës (ربيع العادات);

c – dhjetë libra të treta të ‘Ihja-it’ i kushtohet çështjeve shkatërruese në jetë (ربيع المهلكات);


d – dhjetë libra të katërta të ‘Ihja-it’ i kushtohet çështjeve shpëtuese në jetë (ربيع المنجيات).

Vëllimi i parë i ‘Ihja-it’, përmban dhjetë libra, me këta kapituj: 1. Mbi diturinë, 2. Mbi bazat e besimit, 3. Mbi fshehtësitë e pastërtisë, 4. Mbi fshehtësitë e namazit, 5. Mbi fshehtësitë e zekatit, 6. Mbi fshehtësitë e agjërit, 7. Mbi fshehtësitë e haxhit, 8. Mbi parimet e leximit të Kuranit, 9. Mbi përmendjen e Allahut dhe lutjet, 10. Mbi radhitjen e lutjeve fakultative sipas vakteve.

Vëllimi i dytë i ‘Ihja-it’ përmban dhjetë libra, me këta kapituj: 11. Mbi parimet e ngrënies, 12. Mbi parimet e martesës, 13. Mbi dispozitat e fitimit, 14. Mbi të lejuarën (hallallin) dhe të ndaluarën (haramin), 15. Mbi parimet e shoqërimit dhe miqësinë me njerëz të ndryshëm, 16. Mbi parimet e vetmimit, 17. Mbi parimet e udhëtimit, 18. Mbi dëgjimin dhe ndjenjën, 19. Mbi urdhërimin në të mirë dhe ndalesën nga e keqja, 20. Mbi parimet e jetesës dhe etikën e pejgamberllëkut.

Vëllimi e tretë i ‘Ihja-it’ përmban dhjetë libra, me këta kapituj: 21. Mbi shpjegimin e virtyteve të zemrës, 22. Mbi disiplinimin e shpirtit, 23. Mbi lëngatat e dy epsheve; epsi i

barkut dhe epshi i organit gjenital, 24. Mbi lëngatat e gjuhës, 25. Mbi lëngatat e zemërimit, urrejtjes dhe zilisë, 26. Mbi përbuzjen e kësaj bote, 27. Mbi përbuzjen e pasurisë dhe koprracisë, 28. Mbi përbuzjen e famës dhe dyfytërsisë, 29. Mbi përbuzjen e kryelartësisë dhe vetëpëlqimit, 30. Mbi përbuzjen e vetë magjepsjes.



Vëllimi i katër i 'Thja-it' përmban dhjetë libra me këta kapituj: 31. Mbi pendimin, 32. Mbi durimin dhe falënderimin, 33. Mbi frikën dhe shpresën, 34. Mbi asketizimin islam, 35. Mbi njëshmërinë e Zotit dhe mbështetjen në Zotin, 36. Mbi dashurinë, mallëngjimin, miqësinë e ngushtë dhe kënaqësinë, 37. Mbi nijetin, çiltërinë dhe sinqeritetin, 38. Mbi vetëkontrollimin dhe vetëllogaritjen, 39. Mbi meditimin, 40. Mbi vdekjen.

Të gjitha temat në "Rilindja e shkencave fetare" Gazaliu i prezanton me metodologjinë ekzoterike dhe ezoterike. Shkrimi mbi shkencën, agjërimin, zekatin, haxhin, mësimin dhe këndimin e Kuranit famëlartë etj., që prezantohet përherë është si një diskurs, që ecën nga aspekti ekzoterik (i jashtëm) në atë ezoterik (të brendshëm). Ky kalim i metodologjisë së misticizmit islam nga njëri aspekti në tjetrin quhet 'i'tibar'. Andaj, atë kalim të "i'tibar-it" e shohim, për shembull kur Gazaliu flet për agjërimin, që nga agjërimi i barkut kalohet deri në agjërimin e duarve, këmbëve, syve, pastaj deri tek agjërimi me fjalë, nga këto agjërimet të niveleve është edhe kredhja në agjërim me zemër etj.. Në këtë mënyrë, Gazaliu nëpërmjet kësaj metodologjie i bëri shërbime të mëdha myslimanëve, dhe e begatoi fjalorin me kuptime edhe metaforike. Këtu duam të theksojmë veprën e tij "Mishkatu-l-envar⁵", atëbotë

kur Musai a.s. shkoi për të pranuar relevatën, shpalljen, atëherë Krijuesi i gjithësisë i drejtohet, citoj ajetin kuranor: "Me të vërtetë Unë jam Zoti yt, andaj hiqi nallanet, sepse je në luginën e shenjtë Tuva!"⁶ Por, siç pohon dr. Ebu-l-ala Afijfi, protagonist i kësaj vepre, "Gazaliu nuk merr në konsideratë vetëm nga aspekti ekzoterik, por ai hulumton fshehtësitë

Gazaliu këtë vepër e ka shkruar në një gjuhë të kapshme, që mund të kuptohet lehtë pa ndonjë vështirësi, për dallim nga ato vepra të tjera filozofike të tij, ku ai polemizon për termin e shkencës, përshkruan para së gjithash çështjet etike-religjioze dhe morale si dhe problemet e tjera të myslimanëve të asaj epoke.

hyjnore në brendësitë e tyre, duke hapëruar me një metodë specifike të interpretimit". Andaj, shfuqizimi i kuptimeve ekzoterike الباطنية është pikërisht mendim i ezoterikëve, batinitët, të cilët shohin me sy të verbër, nuk e kuptojnë tërësisht ekuilibrimin الموازنة ndërmjet tyre. Mirëpo, po ashtu shfuqizimi i kuptimit ezoterik është drejtim literalist مذهب الحشوية. Kështu, ata të cilët ekskluzivisht e veçojnë pikëpamjen e jashtme janë literalistët, kurse ata të cilët ekskluzivisht e veçojnë pikëpamjen e brendshme janë ezoterikët. Mirëpo, ata të cilët bashkojnë këto të dyja, atëherë vetëm ata si të tillë janë të përkryer! Prandaj, unë pohoj, vazhdon Gazaliu, se Musai a.s. e kuptoi urdhrin për zbathjen e (dy) këpucëve, për flakjen e të dy botëve, prandaj ai e zbatoi urdhrin sipas kuptimit ekzoterik me zbathjen e këpucëve të tij, kurse sipas kuptimit ezoterik me përflakjen e dy botëve. Ndaj, me shprehjen "dyzet libra" të kësaj vepre të vëllimshme, ai aludon në simbolikën e moshës së pjekurisë "dyzet vjet", që përmendet në Kuranin famëlartë si një kthesë e moshës së njeriut. "... derisa të arrijë pjekurinë e vet dhe kur t'i mbushë dyzet vjet..."⁷. Shumë komentatorë të Kuranit famëlartë, komentojnë se "dyzet vjet" është si një kthesë e moshës së njeriut në jetë, që është moshë kur të dërguarit pranojnë relevatën e Zotit. Ndërsa disa komentatorë pohojnë se këtu ka edhe përjashtime, meqë disa të dërguar kanë pranuar relevatën nga

Zoti para moshës “dyzet vjet” të jetës së tyre, si p.sh. Jusufi dhe Isai, paqja qoftë mbi ta!

Gazaliu këtë vepër e ka shkruar në një gjuhë të kapshme, që mund të kuptohet lehtë pa ndonjë vështirësi, për dallim nga ato vepra të tjera filozofike të tij, ku ai polemizon për termin e shkencës, përshkruan para së gjithash çështjet etike-religjioze dhe morale si dhe problemet e tjera të myslimanëve të asaj epoke. Gazaliu në këtë vepër, shpjegon rrugët e shpëtimit të myslimanëve nga shumë devijime brenda vetë religjionit, iluzioneve të shumta në fe dhe në besim, të cilat para se gjithash rrjedhin nga prania e madhe e metafizikës së huaj dhe mistikës në botën myslimane. Ai shpjegon të vërtetën e besimit islam, tregon obligimet e përbashkëta dhe individuale, udhëzon në rëndësinë dhe qasjen fetare-shkencore të botës dhe jetës. Kështu kjo vepër mbetet si një enciklopedi e rrallë e shkencave fetare dhe shoqërore, shkencë e kësaj bote dhe botës së përtejme. Duhet theksuar se Gazaliu shpreh mos kënaqësinë për bindjen e myslimanëve imitues, që nuk i mbetën besnikë detyrës së tyre “qëllimi i së cilës është ruajtja e besimit të vërtetë nga ngatërresat e bartësve të risive”. Ai është i pakënaqur me apologjetikën (kelamin), që shërbehet me metodat e filozofisë dialektike heleniste, po ashtu është i pakënaqur edhe me teologjinë dhe ligjet fetare që janë të lidhura ne pranimin e autoriteteve në mënyrë jo kritike nga ana e avangardës – dijetarëve. Kështu, kuptimi i kelamit të Gazaliu është më afër kelamit që definohet si “shkencë e cila na mëson të vërtetën e besimit islam me argumente logjike të sakta”. Pikërisht për këtë, kjo vepër flet mbi domosdoshmërinë e rilindjes së shkencave islame, me tematikën e saj dhe strukturën e argumentuar teologjike-filozofike dhe misticizmit islam, kur thotë: “Mendo mirë, gjyko dhe merr këshillë nga ai, që ka arritur tek e Vërteta pas një rrugëtimi dhe gjurmimi të gjatë, dhe pasi që është liruar nga imitimi i verbër taklid”. Ky imitim, për të cilin shkruan Gazaliu, është thjesht një pësim jo kritik të autoriteteve tradicionale në jurisprudenten islame, tefsir, hadith, akaid, kulturë, civilizim islam, filozofi, art, letërsi dhe në arsim, imitim kundër të cilit ai e ngriti zërin e tij. Por, këtu duhet theksuar se mendimi i disa myslimanëve, edhe pse ata, Gazaliut i japin rëndësi të madhe, prapëseprapë në kuptimin shoqëror-historik dhe civilizues nuk e kuptuan Gazaliun si muxhtehid, si reformator; meqë të tillët ende e trajtojnë Gazaliun vetëm në sufizëm spekulativ, të cilët janë jashtë realitetit dhe jashtë kontekstit të historisë.

Gazaliu në këtë vepër ka parashtruar mendimin duke i harmonizuar shkrimet e tij në lëmin e fikhut dhe usulit, ai ka treguar aftësinë e tij për dialektikë, paraqitje të argumentuar dhe pjekuri intelektuale në kritikën e mendimit filozofik, gjegjësisht në pranimin e disa qëndrimeve të tyre, kështu ai bën një ndikim të rrallë dhe të madh në lëvizjet shpirtërore dhe fetare në botën islame. Vepra është e

rëndësishme sepse paraqet kriteret islame në shpjegimin dhe kuptimin e vetë termit shkencë, pozitën e saj dhe rolin brenda botës myslimane të shekullit X dhe XI (5 dhe 6 h.). Vlen për t’u theksuar, se për “Rilindja e shkencave fetare” janë shkruar komente të ndryshme me dhjetëra libra të vëllimshme, në një anë, kurse në anën tjetër, ka të tillë që e kanë përmbledhur në një libër. Andaj këtu duhet veçuar përmbledhja e “Ihja-it” në një libër nga vëllai i tij Ahmed el Gazali, (لباب احياء علوم الدين) “Ajka e rilindjes së shkencave fetare”. Madje mund të thuhet se kjo vepër e Gazaliu, në intervale të caktuara kohore është studiuar dhe trajtuar shumë edhe në Perëndim, sikurse në vetë botën islame, andaj është përkthyer në gjermanisht, spanjisht, boshnjakisht, kurse tani edhe në gjuhën tonë shqip, ndërsa në Lindje është përkthyer në persisht, urdo dhe turqisht-osmanisht. Këtu duam të theksojmë se kjo vepër e vëllimshme atëbotë ishte në program edhe në “Medresenë e Madhe” në Gjakovë, që ishte themeluar në vitin 1707, kurse e mbyllur dhunshëm në vitin 1948. Prandaj, nuk është e rastit që ky opus i vëllimshëm i Gazaliut fillon me kapitullin kushtuar diturisë, me të cilin hapet “Rilindja e shkencave fetare”. Gazaliu pjesën më të madhe të veprave i ka shkruar ndërmjet moshës dyzet dhe pesëdhjetë e katër të jetës së tij. “Rilindja e shkencave fetare” është kulm i opusit të Gazaliut, të gjitha përvojat intelektuale dhe shpirtërore të Gazaliut janë të përfshira në faqet e këtij libri. Këto janë, gjithsesi motive, që Gazaliun sërish e lexojnë brezat myslimanë dhe jomyslimanë nga periudha të ndryshme, intelektualë të ndryshëm, me kultura dhe qytetërime të ndryshme në të katër anët e botës, sikur që e lexojmë edhe ne tani në Kosovë dhe në botën shqiptare. Ky libër, që është përhapur thuajse në të katër anët e botës, e që rrezaton madje edhe në ditët tona, është një dëshmi e sinqeritetit të autorit, i cili fton në përmbajtjen tok të tekstit, arsyes dhe të traditës. Kur Gazaliu ishte në prag të kalimit nga kjo botë, të pranishmit kërkuan këshillë prej tij, atëherë ai ju tha: “Përmbajuni sinqeritetit!”, këto ishin fjalët e fundit të tij, që vdiq më 19 dhjetor 1111, por mbi 200 vepra të tij janë të pavdekshme.

Dhe në fund të kësaj trajtesë modeste, i shprehim mirënjohje të thella dr. Ali Iljazit, për këtë përkthim dhe shumë të tjera, që dhuroi një ndihmesë kolosale, ku e pasuroi bibliotekën shqiptare për lexuesit shqiptarë besimtarë, andaj Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë me Xhenet!

1 ابو حامد الغزالي *Ihja ulumu-d-din* 1-5, Bejrut, 2002

2 Ebu Hamid el Gazali, *Rilindja e shkencave fetare*, (Furkan – Shkup), përkthyer nga boshnjakishtja prim. dr. med. sci. Ali F. Iljazi

3 Ebu Hamid el Gazali, *Oziviljavanje vjerski znanosti*, (Sarajevë, 2009). Nga parathënia e prof. dr. Enes Karic.

4 Ebu Hamid el Gazali, *Shpëtimi nga lajthitja*, (Mitrovicë, 1996), përkthyer nga boshnjakishtja Muhamed Iljaz Dolaku

5 Mishkatu-l-envar – Kandili i dritave, Logos A Shkup, përkthyer nga arabishtja Mulaim Shehu

6 Kurani famëlartë, 20-12.

7 Kurani famëlartë, El Ahkaf, 15.

Një katalizator semantik

(KRITIKË LIBRIT “HERA E PARË NË MEKË” TË AUTORIT BESNIK JAHA)

Granit SADIKU

HYRJE

“*Emadhërishmja kërkon thjeshtësinë, E bukura e duron stolisjen*”.¹ Dhe këtë koment tejet modest mbi një vepër të veçantë jam munduar ta bëj thjesht një stolisje. Që nga çasti kur e lexova kapitullin hyrës, e kisha parasysh se për këtë libër nuk do të mund ta jepja përshtypjen thjesht me një shprehje kënaqësie për leximin e tij, apo me një paragraf të shkurtër vlerësues.

Në kulturën e kritikës letrare shpeshherë vlerësohet autori më shumë sesa vepra. Madje edhe indikator kryesor për leximin e veprës është e bëma e autorit. Duke e njohur personalisht autorin e veprës në fjalë, u kujdesa që prioritet t’i kem elementet që duhen kritikuar, e jo ato që duhen vlerësuar. Ngase, meqë e kam pasur profesor, prej tij kam mësuar se konformiteti është gjithmonë dëmi i shoqërisë dhe paraziti i saj, ndërsa mendimi ndryshe dhe kritika e mirëfilltë është pasuria e saj.

MBI LIBRIN DHE AUTORIN

“*Hera e parë në Mekë*” është libri më i ri i profesor Besnik Jahës. Si nëntitull të veprës autori ka përzgjedhur fjalën “*udhëpërshkrim*”, e cila e orienton lexuesin menjëherë drejt një përvoje personale. Kjo vepër, e shkruar me finesë dhe stil tejet të hollë, paraqet një përvojë reale – ekzistente – të autorit gjatë udhëtimit të tij nga Kosova drejt vendeve të shenjta, që janë Meka dhe Medineja. Libri fillon dhe mbaron me kapitullin e fluturimit dhe me figurën e rrotës, e cila menjëherë e krijon brenda veprës fenomenin e quajtur “*double coding*”, sipas Umberto Ecos. Ky fenomen krijon ndarjen e dy

Autori në këtë vepër zbulon edhe një bindje të tij, që në teorinë letrare quhet ekstratekstualitet. Ekstratekstualiteti paraqet aspektin idealist të autorit, gjegjësisht besimin e tij në inspirim.

kategorive lexuesish: 1. Lexuesin semantik – që përbën karakterin homeopatik të veprës, dhe; 2. Lexuesin semiotik – që përbën karakterin aleopatik të saj. Lexuesi semantik kapitullin e parë të librit do ta kuptonte si diçka esenciale, si bazë kryesore të ngjarjes pa të cilën nuk do të mund të zhvillohej ngjarja dot. Fluturimi është mënyra e vetme e udhëtimit drejt një vendi aq të largët, dhe pa të (për autorin) nuk do të ishte i mundshëm as ky udhëpërshkrim. Ndërsa lexuesi semiotik do ta përshkruante se, më shumë sesa fluturim i një aeroplani, kjo do të thotë fluturim i kohës, e që kushtëzon pritjen për kohën e duhur, që pastaj e shpërblen me dhuratën e një vizite të shumëpritur. Ndërkaq, fjala e parë sikur e arsyeton këtë koncept, ngase përmendet rrota, që në aspektin subjektiv e ka kuptimin e sjelljes së fatit, mundësive, kohës së duhur për të bërë diçka, e kështu me radhë.

Motivi i shkrimit të veprës herë pas herë mbetet mister, e që autorët e lënë në dorën e lexuesve për ta zgjidhur, mirëpo në rastin e librit “*Hera e parë në Mekë*” ajo pushon së qeni mister, ngase autori qysh nga nëntitulli e jep motivin e veprës. Ndërsa, këtë motiv e përshkruan akoma më bukur në paragrafin në vijim:

“*Dhe, meqë ishte hera e parë, vendosa të shkruaj për këtë udhëtim. Pasi, edhe ashtu përshtypjet e para, siç thuhet, kurrë nuk kanë rast të dytë*”²

*

Diçka e rrallë dhe tejet me rëndësi, që paraqitet në libër qysh nga faqja e parë, janë QR kodet, të cilët autori i ka lënë si fakte për ta stolisur edhe më përshkrimin e tij. Nga

shqyrtimi i parë i QR kodeve fitohet përshtypja se janë përkthime të ajeteve kuranore nga shqipja, gjegjësisht janë versioni origjinal i Kuranit në gjuhën arabe, mirëpo më vonë, gjatë leximit, vërehet se autori ka inkorporuar jo vetëm përkthime, por edhe imazhe, këngë, harta, linqe, e që lidhen drejtpërdrejt me aktualitetin e përshkrimit. Kjo veçanti e librit e bën librin me mundësi qasjeje edhe në aspektin digjital, gjë e cila shënjon mbajtjen e hapit të autorit përmes veprës me epokën aktuale të digjitalizuar. Si rrjedhojë, pasuria e veprës me QR kode e bën veprën ta ketë jehonën e saj *intermediale*, e që flet bukur shumë për njohuritë e gjëra të autorit në ndërlidhjen e librit me filmin,³ operën, teatrin,⁴ muzikën⁵ etj.

Thëks të veçantë përgjatë tërësve të veprës zë edhe intertekstualiteti i përsëritur herë pas here, qoftë përmes inkuadrimit të poezive, ajeteve kuranore, proverbeve të urta, apo edhe citimeve nga veprat e autorëve bardë të letërsisë. Thëniet e veçanta autori zakonisht i ka veçuar me formatin “*italic*”, por jo rrallëherë në këtë format autori ka vendosur edhe thëniet e veta, në margjinat e faqeve, ose nëpërmendjet e veta. Kjo për mua si lexues nuk ishte edhe aq e mirëpritur, ngase më ngjallte herë pas here dilemë se a është thënie e autorit, apo e cituar prej autorit. Mirëpo, edhe në rast se thënia do të ishte e autorit, nuk do duhej të ishte e veçuar, ngase janë lexuesit ata që e veçojnë apo i nënvizojnë thëniet e tyre të parapëlqyera, e jo autori. Përshtatimisht kësaj, intertekstualiteti flet edhe më për njohuritë e gjëra të autorit në fusha të ndryshme të dijes. Dy shkencat që autori i ka shtjelluar më shumë në faqet e këtij libri janë: historia⁶ dhe jurisprudenca⁷ islame. Kjo gjë është e nënkuptuar, ngase mungesa e njohurive për haxhin, sidomos në këto dy lëmë, e bën tejet të vështirë përmbushjen e këtij adhurimi të veçantë, e që në rastin e autorit ishte vizitë – në parim, po edhe adhurim në të njëjtën kohë.

Autori në këtë vepër zbulon edhe një bindje të tij, që në teorinë letrare quhet ekstratekstualitet. Ekstratekstualiteti paraqet aspektin idealist të autorit, gjegjësisht besimin e tij në inspirim. Që në faqet e para ai shfaq botëkuptimin e tij ndaj shkrimit:

*“Të kam zili që po shkruan, - më tha. - Ti mund të shkruash çfarë je duke parë jashtë, dhe sytë e tu po shohin jashtë sikur të ishin sy piktori, e unë nuk po mund të pikturoj këtu me panel e ngjyra, - vazhdoi ai me humorin e tij të zakonshëm e të butë. Nuk ka dert që s’i ke ngjyrat me vete, se edhe fjalët kanë ngjyra, - i thashë me po të njëjtin humor. - Do t’i shohësh kur ta lexosh këtë që po shkruaj” (...)*⁸

Pastaj, kur e shtjellon edhe më tutje mënyrën e tij të shkruarit, vazhdon kështu:

“Para se të shkruajmë ulemi në karrige, kemi fletën e bardhë dhe lapsin, sot më shpesh laptopin me baterinë plot, jemi plot energji, hapim dritaren vertikalisht në 15 shkallë, ca tingu

*instrumentali vijnë nga larg, e dritarja pak e hapur lë një puhizë t’i valëvitë këndshëm perdet skaj tavolinës; epo kjo po që se quhet atmosferë frymëzimi që mundëson thurjen e shkronjave dhe krijimin e magjisë së quajtur, letërsi.”*⁹

Autori beson në inspirim, sidomos kur ai dëshiron të shkruajë për shpirtëroren, në vendin që – siç thotë edhe ai vetë – të lidh me vertikalen. Shpirti që tregohet brenda veprës e paraqet një lloj mbrojtjeje të autorit brenda saj, dhe në vend që t’i gjejë elementet e pakënaqësisë, ai i gjen elementet që e bëjnë atë të lumtur dhe të përmbushur shpirtërisht. Kjo është edhe filozofia e tij, ngase ai nuk i vlerëson shkrimtarët “sharlatanë”, ashtu siç e ka quajtur një kategori shkrimtarësh në parathënien e një reviste:

*“Sot letërsia jonë ka shumë autorë të mirë. Mirëpo, për fat të keq, ka edhe shumë sharlatanë, e që mendojnë se me sarkazëm dhe ironizim të çdo teme, me dalje kundër çdo gjëje, po e “zbulojnë ujët e vakët”, dhe kështu do të jenë shkrimtarë e poetë.”*¹⁰

Pra, autori në fjalë nuk e gjen ironizimin e diçkaje si mënyrë për ta trajtuar atë, por ai shkon deri në njohjen e saj më të thellë dhe analizimin e saj. Kjo e bën veprën e tij tejet melankolike në aspektin religjioz, mirëpo jo edhe dogmë. Ngase autori i ka vlerësimet e tij dhe lavdet për botën e Lindjes, por i ka edhe kritika serioze, të cilat edhe i paraqet. Ai e kritikon Arabinë Saudite për shkallët e ndryshme të



esktrimiteteve që ka pasur, nga ai i larti në atë më të ulët. Po ashtu e kritikon edhe për shkujdesjen e Saudisë ndaj disa objekteve me vlerë, që do të duhej të ishin restauruar për shkak të vlerës së tyre historike. Mirëpo, këtu e trajton edhe një temë me rëndësi për lexuesin mysliman, se stereotipi ballkanas, se gjoja Lindja është e prapambetur dhe nuk është në hap me botën moderne, është tërësisht i pavend. Duke shfaqur hotelet luksoze, ushqimet, pritjen, makinat, ndërtesat, qytetet, infrastrukturën e zhvilluar, autori ndikon në ndryshimin e asaj përshtypjeje. Ai, përmes tonit ironik, e krahason kësaj Lindjen dhe Perëndimin:

“Dhe mendoja se po, nëse Perëndimi krenohet me zhvillimin e vet, mund të vijë këtu ta shohë “prapambeturinë”. Apo, interneti ia shpërfaqti propagandën e pandershme që kishte zhvilluar për shekuj me radhë.”¹¹

*

Tema e fjalëve, dhe fjalëformimet janë po ashtu fusha që autori i prek përmes shprehjeve që i përdor herë pas here. Disa herë në vepër gjejmë fjalë që përdoren tejet rrallë në letërsi, siç është, për shembull fjala “nëpërmendje”, “turravrap”, “tevona”, por në tekst janë të pranishme edhe trajta provokuese sitaksore e të reja fjalëformimi, e të cilat autori i ka krijuar për nevojat e tekstit, siç janë: “madhështipushtues”¹², “tamerrmendja”¹³, “gjysmëqorr”¹⁴.

*

Përkundër seriozitetit dhe patosit – ndjeshmërisë – së tekstit, në këtë udhëpërshkrim gjejmë, herë pas here, edhe elemente satire e sarkazmi, e të cilat autori i ka vënë në vende të caktuar, për ta liru lexuesin nga ngarkesa e tepërt emocionale. Komedia shfaqet qyshkur autori tenton t'i vërej minaretë e xhamisë, dhe meqë s'mundet dot, përdor satirën.

MBI CILËSITË E LIBRIT

Teoria e Platonit mbi rrëfimin ishte se ekzistojnë dy mënyra të rrëfimit: *mimesis* (që përfshin zhanret tragjedi dhe komedi), dhe *diegesis* (që përfshin ditriambin). Mimesisi paraqet kryesisht aktin, apo imitim. Kallëzimi është fare pak i theksuar, dhe brenda tij nuk mund të vërehet zëri i narratorit. E kundërta është *diegesis*, që nënkupton përfshirjen e zërit të narratorit në tekst. Ky libër është në trajtën e rrëfimit diegetik. Autori përveçqë rrëfen përvojën personale, sjell edhe fotografi të bllokut të tij të shënimeve gjatë kohës sa e ka shkruar dorëshkrimin e parë të librit (Shih QR kodin f. 19!). Pastaj zhvillimi i ngjarjes, dialogët mes personazheve, zhvillimi i ngjarjes në formatin fillim – mes – fund, krijon përshtypjen e një romani.

Tiparet e Aristotelit për retorikën ishin 4: a) që ta bëjë audiencën më të mirë; b) t'i zmadhojë apo t'i zvogëlojë faktet që janë të rëndësishme; c) ta ngacmojë në mënyrë të duhur audiencën emocionalisht, dhe; d) t'ua rifreskojë memorien

dëgjuesve. Këto tipare mund të gjenden fare lehtë përgjatë leximit të kësaj vepre. Retorika e lartë në vepër arrin ta bëjë lexuesin për vete, dhe kësaj ta ketë ndikimin e vet depërtues. Mirëpo, përkundër aspektit diegetik dhe retorik të vepërës, kjo vepër prapë nuk mund të quhet roman! Autori në këtë vepër ka paraqitur gjithçka reale, dhe nga fillimi i librit e deri në fund nuk ekziston asnjë element fiktiv. Autori paraqitet në vetën e parë, dhe e tregon historinë e vet si rrëfim personal, pa e bartur atë në personazhe. Dhe, po ashtu autori ka treguar, përmes nëntitullit, se kjo vepër është udhëpërshkrim, e jo roman. Mirëpo, ka elemente letrare më shumë sesa një përshkrim i thjeshtë, dhe elemente fiktive shumë më pak sesa një roman. Me fjalë të tjera, kjo vepër do të mund të përshkruhej si: “më shumë se udhëpërshkrim, e më pak se roman”. Ajo që e ushqen shpirtin e lexuesit në vepër, është pikërisht ai katalizatori semantik brenda saj. Arti i autorit është art (letrar) islam, dhe si i tillë ai ngulmon në aspektet pozitive shpirtërore.

“Përjetimin subjektiv të vepërës artistike në trajtë të katalizatorit semantik e hasim drejtpërdrejt në artin islamik. Ai në realitet krijon një qetësi, i eliminoi të gjitha turbullirat dhe pretendimet pasionuese të botës, duke ndërtuar në vend të tyre një rend të shprehjes së ekuilibrit, qetësisë dhe paqes.”¹⁵

Çdo libër, - siç thoshte Michel Foucault – është një nyjë brenda rrjetit. Autori krijon, apo kombinon – siç do të thoshin post-modernistët – më të mirën që mund të gjejë nga fjalët dhe nga përshkrimet, për të arritur deri te vëmendja e lexuesit. Ky libër prek në një mënyrë brilante nivelet e vetëdijes dhe të ndjenjave në qenien e një lexuesi besimtar, dhe është njëfarë formule e ripërtëritjes së tij shpirtërore. Dhe, si i tillë, sigurisht se ia vlen të lexohet!

1 Immanuel Kant – Mbi të bukurën dhe të madhërishtmen.

2 Besnik Jaha – Hera e parë në Mekë.

3 Autori e citon një thënie nga filmi “V for Vendetta”, kur flet për Kuratin, pastaj krahason imazhet e vendeve të shenja nga përshtypjet prej filmit “Mesazhi” etj..

4 Autori jep një përshtypje të shkurtër për Vjenën në aeroportin e saj ku flet për operën, teatrin, aktorin e madh shqiptar Aleksandër Moisiu, pastaj vëllëzërit kompozitorë Franc dhe Ferdinand Schubert, etj..

5 Këngë islame, zakonisht në versionin e kasides – si zhanër i preferuar i autorit.

6 Kur flitet për historinë e ndërtimit të Qabesë, pastaj historia e Muhamedit a.s., historia emocionale e Talhas, e shumë histori të tjera.

7 Autori ka përmendur kushtet e veshjes së ihramit, të cilat i mëson nga mesazhi në “Whatsapp” prej mikut të tij Bashkimit, e që janë kryekëput lami e jurisprudencës islame.

8 Po aty, f.10.

9 Po aty, f.24.

10 Revista AGORA - 2017, me parathënie nga Besnik Jaha.

11 Po aty, f.45.

12 Në gramatikë ky fenomen quhet fjalëformim, dhe hyn në grupin e fjalëformimeve me kompozim, që nënkupton bashkimin e dy temave motivuese ku e dyta ia jep kuptimin të parës: madhështi+pushtues.

13 Formuar me prejardhje, me bashkimin e parafjalës me rrënjën e fjalës. Në këtë rast gjejmë diçka unike, që është bashkimi i tri fjalëve të veçanta në një: ta+merr+mendja.

14 Kompozim, gjysmë+qorr.

15 Metin Izeti – Pasqyra estetike e traditës perenniale.

Vakëfet islame dhe roli i tyre qytetërues

(E SHKUARA, E TASHMJA DHE E ARDHMJA)

P.D Abdurrahman ibën Ibrahim el-Dahjani

Allahu i Lartësuar i ka plotësuar begatitë mbi robërit e Tij besimtarë nëpërmjet asaj çka ua ligjësoi në librin e Tij, në praktikën e profetit të Tij, duke u garantuar gëzim dhe fitore në të dy botët nëse ata u përmbahen dispozitave dhe ecin udhëve të udhëzimit të Tij. Prej dyerve dhe fushave të mirësive të mëdha ishin investimet e myslimanëve prej pasurisë së tyre me atë çka Allahu i kishte begatuar në dobi të shoqërisë, si dhe të individit e bashkësisë islame në veçanti. Myslimanët garonin për të zbatuar dispozitat e Allahut të ardhura në Kuran: “Nuk do arrini sinqeritetin derisa të jepni prej asaj që doni më shumë.” (Ali Imran, 92). Si rezultat, vakëfet janë investimi më i madh që kanë kryer myslimanët ndikuar prej ajeteve të shumta të ardhura në Kuran. “Të dhuroni është më mirë për ju nëse jeni që e dini.”

Vakëfet hyjnë te sadakatë e rrjedhshme edhe pas vdekjes së robit në bazë të hadithit: “Kur vdes biri i Adem, i ndërpriten punët e tij përveç tri rasteve, sadakaja rrjedhëse, dituri e dobishme ose një djalë (pasardhës) i mirë i cili lutet për të.”

Historianët e qytetërimit islam kanë shkruar e dokumentuar për rëndësinë e jashtëzakonshme të vakëfeve islame, duke i konsideruar vakëfet si motori themelor, mbrojtës dhe ushqyes për të gjitha çështjet jetësore të shtetit islam. Madje është elementi kryesor i financimit, furnizimit të bashkësisë dhe shtetit në të gjitha çështjet.

Rëndësia e burimeve të vakëfeve përfshinë pothuajse të gjithë shtetin islam, të gjitha grupet dhe shtresat e shoqërisë. Madje do ta kalojë rolin humanitar, nuk do përqendrohet

vetëm te njerëzit, por do e shikojmë që do përfshijë kafshët dhe shpendët: kujdesin, mbrojtjen dhe ushqimin e tyre. Këtu përfshihej edhe kafshët e mëdha, të moshuara e të sëmura, të cilat do kishin kujdesin e tyre derisa të ngordhnin. E gjitha kjo prej shpenzimeve të vakëfeve. Të flasësh rreth institucionit të vakëfit në botën islame, është si të flasësh për një institucion social, financiar, ushtarak dhe fetar. Ka luajtur rolin kryesor në rregullimin e bashkësisë islame, formimin e perandorisë, si dhe ndërtimin e qytetërimit të saj. Vakëfet krijuan lidhje të fortë shpirtërore mes shtresave të ndryshme të shoqërisë: ndërmjet dhënësit dhe marrësit, ndërmjet të pasurit dhe të varfrit.

Vakëfet do mbajnë mbi shpatullat e tyre pjesën më të madhe të progresit të qytetërimit islam që nga përhapja e Islamit dhe thirrja në të; kanë hedhur në letër diturinë dhe e kanë përhapur atë; kanë ndërtuar xhami e rrugë; strehë për udhëtarët; kujdesin për jetimët, nevojtaret dhe moshën e thyer; ngritjen e bibliotekave dhe botimin e librave; ndërtimin e shkollave; vendqëndrimet për mësuesit dhe studentët.

Vakëfet i dhanë ymetit gjithçka, madje në disa raste ato ishin “alfa e omega”. Vakëfet përfaqësonin shtyllën kurrizore për të gjitha fushat e pushtetit dhe veprimtaritë e shtetit islam. Madje shteti mbështetej në dhurimet e vakëfeve për veprimtari të ndryshme duke pasur mundësi të angazhohej me çështje të tjera. Vakëfet islame ndikuan në ndjenjat e poetëve duke na lënë vargje poezie dhe kaside në të cilat kanë gdhendur rolin e rëndësishëm të vakëfeve në qytetërimin islam. Janë pikërisht këto poezi e kaside

Historianët e qytetërimit islam kanë shkruar e dokumentuar për rëndësinë e jashtëzakonshme të vakëfeve islame, duke i konsideruar vakëfet si motori themelor, mbrojtës dhe ushqyes për të gjitha çështjet jetësore të shtetit islam.

dëshmitare në kohë të shenjave e gjurmëve të qytetërimit islam. Prej fukahave që kanë shkruar poezi për vakëfet janë dijetarët si Sujuti, El Kendi etj..

Vakëfet me rolin që kanë luajtur i kanë paraprirë konventës bazë për të drejtat e njeriut të vitit 1948, ngase kjo konventë u jepte të drejta punëtorëve dhe bujqve, mirëpo vakëfet u kujdesën për një ymet të tërë, e jo vetëm për disa sektorë. U kujdesën për familjet që kishin humbur kryetarin e familjes; u kujdesën për pleqtë dhe të pafuqishmit për të fituar jetesën e tyre; u kujdesën për jomyslimanët të cilët ishin të pafuqishëm të punonin tokat e tyre; luftuan analfabetizmin duke shpërndarë arsimin falas; ndërtuan spitale për të sëmurët.

Ndonëse në shekullin e kaluar feja pati sfida të mëdha dhe vakëfet pësuan tronditje, mirëpo përkundër kësaj, ato arritën të qëndronin në këmbë dhe të mos kishte zëvendësues për to. Xhamia është një prej themeleve të rëndësishme të qytetërimit islam, madje shtylla ruajtëse e qytetërimit islam. Institucioni i vakëfit do të konsiderohet si një ndër burimet më të rëndësishme të financave për të vazhduar jetën e veprimtarive që kryhen në xhami që nga ligjëratat fetare të cilat përfshijnë fusha të ndryshme të jetës.

Sistemi i vakëfeve ishte shtylla kryesore për shkollat dhe institucionet arsimore që përfshinte mesxhidet, zavijet, hankat,

Sistemi i vakëfeve ishte shtylla kryesore për shkollat dhe institucionet arsimore që përfshinte mesxhidet, zavijet, hankat, mektebet; ashtu siç ishte shtyllë thelbësore për institucionet e përkrahjes sociale dhe për të gjitha institucionet shëndetësore.

mektebet; ashtu siç ishte shtyllë thelbësore për institucionet e përkrahjes sociale dhe për të gjitha institucionet shëndetësore.

Vakëfet përfshinin fshatra të plotë, fusha bujqësore, hamamet, hanet, furra, dyqane, mullinj dhe kuzhina për të varfrit, udhëtarët e studentët. Gjatë kohës së sundimit memalik dhe sidomos gjatë sundimit osman, vakëfet u shtuan shumë. Të gjitha qendrat e diturisë në mbarë botën islame ishin rrjedhim i sponsorizimeve të bëra nëpërmjet vakëfeve. Pa rolin e vakëfeve në atë periudhë, arsimi fetar dhe jofetar, nuk do kishte arritur të luante rolin e tij. Nuk do arrinte të zinte vendin e tij në shkencën botërore.

Vakëfet e institucioneve fetare-arsimore do të shtriheshin në mbarë botën islame. Nuk do njihnin kufij gjeografik. Nuk kishte mbetur qytet apo fshat pa vakëfe në shërbim të komunitetit. Vakëfet përgjatë historisë islame kanë pësuar ulje-ngritjet e tyre të kushtëzuara prej faktorëve të ndryshëm, përveç vakëfeve në fushën humanitare. Ato asnjëherë nuk ndalën përgjatë gjithë historisë islame. Vetë vakëfet në thelb janë veprimtari sociale-humanitare, të shtyrë nga arsye po sociale. U morën me organizimin e shoqërisë duke lehtësuar problematikat e saja.

U ndërtuan shtëpitë e të pastrehëve të cilat njiheshin si “shtëpitë e të varfërve”; u ndërtuan sebile (çezmat me ujë) si dhe kuzhinat për të varfrit; u ngritën institucione





për jetimët ku u mbuloheshin shpenzimet e nevojshme në ushqim, veshje e arsim derisa të rriteshin dhe të ishin të pavarur e të aftë për të fituar jetesën vetë; u ngritën institucione për të verbrit dhe moshën e thyer. Vakëfet u kujdesën për të vdekurit duke ua paguar të gjitha shpenzimet; kujdeseshin të organizonin ceremonitë martesore për të pamundurit financiarisht. Dhuruesi ishte i qartë në mbulimin e shpenzimeve që kryente mbi nevojtarët. Shkruheshin marrëveshje ku fiksoheshin detyrimet e palëve.

Spitalet vakëf kanë qenë të përhapura në mbarë hapësirën e botës islame, duke luajtur rolin e tyre më së miri në shërbim të ymetit. Spitali i parë vakëf i ndërtuar në shtetin islam është në vitin 88h gjatë sundimit të kalifit Velid ibën Abdylmelik, gjatë sundimit emevit në Damask të Sirisë. Të gjitha shpenzimet e spitalit që nga paga e mjekëve e me radhë, mbuloheshin prej vakëfeve. Ndërsa Ahmed ibën Tulun, do ndërtojë spitalin e plotë në vitin 259 hixhri në Egjipt. Njëkohësisht kujdes i është kushtuar edhe të sëmurëve mendorë, për të cilët caktohej kujdestari, i cili e nxirrte shëtitje në natyrë mes gjelbërimit dhe luleve, i lexonte Kuran butësisht për t'ia qetësuar zemrën.

Historia ka regjistruar gjithashtu vakëfin e pasur të cilin la sulltan Kalouni për bimaristanin e tij në Kajro, spital në të cilin kuroheshin të sëmurët fizikisht dhe mendërisht. Pajisi spitalin me ilaçe nga India, të cilat nuk mungonin kurrë, pagesa të kënaqshme për mjekët, tesha e ushqime për të sëmurët. Spitalit i ndërtoi kopsht të gjelbëruar si dhe kishte caktuar lexues të Kuranit për të sëmurët, të cilët gjithashtu paguheshin prej vakëfit të tij. Sponsorizimi në vakëfe

përfshiu edhe moshën e thyer duke u ndërtuar Dar elmusin, ose siç njihet sot “shtëpi pleqsh”.

Vakëfet kanë pasur rol në uljen e papunësisë, duke ndërtuar institucione arsimore të profilizuara për ata të cilët nuk ishin në gjendje të mësonin ndonjë zanat, si dhe u jepej mundësia të trajnoheshin, të fitonin eksperiencën e duhur. Kjo shmangu fryrjet burokratike të shtetit, e cila përkthehet në më shumë punësime dhe pagesa për punonjësit në aparatit shtetëror.

Vakëfet kanë pasur rol shumë të rëndësishëm në forcimin e moralit dhe edukatës duke ngushtuar në maksimum rrëshqitjen. Vakëfet kanë treguar kujdes ndaj grave vejusha, të divorcuara e të braktisura prej burrave, duke u siguruar strehë, ushqim, kujdes shëndetësor për to dhe fëmijët e tyre, duke shmangur në këtë mënyrë që këto gra të kërkonin burime të ardhurash për të mbajtur veten e tyre dhe fëmijët me punë jo të ndershme.

Vakëfet kanë ndihmuar të burgosur të cilët prej pamundësisë për të paguar borxhet, kishin përfunduar në burg.

Tregon Ibën Batuta në një ndër udhëtimet e tij në Damask, se derisa po ecte qosheve të Damaskut, vuri re një djalë të vogël, shërbëtor në një ndër shtëpitë damaskiene, të cilit i kishte rënë pa dashje nga dora tasi prej porcelani kinez. U mblodhën njerëzit dhe e këshilluan t'i merrte copat e thyera dhe të shkonte te vakëfi i enëve të thyera. Aty kujdestari i vakëfit i jepte vlerën e enës së thyer dhe i thoshte të shkonte të blinte një tjetër si ajo. Ky ka qenë vakëf, i cili ruante dinjitetin e të varfrit përballë pronarit të tij, i cili prej zemërimit mund ta ndëshkonte shërbëtorin e tij ose t'i bërtiste në fytyrë. Këto vakëfe gjetën përhapje në shumë qytete të botës islame, si në Mekë, Bejrut, Egjipt, Tunizi dhe Fes.

Siç e shikojmë, Islami ka përhapur dritën e tij që nga lindja e deri në perëndim me anë të kujdesit që ka treguar për çdo individ të bashkësisë islame nëpërmjet institucionit të vakëfit.

Përktheu: Klodiana Xhaferaj

P.D Abdurrahman ibën Ibrahim el-Dahjani, “El-eukaf el-islamije ue duriha el-hadari el-madi ue el-hadir ue el-mustakbel”, (Medine el Muneuere, 2001, botimi i parë.)

**Spitali i parë
vakëf i
ndërtuar në
shtetin islam
është në vitin
88h, gjatë
sundimit të
halifit Velid
ibën
Abdylmelik.**

Rëndësia e Imam Maturidiut dhe maturidizmit për një qytetërim të ri islam (2)

Prof. dr. Hasan Onat

Në shkencën e Kelamit, Maturidiu i kushtoi rëndësi vullnetit njerëzor dhe mësoi teorinë se njerëzit janë përgjegjës për punën dhe mendimin e tyre të lirë. Kur njeriu është i lirë, ai ka dhënë një kontribut të madh në shkencë, që është domosdoshmëri e përgjegjësisë së tij

PËRSE NA DUHET SHKOLLA MATURIDITE?

Mendimi i Imam Maturidiut dhe shkolla e tij është një pikënisje ideale për të përfytyruar një qytetërim të ri. Kjo sepse:

1. Tradita më e rëndësishme që mund të përdoret për të ringjallur arsyen dhe mendimin kritik në botën islame është damari hanefi-maturidi. Me gjithë shkatërrimin e procesit të *Mihnes*¹, të cilin ne ende e ndjejmë, parimet kryesore që lanë gjurmë në këtë traditë, si dallimi midis veprës dhe besimit dhe dallimi midis fesë dhe politikës, arritën të ruajnë ekzistencën e tyre si “prushi” në hi. Arritja më e rëndësishme e Maturidiut është aftësia e tij për të rindërtuar qëndrimin “racional” në qendër të traditës (*ehlul r-re’j*), me pioner Ebu Hanifen, i cili kishte pasur polarizime të thella ideologjike me muteziletë. Ndërsa procesi anti-mihne kaloi mbi muteziletë si një cilindër, ai ose vrau ose diskreditoi të gjithë ata që ishin të lidhur me mutezilen, si dhe të gjitha llojet e mendimeve që nuk ishin në përputhje me metodologjinë tradicionaliste (*Ehlul-Hadith*), në mënyrë që të mos ngriheshin më kurrë. Në këtë proces, ende nuk është bërë përcaktimi i dëmit në lidhje me hanefizmin. Nga njëra anë, Maturidiu vendosi një distancë mes vetes dhe muteziles, duke bërë kritika të ashpra, e nga ana tjetër, vazhdoi të ushqej me një

damar racional duke nënvizuar drejtpërdrejt Ebu Hanifen.

2. Emri i Maturidiut gjallëron ende, edhe pse maturidizmi nuk njihet në qarqet që kanë mundësinë të udhëheqin një lëvizje të re qytetëruese. Mendojmë se nuk do të jetë shumë e vështirë t’i lëmë vend Maturidiut në kujtimet e njerëzve që janë në kërkim. Anashkalimi i Maturidiut për një kohë të gjatë pengoi që mendimet e tij të ndoten dhe falsifikohen.

3. Kuptimi i fesë dhe përvojës nga Maturidiu mund të jetë një udhërrëfyes në rindërtimin e racionalitetit të shëndetshëm dhe të menduarit kritik të nevojshëm për të parandaluar selefizmin, i cili ushqehet nga kolonializmi dhe trauma e qytetërimit të mundur, në të cilin është hedhur bota islame.

4. Aftësia e myslimanëve për të dalë nga spiralja e dhunës varet nga aftësia e tyre për të hequr qafe kuptimin e shtrembëruar reaktiv që e redukton Islamin në një lloj ideologjie politike, që i sheh të gjitha zgjidhjet si kapje e “pushtetit” dhe identifikon fenë me politikën. Emri i vetëm që mund të na ndriçojë me qëndrimet e tij në këtë drejtim është Imam Maturidiu.

5. Nevojitet një epistemologji e re për të përfytyruar një qytetërim të ri. Një nga dimensionet më origjinale të Maturidiut janë pikëpamjet e tij mbi epistemologjinë.

Maturidiu e ka parë shumë mirë se pesë shqisat janë baza e dijes dhe e kujtesës



njerëzore. Një nga arsyt kryesore pse myslimanët janë lënë jashtë garës së qytetërimit është se ata kanë humbur fuqinë e dijes dhe shkencës. Kjo situatë ka sjellë pamundësinë e tyre për të prodhuar teknologji paralele me rrjedhën e njerëzimit. Sipas mendimit tim, faktori më i rëndësishëm që çon në gjithë këtë është humbja e lidhjes së njohurive për rrënjët e dijes në mendje me botën e jashtme. Myslimanët janë larguar nga një qëndrim realist në një idealizëm të shtrembëruar.

Duke marrë parasysh periudhën kohore në të cilën ai jetoi, shihet qartë se refuzimi i Maturidiut për të pranuar zbulimin, mrekullitë dhe frymëzimin si burime dijeje është një përcaktim i avancuar. Qasja e Maturidiut nevojitet më shumë se kurrë për informacion të saktë, të besueshëm dhe të shëndoshë në proceset ku “informacioni diskreditohet” në kohën që po kalojmë.

6. Një kuptim i ri i Islamit duhet ndërtuar për një qytetërim të ri. Kuptimi i Maturidiut për fenë i përqendruar në

Kontributi më i rëndësishëm i Maturidiut në mendimin islam shfaqet në pikën e teorisë së tij të dijes, qasjes së tij të bazuar në arsye dhe të kuptuarit e tij të fesë, e cila bazohet në faktin se arsyeja dhe shpallja do të jenë efektive së bashku, dhe se besimi dhe veprimi nuk mund të identifikohen njësoj.

Teuhid mund të lehtësojë krijimin e vetëdijes së emëruesit të përbashkët të Islamit.

7. Një nga çështjet që e thellon krizën që po përjetojnë myslimanët është se ata nuk tregojnë ndjeshmërinë e nevojshme ndaj lirisë njerëzore. Aty ku nuk ka liri, nuk mund të flitet për qytetërim, ashtu siç nuk mund të flitet për Islam. Nëse kuptimi i ekuilibruar i Maturidiut për lirinë kuptohet mirë, do të jetë e mundur të heqësh qafe si nga kuptimi fatalist që ndihmon për të legjitimuar negativitetet, ashtu edhe nga mjediset shtypëse që e bëjnë të vështirë të menduarit qartë dhe aktivizimin e aftësive krijuese.

8. Maturidiu ka adoptuar një qasje ku arsyeja dhe shpallja mund të jenë efektive së bashku dhe të plotësojnë njëra-tjetrën. Kjo qasje mund të jetë një model i përshtatshëm për një kuptim të shëndetshëm të fesë.

9. Maturidi gjithashtu mund të hedhë dritë se si të përfitohet nga pikëpamje të ndryshme dhe se si diversiteti mund të jetë i pasur. Kur lexohet me kujdes *Kitabu't-Teuhidi*, shihet qartë se si janë përfutur disa nga pikëpamjet e tyre pozitive, edhe pse ka kritika të ashpra ndaj sekteve të tjera, veçanërisht ndaj mutezileve.

SISTEMI I MENDIMIT TË MATURIDIUT DHE NJË QYTETËRIM I RI ISLAM

Nuk diskutohet që myslimanët krijuan një qytetërim të madh, megjithëse sot ai ka mbetur në thellësi të së kaluarës. Një pjesë e rëndësishme e kësaj përvoje ka formuar infrastrukturën e qytetërimit aktual perëndimor. Megjithatë, nuk mund të thuhet se ky akumulim qytetëruar është shfrytëzuar mjaftueshëm. Ka ende shumë që mund të shfrytëzohen. Mendjet e mëdha si Maturidiu, ende në pritje për t'u zbuluar, presin shkencëtarë që do t'i kuptojnë. Ne duam vetëm të lexojmë sistemin e mendimit të Maturidiut nga këndvështrimi i një qytetërimi të ri, të identifikojmë idetë themeluese që mund të mbështesin formacione të reja, të mendojmë dhe diskutojmë se si mund të na udhëheqin ato. Në këtë drejtim, gjëja e parë që na vjen ndërmend është të kuptuarit e tij për dijen, arsyen dhe fenë.

Maturidiu ishte i pari që shpalosi sistematikisht pikëpamjet e tij mbi teorinë e dijes në historinë e mendimit islam. Vlen të merren parasysh thëniet e mëposhtme të Hysejn Ataj (Hüseyin Atay): “Sipas përcaktimit tim, themeli i

teorisë së dijes në historinë e shkencës dhe filozofisë islame është Muhamed b. Muhamed b. Mahmud Ebu Mensur Maturidi (333/944). Kombi turk i ka dhënë botës islame pesë dijetarë dhe filozofë të mëdhenj në mbarë botën: Ebu Hanifen (150/767), Buhariun (256/868), Ebu Xhafer et-Taberiu (310/922), Farabiun (399/950) dhe Maturidiun (333/944). Në shkencën e *Kelamit*, Maturidiu i kushtoi rëndësi vullnetit njerëzor dhe mësoi teorinë se njerëzit janë përgjegjës për punën dhe mendimin e tyre të lirë. Kur njeriu është i lirë, ai ka dhënë një kontribut të madh në shkencë, që është domosdoshmëri e përgjegjësisë së tij, në teorinë e shkencës dhe në ngritjen e qytetërimit si rezultat i saj. Është mënyra e duhur për të përfutur nga idetë e mendimtarëve të mëdhenj si Maturidiu në drejtim të formimit të dijes dhe zhvillimit të mendimit dhe për të kuptuar më mirë kulturën dhe qytetërimin islam (Atay, “Ebu Mansur Maturidi ve Bilgi Kurami”, *İmam Maturidi ve Maturidilik*, ed. S. Kutlu, 174).. Mendojmë se edhe Biruni dhe Ibën Sina duhet të pajtohen me këtë përcaktim të Atait. Nëse do të ndërtohet një qytetërim i ri islam, shtylla teologjike e tij mund të jetë Maturidiu, shtylla filozofike është Farabiu dhe Ibën Sina, dhe shtylla shkencore është Biruni. Edhe fakti që kontributi i këtyre mendjeve vërtet të dalluara në qytetërimin e mëparshëm islam nuk është hulumtuar në mënyrë adekuate është një çështje që do ta bëjë më të lehtë të kuptojmë pse qytetërimi islam zuri vendin e tij në mesin e qytetërimeve të vdekura.

Grënjët e traditës së mendimit nga ka ardhur Maturidiu i gjejmë në shekullin e parë hixhri. Çështja e “mëkatit të madh” që i lodhte myslimanët në atë kohë, qëndrimet fyese të arabëve ndaj jo kurejshëve dhe jo arabëve të quajtur *mevali*, presioni i madh i pushtetit emevit, formacionet e reja sociologjike dhe kërkimet e reja në aspektin e mendimi janë pothuajse të pashmangshme. Disa faktorë, si reagimi ndaj autoritetit qendror të kurejshëve, dhimbjet e kalimit nga jeta beduine në jetën e vendosur (urbane) dhe ndryshimi i shpejtë kulturor i kishin përgatitur havarixhët dhe havarixhëzmin, të cilët ishin përfaqësues “reaktiv- të kuptuarit fisnor të fesë”. Havarixhët, të cilët e shohin vetëm vendbanimin e tyre si “*daru’l-islam*” (toka islame), i largojnë lehtësisht nga Islami ata që nuk mendojnë si ata, identifikojnë veprat dhe besimin dhe i akuzojnë ata që bëjnë mëkate të mëdha me politeizëm. Teksa ngushtuan hapësirën e jetesës së myslimanëve, ata dëmtuan edhe harmoninë e Islamit me natyrën me pikëpamjet e tyre që legjitimojnë dhunën. Ndërsa pushteti emevit u përpoq të përballej me rebelimet e havarixhëve, nga ana tjetër, ata mbështetën tendencat që më vonë do të formonin thelbin (doktrinën) e “xhebrijës” për të legjitimuar veprimet e tyre. Këtu, diskutimet për “mëkatin e madh”, diskursi kundër lirisë së emevitëve dhe havarixhëve, përpjekjet e myslimanëve jo arabë të quajtur *mevali* për të mbajtur jetën si myslimanë, në mënyrë të pashmangshme i



shtynë disa njerëz të kërkonin qasje më liridashëse dhe egalitare duke theksuar parimet universale të Islamit. Në këtë drejtim, ata që theksonin dallimin ndërmjet veprave dhe besimit, përkrahnin barazinë në besim dhe pretendonin se ishte e drejtë t'i lihej Allahut gjendja e atyre që bënë një mëkat të madh, këta më vonë filluan të quheshin murxhi.¹

Siç thekson Hysejin Ataj, kontributi më i rëndësishëm i Maturidiut në mendimin islam shfaqet në pikën e teorisë së tij të dijes, qasjes së tij të bazuar në arsye dhe të kuptuarit e tij të fesë, e cila bazohet në faktin se arsyeja dhe shpallja do të jenë efektive së bashku, dhe se besimi dhe veprimi nuk mund të identifikohen njësoj. Megjithatë, ka një gjë që është më e rëndësishme se të gjitha këto: Maturidiu u përpoq të kuptonte dhe shpjegonte njerëzimin, fenë, ngjarjet dhe dukuritë, bazuar në realitetin njerëzor dhe duke u bazuar në natyrën njerëzore. Dëshmia më e dukshme për këtë është se ai e vendosi diturinë e shqisave në qendër të dijes njerëzore. “Sa i përket atij që përvetëson injorancën, e kundërta e dijes si e tillë, po, kushdo që njeh dikë që mohon diturinë, do ta quante kokëfortë.” (Maturidi, 2002, 10). “Ajo që duhet bërë me një person kaq kokëfortë është t'i nënshtrohet dhimbjeve të forta, siç është amputimi, për të hequr dorë nga kokëfortësia e tij e pakuptimtë. Sepse ne jemi të sigurt se ai është i vetëdijshëm për dijen shqisore, e cila ka statusin e shkencës thelbësore, por ai e vazhdon pretendimin e tij vetëm për hir të kokëfortësisë dhe zorit.” (Maturidi, 2002, 10). Këtu mund të shohim qartë se qëllimi i Maturidiut nuk është t'i mendojë njerëzit, por të kontribuojë në ndërgjegjësimin e tyre për ekzistencën e tyre. Pika e nisjes për Maturidiun është vetëdija për ekzistencën e vet.

Përktheu nga gjuha turke: Haki Sahitaj

1 Në kohën e kalifëve abasid, disa dijetarë konservatorë u morën në pyetje dhe disa prej tyre madje edhe u torturuan dhe ky qëndrim i administratës u quajt *mihne*. Ky fenomen u iniciua nga Ma'mûn, një nga kalifët abasid. (Përkthyesi-H.S.).

Shkupi në optikën e një udhëpërshkruesi arab

Mahmud Karut

Emri i tij në turqisht është “Yskyp”, dhe është një qytet i lashtë në brigjet e lumit Vardar, në një lartësi prej rreth dyqind e pesëdhjetë metra mbi nivelin e detit, në një luginë pjellore, të rrethuar me malet e mbuluara nga bora. Është kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut, një nga ish-republikat jugosllave, që nga viti 1945.

Qyteti është i njohur që nga epoka romake si një qendër e aktivitetit ekonomik, falë vendndodhjes së tij gjeografike. Ishte një vendbanim ilir i quajtur Shkup. U godit nga një tërmet i fortë në vitin 518, i cili e shkatërroi plotësisht. Ai u rindërtua vite më vonë, gjatë sundimit të Justinianit 527-565 dhe u emërua “Justiniana Prima”. Por shpejt rifitoi emrin... Sakalibanët e pushtuan në fund të shekullit të shtatë, por Bizanti e rifitoi kontrollin mbi të deri në shekullin XIII - me përjashtim të disa periudhave - gjatë të cilave u pushtua nga bullgarët dhe serbët.

Turqit osmanë, kishin filluar marshimin e tyre në Evropë, dhe filluan drejtpërdrejt në Ballkan.

“Yskypi – Shkupi” u hap në fillim të mbretërimit të Sulltan Bajazidit të Parë në vitin 1390-1402, me nofkën “Yildirim”, që do të thotë rrufeja. Osmanët shpejt e bënë kryeqytetin e tyre të dytë pas Edirnes dhe bazën e tyre ushtarake për të vijuar kështu pastaj fushatën e tyre në Evropë.

Rëndësia e tij u bë e madhe, tregtia lulëzoi në të dhe lëvizja e ndërtimit ishte aktive në të, kështu që ndërtesat e mëdha u shtuan, si xhamitë, pallatet, shkollat, faltoret dhe banjat.

Më e rëndësishmja nga xhamitë e tij është, Xhamia e Sulltan Muradit – 1436 dhe Xhamia e Ishak Beut – 1448. Pastaj xhamia Isa Beu në vitin 1475, xhamia Hoxha Mustafa në vitin 1485 dhe së fundi Xhamia e Jahja Pashës në vitin 1502. Sa u përket shkollave të saj, ajo solli një lëvizje kulturore që u bë e famshme në shekujt XVI dhe XVII, me poetët, historianët dhe studiues të saj të shquar.

Emrat e disa prej njerëzve të tyre të famshëm janë përmendur në Enciklopedinë Islame, botimi i parë - si: Is'hak Çelebi, i njohur si El Yskypi, Pir Muhamed Ashik Çelebi, Uveys bin Muhamed, i njohur si Vejsi , dhe Atai Noi Zadeh el Yskypi, ndër të cilët kishte poetë, juristë, gjykatës dhe shkrimtarë.

Gjermanët pushtuan Shkupin në pranverën e parë të prillit 1941, dhe e bënë bazë ushtarake. U godit nga një tërmet në vitin 1963, që humben jetën afërsisht dy mijë njerëz. Pjesa më e madhe e pjesës tjetër u shpërnda dhe e gjithë lagjja lindore, e cila përmban shumicën e ndërtesave të lashta islame, si xhamitë, tregjet dhe objektet, u shkatërrua, dhe lagjet e tjera u dëmtuan, por qeveria nxitoi të rindërtonte, dhe Shkupi u kthye në një qytet të begatë në industrinë dhe tregtinë e tij, dhe popullsia e tij u rrit çuditërisht.

Pasi ishin në regjistrimin e vitit 1961, vetëm 983.161 njerëz, ata u bënë pas dhjetë vjetësh, pra në vitin 1971, 962.388 njerëz.

Shkupi në shekullin e shtatëmbëdhjetë ishte një nga qytetet më të mëdha në Ballkan. Në atë kohë kishte 2150 dyqane, dyzet e pesë xhami, shtatëdhjetë e pesë mesxhide, njëzet

Arkitektura islame dukej e qartë, qendra tregtare në zemër të qytetit. Minaret ishin të larta, që arrinin deri në qiell dhe dritat shumëngjyrëshe ishin mbështjellë rreth tyre, si shprehje e gëzimit të Ramazanit në muajin e agjërimit.



Tekije, njëzet shtëpi bujtinash, shtatëdhjetë shkolla fillore, pesë shkolla të mesme dhe nëntë shkolla private për lexim dhe intonacion të Kuranit. Shtatë hotele falas, për të cilët kalimtarit nuk paguan asgjë, dhe më shumë se një mijë banja nëpër shtëpi private, duke i shtuar edhe një numër të disa banjave publike.

Në një vizitë të një delegacioni qeveritar sirian në qytetin e Shkupit, delegacioni sirian bëri një shëtitje në qytet dhe nga një vend i lartë - ku e shihnin qytetin në pamjen e tij të përgjithshme - anëtari i delegacionit, z. Munib el Tahan tha: “Ne pamë një xhami të lashtë, dhe afër saj një treg antik, si dhe rrugën e saj me gurë të mëdhenj e të lëmuar (kalldrëm) dhe në këtë treg kishte dyqane për shitje dhe artizanate, tradicionale dhe antike, si dhe dyqane që shesin pëlhura dhe tekstile të ndryshme.

Munib el Tahani thotë: “Më e bukura ishte mirëpritja që delegacioni e takonte kudo që vizitoi - dhe ndoshta arsyeja ishte se shumica e pronarëve të dyqaneve ishin myslimanë - dhe kur dëgjuan një nga anëtarët e delegacionit duke folur në arabisht, ata ndjenin një lidhje shpirtërore dhe nostalgji për gjuhën e Kuranit - kështu tha një nga qytetarët - dhe disa prej tyre ishin të kënaqur dhe shfaqnin lumturinë që ai është mysliman dhe se ai na do, sepse ne jemi nga vendet islame, madje edhe përkthyesja që po ecte me ne nuk i fshehu ndjenjat ndaj nesh dhe tha se quhej Xhuliana e myslimanët e quajnë Lejla. Ajo që e lëndon shpirtin është se xhamia më e

madhe dhe madhështore në Shkup nuk i hap dyert veçse për turistët. Një nga qytetarët në Shkup tha: “Ajo hapet vetëm për namazin e xhumasë dhe për dy bajramet.”

Në një qytetin e Shkupit, në vitin 1991, nga një gazetar arab, ai përshkruante atë që shihej në kryeqytetin e Maqedonisë dhe tha: Arkitektura islame dukej e qartë, qendra tregtare në zemër të qytetit. Minaret ishin të larta, që arrinin deri në qiell dhe dritat shumëngjyrëshe ishin mbështjellë rreth tyre, si shprehje e gëzimit të Ramazanit në muajin e agjërimit. U sigurova të vizitoja Xhaminë e Madhe, e cila ishte gjëja e parë që më ra në sy nga dhoma e hotelit dhe gjëja e fundit që e shoqërova para se të flija. Shkova në distriktin e pazarit dhe gjeta një sërë dyqanesh luksoze, të ngjashme me dyqanet e vjetra në Han el Halili në Kajro. Iu afrova xhamisë, pasi mbaroi koha e agjërimit, e gjeta xhaminë të mbushur me besimtarë dhe një i ri tetëmbëdhjetë vjeç duke lexuar Kuranin fisnik, në mënyrën e leximit të shejh Abdulbasit Abdusamed dhe të pranishmit po dëgjonin me vëmendje, imami i xhamisë, shejh Selami po ua shpjegonte kuptimet e leximit fisnik.

Gjeta dyqane të vogla pranë bibliotekës së madhe, që shisnin libra dhe revista, të cilat kanë të bëjnë me mësimet e fesë islame, dhe të tjera, të cilat janë nxjerrë nga meshihati islam, ku natyra e shtetit laik pasqyrohet në marrëdhëniet e tij me fetë. Shkupi është kryeqyteti administrativ dhe kulturor i Maqedonisë, dhe lumi Vardar e përshkon atë. Karakterizohet me tipare ballkanike, krahas manifestimeve të arkitekturës islame, veçanërisht në rrethin e pazarit të vjetër. Më pas shfaqet arkitektura moderne që u ndërtua në qytet, pas tërmetit të vitit 1963, ku u rindërtua sërish për të pasur një karakter modern të ndryshëm nga ai që u restaurua dhe u ruajt nga monumentet e tij antike, gjë që tërmeti shkatërrues nuk arriti deri aty.

Jeta kulturore në Shkup fillon nga universiteti, ku buron nga kontributi shkencor i Universitetit të Shkupit, i cili strehon njëzet e pesë mijë studentë. Në Shkup ka dy institute për studimin e muzikës, një institut i lartë i arteve të bukura dhe të aplikuar dhe një tjetër për artet e teatrit, kinemasë, radios dhe televizionit. Shkupi ka një numër të muzeve. Popullsia e Shkupit është afër gjysmë milion njerëz. Këtu duhet të përmendim një nga dijetarët e njohur nga Shkupi në të kaluarën, përkatësisht Pir Muhamedi, myftiu i Shkupit. El Muhebi e përmend në librin e tij “Hulas el Athar” se Pir Muhamedi u bë myfti në Shkup, dhe se ky myfti ishte shumë i famshëm dhe ishte një jurist i ditur. Ai mbledhi çështjet që kishin ndodhur në kohën e tij nga çështjet që jepte fetva, e më pas i rregulloi ato në kapitujt e jurisprudencës, dhe njiheshin si “Fetvatë e el-Yskybiut”. Vdiq në vitin 1611.

Përktheu nga arabishtja: Shpend Hulaq

Marrë nga libri “Muslimanët në ish-Jugosllavi”, Mahmud Karut

Pasqyrë e shkurtër e arkivit (fondit arkivor) të Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë (1984-1997)¹

MSc. Drin Aliu

ABSTRAKT

Ky punim hulumtues ka për qëllim pasqyrimin e fondit të vjetër arkivor të Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë. Është bërë përpjekje maksimale që ky punim hulumtues të pasqyrohet drejt me objektivitet, duke implementuar metodat adekuate shkencore: përshkrimin dhe analizën.

Fondi arkivor në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë ndahet në dy pjesë, fondi i vjetër i periudhës së paraluftës dhe fondi i ri i periudhës së pasluftës. Në këtë punim pasqyruar do të pasqyrohet vetëm fondi i vjetër, i cili përshinë intervalin kohor 1984-1997. Fondi në fjalë është prodhuar nga veprimtaria edukativo-arsimore e shkollës, por përbëhet edhe nga pak dokumentet që kanë ardhur nga jashtë në drejtim të shkollës, duke përfshirë këtu: kërkesa, ankesa, raporte, referenca-rekomandime, kontrata, urime, vërtetime etj.. Fondi ka gjithsej 7 kuti me dokumente të ndryshme, të cilat janë të paklasifikuara. Fondi në vete përmban një numër të konsiderueshëm dokumentesh si: rregullore, procesverbale, njoftime, konkurse, lista të nxënësve, kërkesa, ankesa, dëftesa, vendime, vërtetime, mirënjohje, dekorata, projekte, regjistra, deklarata, raporte, urime etj..

Vlen të theksohet se arkivi i Medresesë “Alauddin” në Prishtinë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse përmes studimit të tij pasqyrohet veprimtaria shumëdimensionale e Medresesë. Në vazhdim të këtij punimi, në mënyrë të shkurtër dhe konstruktive do të pasqyrohet

përmbajtja dhe rëndësia që përmban ky fond arkivor me qëllim që studiuesit e kësaj fushe të kenë një orientim dhe lehtësim rreth përmbajtjes së këtij fondi arkivor.

1.1 Një historik i shkurtër i shkollës

Medreseja “Alauddin” u hap dhe filloi punën e saj edukativo-arsimore më 01.11.1951 në qytetin e Prishtinës e njohur me emrin zyrtar si “Medreseja e Ulët Shqiptare”. Medreseja e Ulët Shqiptare filloi veprimtarinë e saj në kohën më të vështirë në të cilën po kalonte populli shqiptar në përgjithësi, arsimit kombëtar dhe fetar në veçanti.

Me këtë gjendje të vështirë u përballë edhe Medreseja, mësimdhënësit dhe nxënësit e saj. Krahas kushteve të vështira, kurajoja dhe vullneti për të vazhduar procesi edukativo-arsimor në gjuhën shqipe ishte shumë i madh si nga ana e mësimdhënësve, ashtu edhe nga ana e nxënësve. Si rezultat i vullnetit dhe përkushtimit nuk munguan as rezultatet. Drejtuesit dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle punuan me përkushtim të madh në funksionalizimin dhe zhvillimin e saj. Gjatë viteve të para të punës, si rezultat i mungesës së kuadrit të ri, në Medrese punuan mësimdhënësit e vjetër që kishin shërbyer në medresetë e mëhershme në Kosovë, të cilat u mbyllën në vitin 1948. Këta mësimdhënës ishin njerëz të ditur, njohës të disa gjuhëve, kishin përvojë pune dhe ishin atdhetar të shquar. Mësimdhënësit e Medresesë edhe pse në kushte të disfavorshme punuan shumë, me të vetmin qëllim, edukimin dhe arsimimin e

Medreseja “Alauddin” u hap dhe filloi punën e saj edukativo-arsimore më 01.11.1951 në qytetin e Prishtinës e njohur me emrin zyrtar si “Medreseja e Ulët Shqiptare”.

Gjatë viteve të para të punës, si rezultat i mungesës së kuadrit të ri, në Medrese punuan mësimdhënësit e vjetër që kishin shërbyer në medresetë e mëhershme në Kosovë, të cilat u mbyllën në vitin 1948.

gjeneratave të reja në frymën kombëtare dhe fetare.

Krahas kushteve shumë të vështira dhe pengesave të llojllojshme, Medreseja e Ulët e Prishtinës, zhvilloi një veprimtari sa të vështirë aq edhe të suksesshme mes viteve 1951-1962 duke nxjerrë gjithsej 115 nxënës të diplomuar. Si rezultat i përkushtimit të BFI-së, drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve të saj, kjo shkollë arriti me shumë sukses t'i përballonte sfidat e kohës. Ajo që mund të themi në përgjithësi është se roli i Medresesë së Ulët në procesin edukativo-arsimor në Kosovë mes viteve 1951-1962 ishte shumë i madh, sepse ndikoi drejtpërsëdrejti në shkollimin e disa gjeneratave si në aspektin fetar ashtu edhe në atë kombëtar, duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në uljen e numrit të analfabetizmit dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare.

Medreseja e Ulët që nga themelimi ishte dhe shërbente si shkollë e mesme e ulët katër vjeçare. Si pasojë e mungesës së një shkolle të mesme të lartë fetare, nxënësit

Si rezultat i nevojës imediate me iniciativën e BFI-së, Medreseja e Ulët e Prishtinës, në vitin shkollor 1962-1963 u shndërrua në Medrese të Mesme dhe e mori emrin “Alauddin” si rezultat i afërsisë që kishte me Xhaminë “Alauddin”.

shqiptar detyroheshin të vijonin shkollimin e mesëm fetar në Sarajevë në Medresenë “Gazi Husrev Beg” e cila njëherësh ishte edhe medreseja e mesme e lartë e vetme në Jugosllavi. Si rezultat i nevojës shumë të madhe që edhe shqiptarët (krahas boshnjakëve) të kishin një shkollë të mesme të lartë fetare, BFI i bëri të gjitha përgatitjet e duhura që Medreseja e Ulët të shndërrohej në medrese të mesme. Pas 11 vjetëve punë, përkushtim dhe sakrificë, Medreseja e Ulët, dha rezultate shumëdimensionale duke hedhur kështu edhe themelet e Medresesë së Mesme “Alauddin”. Si rezultat i nevojës imediate me iniciativën e BFI-së, Medreseja e Ulët e Prishtinës, në vitin shkollor 1962-1963 u shndërrua në Medrese të Mesme dhe e mori emrin “Alauddin” si rezultat i afërsisë që kishte me Xhaminë “Alauddin”.

Sikurse Medreseja e Ulët Shqiptare edhe Medreseja e Mesme “Alauddin” (e cila u ngrit mbi themelet e Medresesë së Ulët Shqiptare) vazhdoi veprimtarinë e saj edukativo-arsimore duke dhënë kontribut shumëdimensional në edukimin dhe

arsimimin e gjeneratave të reja në frymën fetare dhe kombëtare në kohën më të vështirë që po kalonte Kosova dhe populli i saj. Medreseja “Alauddin” si institucion edukativo-arsimor ngërthen në vete shumë komponentë të veçanta dhe specifike, gjë që e dallon nga shkollat e tjera, duke filluar nga vizioni, kuadri profesional, kombinimi i plan-programeve mes lëndëve fetare dhe lëndëve të përgjithshme, disiplina, cilësia, kompaktësia etj., të gjitha këto dhe shumë elemente të tjera e bëjnë këtë shkollë unike dhe fanar ndriçues dhe shembull për shkollat e tjera.

Medreseja “Alauddin” me veprimtarinë e saj të larmishme dha një kontribut shumëdimensional në përgjithësi në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor në veçanti, duke ndikuar kështu drejtpërsëdrejti në formësimin e një shtrese intelektuale fetare e kombëtare në Kosovë dhe më gjerë. Pa dyshim një kontribut shumë të madhe në këtë drejtim dhanë edhe drejtuesit dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle, të cilët punuan me intensivitet në kushte aspak të lehta me të vetmin qëllim, zhvillimin dhe avancimin e arsimit. Në Medresenë “Alauddin” u shkolluan dhe edukuan shumë gjenerata në një kohë shumë të vështirë për vendin dhe arsimin shqip. Krahas të gjitha vështirësive, si rezultat i punës progresive kjo shkollë arriti që t'i përballonte të gjitha sfidat e kohës dhe të kontribuonte shumë në kultivimin e vlerave fetare e kombëtare në përgjithësi dhe në përhapjen e mësimave në gjuhën shqipe në veçanti.²

1.2 Pasqyrë e shkurtër e Arkivit (Fondi arkivor) të Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë (1984-1997)




Foto 2- Vendimi i hapjes së Medresesë së Ulët



Foto3- Nga ceremonia e hapjes së Medresesë "Alauddin" në Prishtinë.

Si çdo shkollë tjetër, e cila zhvillon veprimtari edukativo-arsimor dhe që prodhon dokumentacion, edhe Medreseja e Mesme "Alauddin" veprimtarinë e saj edukativo-arsimor e ka të regjistruar-pasqyruar në dokumentacione, të cilat ruhen në Arkivin e kësaj shkolle. Meqenëse Medreseja e Mesme "Alauddin" veprimtarinë e saj edukativo-arsimor e filloj dhe e vazhdoj në objektin e vjetër të "Medresesë së Ulët Shqiptare" mes viteve 1962-1985, për dokumentacionin mes viteve 1951-1962, dhe dokumentacionin mes viteve 1963-1984, gjatë hulumtimit nuk kam hasur në informacion. Duke pasur parasysh këtë gjë, në punim do të pasqyrohet sipërfaqësisht dhe në mënyrë konstruktive dokumentacioni i Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë nga viti 1984 (nga koha kur Medreseja vazhdoi veprimtarinë e saj nga objekti i vjetër në objektin e ri) deri në vitin 1997.

Meqenëse Arkivi është thesari i çdo institucioni përmes së cilit pasqyrohet veprimtaria e tij, edhe Medreseja e Mesme "Alauddin" në Prishtinë e posedon këtë thesar të çmuar dokumentesh, përmes së cilit pasqyrohet dhe dokumentohet veprimtaria dhe kontributi i saj i larmishëm dhe shumëdimensional.

Arkivi (Fondi arkivor) i Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë përfshin një interval kohor mes viteve 1984-1997 (ekziston dokumentacioni edhe pas viti 1997 e deri më

sot, mirëpo ne do ta pasqyrojmë vetëm dokumentacionin mes viteve të lartcekura). Ky fond arkivor është i ndarë në gjithsej 7 kuti arkivore, të cilat përmbajnë dokumente të ndryshme si kërkesa, ankesa, raporte, referenca-rekomandime, kontrata, urime, vërtetime etj..

Fondi ndahet si në vijim:

1. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1984-1986, Kutia nr: 1.
2. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1986-1987, Kutia nr: 2.
3. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1988-1989, Kutia nr: 3.
4. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1990-1991, Kutia nr: 4.
5. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1991-1992, Kutia nr: 5.
6. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1993-1994, Kutia nr: 6.
7. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: *Veprimtaria e Medresesë "Alauddin"*, viti 1995-1997, Kutia nr: 7.

Ky fond arkivor është shumë i pasur me shumëllojshmëri të dokumentacionit përmes së cilave pasqyrohet veprimtaria e Medresesë "Alauddin" mes viteve 1984-1997.

1.3 Gjendje fizike e dokumenteve dhe rëndësia e tyre historike

Fatmirësisht pjesa më e madhe e lëndës arkivore është në gjendje të mirë fizike, një pjesë e vogël e saj ka nevojë për restaurim dhe konservim. Megjithatë krahas anëve pozitive, kjo lëndë i ka edhe mangësitë e saj. Dokumentet arkivore nuk janë të klasifikuara, gjë që e vështirëson tejmas punën e menagjmentit të shkollës dhe punën e studiuesve për përdorimin e këtyre dokumenteve.

Dokumentet arkivore që gjenden në Arkivin (Fondin Arkivor) e Medresesë "Alauddin" në Prishtinë kanë një rol dhe një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse përmes studimit të tyre pasqyrohet veprimtaria shumëdimensionale e vatrës së edukimit dhe arsimimit fetar dhe kombëtar, Medresesë së Mesme "Alauddin" të Prishtinës.

Shpresojmë që ky punim i shkurtër dhe pasqyrues t'i nxitë studiuesit në hulumtojnë në këtë fond arkivor!

- 1 Fondi Arkivor i Medresesë "Alauddin" në Prishtinë.
- 2 Më gjerësisht shih: Drin Aliu "Roli i Medresesë "Alauddin" në procesin edukativo-arsimor në Kosovë mes viteve 1951-1999", (Prishtinë, 2021).

Jeta dhe kontributi i mulla Qamil Mehmetit

Miran Mehmeti

Një prej porosive të tij ishte: “Rrini të lidht me Zotin se nuk ka forcë e as fuqi që ju ban dam kur nuk mungon kjo lidhje, e nëse e shkëput këtë lidhje dije e ke marrë veten nqafë.”

Mulla Qamil Mehmeti lindi në vitin 1928, në fshatin Vojnoc të komunës së Shtimes. Që nga mosha e re kishte pasur një interes të spikatur për t'i ndjekur mësimet fetare, dhe pikërisht deshi Zoti që dëshira e tij të bëhej realitet, fal hapjes së mejtepit në Vojnovc, nga hoxha i shquar mulla Vesel Guta. Hapja e mejtepit ishte një gëzim shumë i madh për mulla Qamilin, ngase aty filloi i ndoqi mësimet fetare deri në përfundimin e studimeve dhe në diplomim. Jeta e tij ishte aq e përkushtuar ndaj praktikimit të njohurive fetare dhe librit të Zotit, dhe aq shumë e deshi këtë program hyjnor, sa që nuk i ndau nga dora e tij mësimet kuranore deri në vdekje. Shërbimi i tij si imam në fshatin Grackë të Lipjanit gjatë muajit Ramazan zgjati përreth 15 vjet radhazi, nga vitet e 50-ta deri në vitet 1965-1967. Gjatë këtyre viteve ka qenë aktiv në jetën fetare, nga koha e diplomimit në mejtep deri në vitet e fundit të jetës së tij. Nga dashuria e madhe që kishte për t'i vizituar vendet e shenjta, më në fund arriti që pas shumë sakrificash të shkoi në haxh në vitin 1990.¹

Në vitin 1961, mulla Vesel Guta mori vendim që të largohet nga fshati Vojnoc për t'u shpërngulur në Hasanbeg (Shkup) të Maqedonisë. Por, duke dal nga fshati, Mulla Veseli çelësin e xhamisë ia dorëzoi Mulla Qamilit. Arsye se pse e kishte bërë këtë zgjedhje ishte për shkak të kontribut të jashtëzakonshëm që Mulla Qamili kishte dhënë për kultivimin e jetës fetare dhe për kryerjen e obligimeve ndaj xhamisë, si për mirëmbajtjen dhe rregullimin e saj, ashtu edhe për gjërat e tjera të zakonshme. Mirëpo, mulla Behxhet Jashari kishte një dëshirë të zjarrtë që të ishte imam i fshatit, prandaj e



kishte lutur Mulla Qamilin që t'i jepej çelësi atij për t'u bërë imam i fshatit. Duke e parë dëshirën e madhe të Mulla Behxhetit për të kryer këtë detyrë, Mulla Qamili kishte vendosur që çelësin e xhamisë t'ia dorëzoj pikërisht Mulla Behxhetit, ndërsa ai mbeti si ndihmësi i tij. Mulla Behxhet Jashari si imam, dhe mulla Qamil Mehmeti si ndihmës i tij, gjetën një bashkëpunim mjaft të mirë në menaxhimin dhe kryerjen e detyrave të tyre gjatë angazhimit në xhami.² Kur thërritej ezani në xhaminë e Vojnocit, të dy ngjiteshin bashkë lart në minaren e xhamisë dhe e thërrisnin ezanin së bashku. Ezani dëgjohej duke u kombinuar me dy zëra të ndryshëm, ku zëri i tyre i bukur, bëhej i pa rezistueshëm për ata që dëgjonin dhe ishte e pamundshme që lotët mos të rrjedhin.³

Mulla Qamil Mehemeti shquhej edhe për nxitjen që ju bënte të tjerëve për të dhënë sadaka, madje dhënia e lëmoshës dhe ndihmës nuk kishte munguar edhe nga ana e tij. Të gjithë ata që e njihnin Mulla Qamilin, e konsideronin që ishte bamirës, dhe se ishte person që e ndante pasurinë me të tjerët, madje qoftë edhe një mollë që e kishte në xhep e ndante me të tjerët. Ai, shumë prej të mbjellave që kishte si: gruri, shalqiri apo patatet, i kishte shpërndarë duke lënë vetëm aq sa i duhen për veten dhe familjen e tij.⁴ Mulla Qamili ishte një hoxhë që e lexonte shpesh Kuranin, duke bërë qindra hatme gjatë jetës së tij. Përveç leximit, ai ka ditur përmendësh shumë prej faqeve të Kuranit, dhe se kur e çelte Kuranin ndodhte që e dinte përmendësh atë faqe. Gjithashtu, ai kishte kënduar hatme edhe për të tjerët si: prindërit e tij, të afërmit e tij, dhe për njerëz të ndryshëm që kishin kaluar në botën tjetër. Mirëpo, gjëja që i pëlqente më së shumti atij ishte t'ua mësonte shkronjat arabe të tjerëve⁵, pikërisht duke e ditur shpërblimin që ka për atë që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve, ashtu siç thotë Muhamedi a.s.: “Më i miri prej jush është ai i cili e mëson Kuranin dhe ua mëson atë tjerëve.”⁶

Gjeneratë pas gjenerate ka qenë mësues i fesë islame dhe çdoherë kishte dhënë një kontribut të veçantë në thirrjen islame, ku i kishte inkurajuar të gjithë ata që rrinin me të apo në tubime të ndryshme ku mbledheshin, në kryerjen e adhurimeve ndaj Zotit, sikurse namazi, por jo vetëm kaq, por edhe me vepra të tjera të mira, duke ua treguar rëndësinë e veprave të mira të Zotit xh.sh.. Një prej porosive të tij ishte: “Rrini të lidht me Zotin se nuk ka forcë e as fuqi që ju ban dam kur nuk mungon kjo lidhje, e nëse e shpëput këtë lidhje dije e ke marrë veten n'qafë.” Gjithashtu, kur për ndonjë gjë shpjegonte e përmendte edhe ndonjë citat nga Libri i shenjtë, duke e argumentuar atë që e thoshte, dhe për t'i bindur njerëzit që kjo është e vërteta, sikurse kur thoshte: “Shikoni t'mirat e Perenisë në çdo anë i kemi edhe nuk ua dimë bereqetin. Toka ku po jetojmë, punojmë e veprojmë nuk janë rastësisht po dhuratë prej Zotit, krejt këto i kemi nga Allahu për insanin me pas ma të lehtë dynjanë, qysh Ai thotë n'Mus'haf: “Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës ndaj çdo gjëje.”^{7,8}

Mulla Qamili ka marrë pjesë edhe në raste të ndryshme me të cilat ballafaqoheshin njerëzit në atë kohë si për festa, por edhe për raste pajtimi mes dy grupeve, ku tregohet se në disa raste në prag të martesës së disa qifteve i kishte pajtuar dhe ata e kishin vazhduar jetën të lumtur, ashtu siç e do feja e bukur islame, duke vepruar sipas rregullave dhe ligjeve islame, ashtu siç thotë Zoti në Kuran: “Silluni mirë me to (gratë)...” En Nisa, 19)⁹, e nuk donte që të vijë deri te më e keqja, si ndarja apo hidhërimi mes tyre, e edhe në rastet kur

**Mulla Vesel
Guta e kishte
çmuar më së
shumti Mulla
Qamilin, dhe
kishte thënë për
të që është një
ndër nxënësit
më të mirë që
kishte për nga
gjenerata e
djemve**

disa familje ishin në hasmëri kishte qenë prezent dhe kishte ndikuar në pajtimin mes tyre.¹⁰ Mulla Vesel Guta e kishte çmuar më së shumti Mulla Qamilin, dhe kishte thënë për të që është një ndër nxënësit më të mirë që kishte për nga gjenerata e djemve, për këtë arsye e kishin pasur një lidhje të fortë mes vete. Ndoshta kjo besnikëri dhe dashuri mes tyre, e ka bërë që Mulla Veselin t'i trashëgonte një përgjegjësi të tillë vetëm atij që është besnik dhe që i besonte më shumë. Pas shpërnguljes së Mulla Veselit në Maqedoni, dhe pas ndarjes së cilën nuk mund ta përballonte në ato kohë relacioni i tyre nxënës-mësues, edhe më tej Mulla Qamili shkonte dhe e vizitonte Mulla Veselin çdo dy javë në Shkup.

Mulla Qamili vazhdoi të shërbente si mirëmbajtës i xhamisë për tridhjetë vite, si në mirëmbajtjen e Xhamisë së Vojnocit, pastaj në ndërtimin e saj, mbajtjen e financave, mbledhjen, grumbullimin, rregullimin dhe mbarëvajtjen e jetës fetare në xhami, si dhe në punët e tjera në lidhje me Xhaminë e Vojnocit. Po ashtu, nuk është bërë asnjë mevlud në fshatin Vojnoc, por edhe në fshatrat përreth që nuk ka qenë prezent, ngase e pëlqente mevludin dhe e kishte bërë traditë që sidomos për lindjen e Muhamedit a.s. të ishte pjesëmarrës, madje çdo viti kishte kënduar mevlud një herë në muaj. Mevludin që e kishte, ishte i shkruar në arabisht, porse e kishte mësuar përmendësh. Ata të cilët e njohën kishin një respekt dhe vlerësim të veçantë për të, ku një prej atyre që kishte një vlerësim të madh ishte Ejup Mehmeti, i cili ishte xhematli në Xhaminë e Vojnocit dhe që i kishte ndihmuar ta këndonin së bashku mevludin me Mulla Qamilin. Ky kishte thënë për mulla Qamilin se: “U kanë mikpritës, ku ka pas raste të tilla ku kishte ba konak për net me radhë njerëz të ndryshëm, deri sa ata kanë pushu, janë ushqy dhe masanej kanë vazhu deri ku kanë pas punë, se Mulla Qamili e ka pas odën përsëj rrugës e i donte e i çmonte shumë musafirët, bile edhe çdo njeri të huj që ishte kalimtar rasti.”¹¹ Pas keqësimit të gjendjes së tij, në moshë të shtyrë dhe i shoqëruar me Kuranin edhe në ditët e fundit të kësaj bote, i ndjeri mulla Qamil Mehmeti ia dorëzoi shpirtin Krijuesit të tij në nëntor të vitit 2006.¹²

Zoti e pastë mëshiruar!

1 Intervistë me Ismajl Mehmetin, Vojnoc, 23 janar 2023.

2 Intervistë me Idriz Mehmetin, Vojnoc, 15 dhjetor 2022.

3 Citon Adem Shabani, banor i fshatit Vojnoc, 18 janar 2023.

4 Tregon haxhi Shefqet Jashari, banor i Vojnocit, prill, 2018.

5 Tregon haxhi Abdullah Fejzullahu, Vojnoc, shtator, 2022.

6 E shënon Buhariu, numër 5027.

7 Intervistë me Ejup Mehmetin, Vojnoc, 18 tetor 2022.

8 Sureja Zumer, ajeti 62.

9 Tregon Ejup Mehmeti, Cit.

10 Intervistë me Ismajl Mehmetin, Cit.

11 Intervistë me Ejup Mehmetin, Cit.

12 Intervistë me Daut Mehmetin, Cit.

Në kujtim të mualimit tim, Hafëz Maksut ef. Spahiut (1910-1989)

Faik Miftari

Hafëz Maksut ef. Spahiu ishte pedant, elegant, i veshur me rregull, me sarëkun (shallin) dhe xhyben, të cilat i mbante pa ia nda. Ka qenë hafëz i fortë me një memorie të jashtëzakonshme të leximit të Kuranit.


Gjatë viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, nëpër xhamitë e Prizrenit, rregullisht organizohej dhe mbahej mësim-besimi fetar islam. Një organizim i tillë, ku më shumë e ku më pak, varësisht prej përkushtimit të imamëve në fshatra, si dhe rrethanave objektive dhe subjektive në atë kohë, mbahej edhe nëpër xhamitë e fshatrave të Prizrenit.

Themi varësisht prej rrethanave dhe kushteve të kohës, sepse, sikurse dihet, ndonëse vitet e '70-ta të shekullit të kaluar gjatë pushtetit të atëhershëm komunist, ishin sidokudo më të përbalueshme për sa i përket ushtrimit të ibadeteve fetare islame, krahasuar me vitet e fillimit të pushtetit komunist (1945-1970).

Krahas mësimave laike në shkollë fillore, po nga ky vit, përgjatë pushimeve verore, për vite me radhë kam ndjekur edhe mësimin fetar në xhaminë e Gazi Mehmed Pashës (Bajraklisë), te mualimi (mësuesi i fesë) i dashur, hafëz Maksut efendi Spahiu (shpirti i tij rahmet pastë!).

Mualimi im, hafëz Maksut ef. Spahiu ka qenë një punonjës i palodhshëm, i cili i ka dashur shumë fëmijët, dhe me gjithë angazhimin e tij si imam në xhaminë e Qatib Sinanit në qytet, me vullnet të plotë dhe pa asnjë metelik, përgjatë pushimeve verore dhe dimërore, mbante rregullisht mësim-besimin fetar në xhaminë e Bajraklisë.

Mësuesi im i mësim besimit, hafëz Maksut ef. Spahiu ishte pedant, elegant, i veshur me rregull, me sarëkun (shallin) dhe xhyben, të cilat i mbante pa ia nda. Ka qenë hafëz i fortë me një memorie të jashtëzakonshme të leximit të Kuranit. Ndonëse nuk kishte



mekam (zë) të theksuar, ai konsiderohej si një ndër hafëzët më të fortë të qytetit të Prizrenit dhe më gjerë. Në vitet e shtatëdhjeta, gjatë muajit të bekuar Ramazan, së bashku me hafëz Abdullah ef. Sagdanin (1912-1991) lexonin rregullisht mukabele para namazit të ikindisë në xhaminë e Bajraklisë. Hafëz Maksut efendiu, çmohej edhe për kaligrafinë e tij të bukur e të veçantë, dhe se nuk kishte shkrim me alfabetin arab të cilin nuk mund ta deshifronte e ta lexonte.

Hafëz Maksut efendiu, përveç që na ka mësuar shartet e imanit, islamit, abdesit, etj. dhe njohuritë e tjera themelore të fesë islame, ai na ka mësuar edhe leximin e shkronjave të Kuranit, gjegjësisht shkronjat e alfabetit arab. Edhe sot e kësaj dite shehadezin (Dëshminë se Allahu është Një, dhe Pejgamberi Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij), si dhe të gjitha duatë dhe lutjet që i di, na i ka mësuar ai, dhe të cilat sot e kësaj dite i mbajë në mend.

E veçanta e tij ishte se pyetjet i bënte aty për aty dhe pa paralajmërim të përsëritjes së leximit, mësimit përmendsh të duave dhe lutjeve që i mësonim dhe i përsëritnim pa ndonjë problem të theksuar.

Talebet (nxënësit) e mësim besimit fetar me mualimin (mësuesin) e tyre, hafëz Maksut ef. Spahiun, në oborrin e xhamisë së Bajraklisë (Foto e viteve 1970)

Gjatë kohës sa kemi ndjekur mësim-besimin në mejtepe te hafëz Maksut efendiu, nuk kemi pasur libra të veçantë për mësimin e shkronjave të Kuranit, gjegjësisht të shkronjave të alfabetit arab. Mualimi ynë i dashur, hafëz Maksut efendiu për çdo ditë që vijonim mësim-besimin, na i shënonte nga dy rreshta në fletoret tona, të cilët rreshta ne i mësonim dhe të nesërmen i lexonim dhe i përsëritnim para tij, gjersa përfundonim shkronjat dhe fjali të shkurta leximi me rrokje dhe pas përfundimit të tyre kalonim në leximin e Kuranit fisnik.

Ka pasur vite kur gjatë pushimeve verore mësimin në mejtepin e xhamisë së Bajraklisë te mësuesi hafëz Maksut efendiu, e vijonin edhe gjer në 100 talebe (nxënës). Në ditët kur numri i nxënësve ishte më i ulët, mualimi ynë i dashur mbetej i dëshpëruar dhe i dilnit lotët për shkak të mos vijimit të rregullt të nxënësve. Kur ishim më pak nxënës, mësimin e mbanim në sallën që gjendej në përdhese të objektit të vjetër të vakëfit - sot zyrat e Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit.

Edhe gjatë pushimeve dimërore, hafëzi ynë i dashur, mbante mësim-besim, porse për shkak të motit të ftohtë, frekuentimi i nxënësve ishte shumë i vogël, dhe se zakonisht në këtë periudhë kohore mësimin e vijonin vetëm ata nxënës që kishin hyrë në leximin e Kurani kerimit.

Këto ishin vetëm disa nga kujtimet e mia, plot 50 vjet (gjysmë shekulli) më parë, nga vijimi i mësim-besimit te

Hafëz Maksut efendiu për çdo ditë që vijonim mësim-besimin, na i shënonte nga dy rreshta në fletoret tona, të cilët rreshta ne i mësonim dhe të nesërmen i lexonim dhe i përsëritnim para tij, gjersa përfundonim shkronjat dhe fjali të shkurta leximi me rrokje dhe pas përfundimit të tyre kalonim në leximin e Kuranit fisnik.

mualimi (mësuesi) im i dashur, hafëz Makut ef. Spahi. Do ta mbaj mend përherë gjersa të jem gjallë, dhe i jam falënderues nga zemra për të gjitha mësimet që i kam marrë prej tij. Zoti e shpërbleftë dhe e gradoftë me Xhenetin Firdevs!

BIOGRAFIA E HAFËZ MAKSUT EF. SPAHIUT

U lind në vitin 1910, nga babai Ymer dhe nëna Gjylnaze. Ka kryer medresenë e Gazi Mehmed Pashës në Prizren së bashku me ish-myftiun e Prizrenit, hafëz Safet ef. Bashën (1920-1987). Në fillim, detyrën e imamit e ka ushtruar një kohë në fshatin Lubizhdë, për namazin e xhumasë, më pas kaloi me shërbim si imam në fshatin Piranë, ku qëndroi për një kohë të shkurtër. Më pas kthehet në qytetin e Prizrenit për të shërbyer si imam. Në fillim caktohet në detyrën e imamit në xhaminë e Haxhi Ramadanit (Qorr Agës), për t'u transferuar më tutje në xhaminë e Qatip Sinanit (Levishës), ku ka shërbyer imam prej vitit 1960 e deri në vitin 1982, kur doli në pension.

Hafëz Maksut Spahi. nderohej, çmohej, respektohej nga xhemati i tij dhe qytetarët e gjerë të Prizrenit, sepse karakterizohej me natyrë të qetë, i heshtur. Ishte hafëz i fortë dhe një ekspert i rrallë i kaligrafisë arabe. Përveç gjuhëve orientale (arabe, turke dhe perse) njihnte edhe gjuhën frënge.

Hafëz Maksut ef. Spahi. ndërroi jetë dhe kaloi në Ahiret, në fund të muajit maj, në vitin 1989, në moshën 79 vjeçare. U varros me nderime të larta fetare dhe qytetare në varrezat Kuriçeshme të qytetit tonë të bukur të Prizrenit.

Në kujtim të tij, në krye të këtij përvjetori të 50-të të takimit me mësuesin-mualimin tim të mësim-besimit fetar, bëj dua për shpirtin e tij të ndritur, me shpresë dhe lutje që Allahu i Plotfuqishëm ta shpërblejë me Xhenetin Firdevs! (Qershor, 2023)



Të veshur me ihram

(REPORTAZH NGA HAXHI 2023)

Bajram Zeqiri

Të veshur me ihram, me petkun që tregon devotshmërinë dhe thjeshtësinë, haxhilerët tanë, mëngjesi i së shtunës së 17 qershorit, i gjeti në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë. Të emocionuar po merrnin rrugën më të mirë të jetës së tyre, rrugëtimin jetësor për ta kryer njërën nga pesë obligimet e fesë islame – haxhin. Ashtu siç është bërë traditë, në përcjellje të tyre kishin dalë edhe shumë familjarë e miq, që i uronin haxhilerët për rrugëtim të mbarë e për pranim të ibadeteve. Në përcjellje të tyre kishte dalë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili i uroi haxhilerët me pranim të haxhit dhe për lehtësim të kryerjes së ibadeteve. Në orën 6:45 të mëngjesit, aeroplani me grupin e parë të haxhilerëve u nis drejt Xhides. Në fillim të udhëtimit u bë edhe dua ja e udhëtimit, e më pas, me të arritur në mikat (vendveshjen e ihrameve), nga udhëheqësit e grupeve të haxhilerëve, u kërkuar edhe bërja e nijetit për ta kryer umren. Rreth orës 12, me kohën lokale të Arabisë Saudite, aeroplani i parë arriti në aeroportin e Xhides. Në pritje të haxhilerëve kishin dalë

udhëheqësit e Drejtorisë së Haxhit nga Bashkësia Islame e Kosovës, të cilët në mënyrë të organizuar, me autobusë, i nisën haxhilerët drejt Mekës për t'i akomoduar ata në hotelin “Akhyar al mahbas”. Gjatë rrugës haxhilerët tanë vazhdimisht këndonin telbijen, me të cilën dëshmonin përgjigjen ndaj urdhrit të Zotit për ta kryer haxhin. Ata u akomoduan pasdite në hotel, teksa nga Kosova, po atë ditë u nis edhe grupi i dytë, ndërsa të nesërmen dhe të pasnesërmen, më 18 dhe 19 qershor, u nisën edhe grupet e tjera, gjegjësisht edhe katër grupe të tjera, që në total plotësonin gjashtë grupet e parapara me gjithsej 1597 haxhilerë.

Haxhilerët tanë posa arrinin në Meke, menjëherë, në mënyrë të organizuar niseshin drejt Qabesë së bekuar për ta kryer umren dhe për t'u liruar nga ihrami. Emocionet ishin të pa përshkuara, takimi i parë me Qabënë thuajse të zhvendoste në një botë tërësisht tjetër, larg nga hallet dhe brengat e kësaj bote. Pamja e Qabesë të magjepste, ndonëse ishte natë dhe errësirë, bukuria dhe shkëlqesia e saj vezullonte dhe jepte shkëlqim edhe më tepër sesa qindra drita të neonit,





që ishin përreth saj. Çdo gjë rreth kryerjes së umres ishte e organizuar mirë. Udhëheqësit e grupeve të haxhilerëve kohë pas kohe shpjegonin edhe detaje nga mënyra e kryerjes, për duatë që duhej të bëheshin, por edhe për historikun e Qabesë. Pas kryerjes së tavafit, ishte koha për faljen e dy rekateve pas Mekami Ibrahimit, e më pas për të vazhduar me shtatë ecjet ndërmjet kodrave Safa dhe Merve. Pas ecjes së shtatë, haxhilerët shkurtonin flokët dhe në këtë mënyrë përfundonte edhe kryerja e umres. Këto rituale, në mënyrë të organizuar, i kryenin të gjithë haxhilerët.

Gjatë qëndrimit në Meke, haxhilerët tanë kishin mundësi të dëgjonin nga një ligjëratë të shkurtër me tematikë rreth haxhit, pas namazit të drekës, në xhaminë e hotelit, e cila mbahej nga hoxhallarët tanë.

Këtë vit nga Kosova haxhiu më i ri ishte 13-vjeçari, Ejmen Ajvazi nga Prizreni, i cili ndonëse kishte vizituar edhe më parë Qabënë, tregonte se emocionet e haxhit janë tërësisht ndryshe nga ato që i kishte përjetuar më parë. Ai kishte udhëtuar për ta kryer haxhin me dy prindërit dhe me vëllain e tij, Tarikun, i cili ishte 16 vjeç. Edhe Hava Brahimi nga Mitrovica, tregon me emocione dëshirën dhe vullnetin e kamotshtëm që kishte për ta kryer haxhin. Ajo me lot në sy, shprehte mërzinë që kishte gjatë tri vjetëve që fundit, ku iu kishte pamundësuar vizita e Qabesë, dy vitet e para për shkak të pandemisë, e të tretin për shkakun se kishte mbushur 69 vjet. “Në jetën time nuk kam pasur gëzim më të madh, e as nuk kërkoj të kem gëzim më të madh se ky...” – shprehej Hava për takimin e parë me Qabënë.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Mekë, haxhilerët tanë, herë në mënyrë të organizuar e herë veç e veç, vizitonin Qabënë dhe falnin namazet aty, por edhe kryenin ndonjë umre vullnetare.

Pjesë e këtyre ishte edhe nënë Fahrija, e cila kishte një histori të veçantë. Ajo rriti dhe edukoi dëshmoren e këtij vendi, Xhevë Lladrovcin. Ajo kishte ardhur këtu me të bijën, e për përjetimet e saj, ajo u shpreh: “Nuk kam fjalë me i përshkrua ndjenjat e mia. Falënderoj Zotin e Madhëruar që ma mundësojë të jem në këtë vend të bekuar, të marrë ajër në këtë vend, e të shkeli aty ku shkeli këmba e Pejgamberit a.s.. Kur e pash Qabënë për herë të parë e kur iu afrova Mekami Ibrahimit, mu duk se jam duke fluturuar dhe se nuk jam duke ecur në tokë.”

Në haxh mblidhen njerëz me karakteristika të ndryshme, ndër ta ishin edhe binjakët monozigotë, Behar dhe Sehar Mehmeti, të cilët kishin ardhur së bashku me gratë e tyre, binjaket, Qeseren dhe Haxheren. Aq të ngjashëm që ishin këta, sa që rreth ardhjes për ta kryer haxhin, Behari u shpreh: “Ishte ide e imja për ta bërë së bashku udhëtimin jetësor, por ishte koincidence, që në momentin që desha ta telefonoja vëllain, Seharin, që jeton jashtë vendit, telefoni im cingëroi me thirrjen e Seharit, që shprehu dëshirën e tij për të shkuar së bashku në haxh.”

Për shëndetin e haxhilerëve kujdesej ekipi mjekësor, i angazhuar nga BIK-u, i cili ishte në shërbim të tyre 24 orë. Pjesë e itinerarit gjatë qëndrimit në Meke ishte edhe vizita e shpellës Hira dhe shpellës Theur, ku haxhilerët tanë njiheshin me historikun dhe rëndësinë e këtyre dy vendeve.

Për ditën kryesore të haxhit, Ditën e Arafatit, kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, tha se janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura, dhe tha se gjithçka është gati për t'i pritur haxhilerët tanë. Të martën, më 27 qershor, haxhilerët tanë së bashku me miliona haxhilerë të tjerë, po qëndronin në Arafat, për ta plotësuar kështu njërën ndër kushtet themelore të haxhit.



“Haxhi është Arafat” (Muhamedi a.s.). Namazi i drekës dhe ai i ikindisë u falën të bashkuar në kohë, e pas tyre u mbajt edhe një ligjëratë për vlerën e kësaj dite, e më pas u bë edhe dua e haxhit. Lutjet për ditë të mira, kërkimfalja për gjynahet e bëra dhe pendimi për të kaluarën gjenin vend në gojën dhe zemrën e çdo haxhiu. “E lus Zotin që të ma kthej shikimin...” – ishte një nga lutjet që bënte vazhdimisht Hajrullah Kutllovci, i cili kishte dobësim në të pamë. Atë e shoqëronte vazhdimisht djali i tij, Burhani, i cili tha se qëndrimi këtu na ka bërë edhe më të afërt me njëri-tjetrin. Orët e minutat e kësaj dite dukej se ecnin më shpejt sesa ditët e tjera, e kjo ditë zgjati shumë pak, në krahasim me duatë që kishin haxhilerët tanë. Pas perëndimit të diellit, ata u nisën drejt Muzdelifes, një vend ku do ta kalonin natën në qiellin e hapur. Me të arritur aty, ata falën të bashkuar namazin e akshamit dhe të jacisë, për t’i lënë më pas kohë mbledhjes së guralecëve, me të cilët, në tri ditët e Bajramit, simbolikisht do ta gjuanin shejtanin e mallkuar. Ndonëse kushtet ishin minimale për të pushuar, Muzdelifeja ishte një vend që të pushonte trupi në të, mendja çlodhej, e goja me zemrën plot bënte vazhdimisht dua. Pas faljes së namazit të sabahut, në ditën e Kurban Bajramit, haxhilerët tanë tok të bashkuar u nisën drejt Minas, e prej aty, duke kënduar telbije e tekbire, shkuan në Xhemerate për t’i hedhur 7 gurët e parë. Pas kësaj, ata u kthyen në hotel, u liruan nga ihrami dhe festuan e uruan njëri-tjetrin për Bajram dhe për haxh të pranuar. Në mbrëmje, ashtu të organizuar, ata kryen edhe tavafin e haxhit. Ndërkaq, ditën e dytë dhe të tretë të Bajramit, ata vizituan prapë Xhemeratet dhe gjuajtën edhe 42 gurët e tjerë, gjegjësisht 21 në ditën e dytë dhe 21 të tjerë në ditën e tretë.

1 korriku shënonte edhe ditën e fundit të qëndrimit në Mekë, kështu që haxhilerëve tani iu erdhi koha edhe që të përshëndeteshin me Qabenë. Të mërzitur që po ndaheshin



nga ajo, shumë prej tyre i thanë vetëm “Mirupafshim!”, ngase zemra nuk duronte dot t’i thuhej asaj “Lamtumirë!” Duke lutur Zotin që të na i ketë pranuar haxhin dhe adhurimet e tjera, ne u përshëndetëm me Qabenë, për të vazhduar rrugëtimin tonë drejt qytetit të bekuar, drejt Medinës së ndritshme, aty ku pushon trupi i Pejgamberit a.s..

Më 2 korrik, të gjithë haxhilerët arritën në Medine. Edhe këtu, zemra plot mall dhe emocione, mezi priste të shkonte e ta takonte atë, t’i jepte selame e ta përshëndete, t’i kërkonte shefatin atij, e t’ia përtërinte edhe njëherë besën para tij. Zor se mund të përshkruheshin ndjenjat kur gjendeshe para varrit të tij, sikur e gjalla dhe e vdekura bëhen bashkë për t’i dhënë edhe më shumë kuptim kësaj jete, e për ta dashur edhe më shumë vdekjen për takimin me të a.s..

Gjatë qëndrimit në Medine, haxhilerët vizituan vendet historike të saj, kodrën e Uhudit, Xhaminë e Dy Kibleve, Xhaminë e Kubasë, vendin e betejës së Hendekut, varrezat Baki, aty ku janë të varrosur edhe shumë sahabë, si dhe vende të tjera të rëndësishme.

Edhe ditëve të qëndrimit në Medine iu erdhi fundi, kështu që edhe këtu, përshëndetja (selami) e fundit për Pejgamberin a.s. qe e vështirë, por çdo gjë e kësaj bote ka një përfundim, kështu që erdhi koha që duhej të ktheheshim në Kosovë, gjithnjë duke u lutur që Zoti të na i ketë pranuar këto ibadete. Kështu që, më 10 korrik, grupi i parë i haxhilerëve veçse arriti në Kosovë, ndërkaq më 11 dhe 12 korrik, arritën edhe grupet e tjera.

Lusim Zotin e Madhëruar që haxhilerëve t’ua ketë pranuar haxhin dhe të gjitha ibadetet që i kanë kryer!



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E FRANCËS, Z. OLIVIER GUÉROT

Më 11 korrik 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, z. Olivier Guérot. Ai fillimisht i uroi mirëseardhje ambasadorit në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilit edhe i dëshiroi punë të mbarë dhe të suksesshme në Kosovë. Myftiu Tërnavë më pas e njohu ambasadorin me funksionimin dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet institucioni i BIK-ut. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar për një mirëqenie për të gjithë qytetarët pa dallim, duke shprehur kështu rolin e saj në proceset në të cilat ka kaluar vendi ynë përgjatë dekadave. “Ne si institucion mbetemi të përkushtuar për një mirëqenie për të gjithë pa dallim.

Populli ynë dhe besimtarët tanë kanë vlera dhe virtyte të larta, e ndër to është edhe toleranca dhe mirëkuptimi ndërfetar dhe ndëretnik, me të cilat ne krenohemi para botës mbarë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Nga ana e

tij, ambasadori z. Olivier Guérot, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke e përgëzuar atë dhe institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kontributin e dhënë përgjatë viteve në Kosovë.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMË NGA DIASPORA

Më 9 dhe 25 korrik 2023, drejtori i Diasporës në BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, priti në takime të ndara imamët Besnik ef. Kadriollin, imam në xhaminë “Nurul-Islam” në Mönchengladbach të Gjermanisë, Sabri ef. Jonuzin, imam në QShFK-Oslo të Norvegjisë dhe Mehdi ef. Kastratin, imam në BKFSH - Kristiansand, Norvegji.

Në këto takime miqësore u diskutua për gjendjen e xhamive shqiptare në diasporë dhe për bashkëpunimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe të punëve me xhamtin e atjeshëm.

Me këtë rast, Drejtori për Diasporë shprehu falënderime për imamët dhe për qendrat Shqiptare Fetare në Diasporë, që pa kursyer asnjëherë kanë ofruar dhe ende po ofrojnë ndihmë për Kosovën.

Që të dyja palët ranë dakord që të vazhdohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve për të mirën e të gjithëve.



DEPARTAMENTI I GRUAS PËRFUNDOI TRAJNIMET ME MUALIMET

Më 13 korrik 2023, Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ka përfunduar trajnimet e organizuara për avancimin e punës praktike të mualimeve në mësim-besim dhe përmbushjen e nevojave të tyre në këtë fushë.

Gjatë këtyre trajnimeve janë zhvilluar katër module: Vizioni për mësim-besim, Roli dhe detyrat e mualimes, Thirrje individuale dhe Hapja ndaj shoqërisë, të cilat janë ligjëruar nga trajneri Bashkim Mehani. Përveç ligjërimit, është punuar edhe në grupe, ku mualimet kishin mundësi të prezantonin punime të ndryshme lidhur me temat e trajtuara. Udhëheqësja e Departamentit të Gruas, Vaxhide Bunjaku, tha se këto trajnime



ishin të nevojshme dhe shumë efektive. Sipas saj edhe mualimet u ndanë të kënaqura sepse përfituan shumë njohuri e metoda praktike për zhvillimin e mësimi. “Përmes këtyre trajnimeve mualimet patën mundësi të marrin njohuri shtesë dhe të përdorin

metoda efikase për formimin e gjeneratave më edukative dhe më me vlera”, tha ndër të tjera Bunjaku.

Pjesëmarrëse të këtij trajnimi ishin rreth 150 mualime zyrtare të BIK-ut dhe mualime vullnetare.

U MBAJT PANELI “15 KORRIKU, NATA QË FRYMËZOI BOTËN”

Më 21 korrik 2023, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Ambasada e Turqisë në Kosovë organizuan një panel të veçantë me temë “15 korriku nata që frymëzoi botën”. Në këtë ngjarje morën pjesë deputetë, përfaqësues të lartë të kësaj shoqate, si dhe mysafirë të shumtë nga të dy vendet.

Në panel u theksua miqësia e ngushtë midis Kosovës dhe Turqisë, dhe rëndësia e bashkëpunimit që pagja të mbizotërojë në gjithë botën, njëkohësisht që feja islame të mos keqpërdoret për interesa të caktuara. Deputetja në Parlamentin e Turqisë, Ümmügülşen Öztürk, kryetari i shoqatës “15 Korriku”, Ismail Hakki Turun si dhe personalitete të tjera theksuan nevojën për paqe dhe siguri. Gjatë këtij aktiviteti u shfaq edhe një video për tentimin e grushtshtetit në Turqi, si dhe u bë lutje për dëshmorët e 15 korrikut.



DHUROHEN 6 ARI TRUALL VAKËF PËR KËSHILLIN E BI-SË SË MALISHEVËS



Këshillit të Bashkësisë Islame të Malishevës i është shtuar edhe një truall prej 5.95 ari vakëf, të cilën e dhuruan djemtë e Tahir Ali Bytyçit. Ata u shprehën tejte të lumtur që Zoti ua mundësoi që ta ndjekin rrugën e babait të tyre, duke u bërë kështu pjesë e karvanit të vakëflënësve. Trualli i cili u dhurua gjendet në fshatin Shkozë. Ndërkaq, kryetari i Këshillit të BI-së së Malishevës, Sead ef. Paqarizi, falënderoi vakëflënësit, duke lutur Allahun xh.sh. që t’ua shtojë të mirat dhe t’i shpërblejë në këtë dhe botën tjetër.



REAGIM

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, me shqetësim po përcjell disa prej lajmeve të fundit, ku disa qytetarë raportuan të jenë mashtruar, duke blerë produkte të ndryshme me çmim më të lartë, me qëllim për të ndihmuar familjet me kushte të rënda ekonomike.

Mes të tjerash, bazuar në raportimet e mediave në Kosovë, shoqata dhe individ të caktuar po e keqpërdorin edhe emrin e “Bereqetit” i cili funksionon në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, për çka, ne si shoqatë nuk kemi të bëjmë agjë me këto iniciativa dhe as nuk kemi bashkëpunuar asnjëherë me manipulues të tillë. “Bereqeti” ka koordinatorët e saj në gjithë Kosovën, në secilën komunë, të cilët mund të orjentojnë bamirësit, e po ashtu edhe përmes imamëve të xhamive.

“Bereqeti” edhe kësaj radhe ju bënë thirrje që të keni kujdes me pasurinë tuaj dhe mënyrë se si vendosni t’i ndihmoni të tjerët!

Ju lutemi për kujdes të shtuar, në mënyrë që mos të bini pre e mashtrimeve të tilla!

Mënyra më e mirë dhe më e sigurt për të ndihmuar nevojtarët është përmes degëve zyrtare të shoqatës “Bereqeti”.

Drejtorja e Bereqetit



PËRKUJTIMI I GJENOCIDIT NË SREBRENICË

Më 11 korrik, nën organizimin e Shoqërisë Kulturore e Artistike “Šarski behar”, në Prizren, është organizuar “Marshi i paqes” për Srebrenicën.

Dhjetra pjesëmarrës, në mesin e të cilave edhe kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren, Besim ef. Berisha, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile, të konzullatës dhe KFOR-it turk në Prizren, morën pjesë në marshin paqësor, i cili u mbajt nga Lidhja e Prizrenit deri te Key i Shadërvanit, afër xhamisë së Sinan Pashës.

Në emër të organizatorëve, të pranishmit i përshëndeti Edis Mustafić, kurse Azmir Jusufi mbajti fjalimin hyrës, ku ndër tjerash tha: “Më 11 korrik të vitit 1995 ndodhi gjenocidi në Srebrenicë. Gjykata ndërkombëtare në Hagë, në vitin 2007 nxori Aktgjykim me të cilin masakrën në Srebrenicë, ku janë masakruar e vrarë mbi 8 mijë persona, e kualifikoi si akt gjenocidi. Ky gjenocid ndodhi para syve të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe nën pretendimin e një zone të mbrojtur. Megjithatë, e njëjta bashkësi ndërkombëtare është ende e prirur në mënyrë të padrejtë ndaj boshnjakëve dhe shqiptarëve dhe shteteve të tyre, Bosnje e Hercegovinës dhe Kosovës. Ky gjenocid është planifikuar në nivelet më të larta politike dhe ushtarake të qeverisë së atëhershme serbe, të cilët kishin mbështetjen e institucioneve fetare dhe të udhëheqësve, dhe të gjitha materialet, mediat, burimet njerëzore, ushtarake dhe burimet e tjera u mobilizuan për ta realizuar atë. Megjithatë, përkundër gjithçkaje që është bërë, gjenocidi i kryer mohohet në të gjitha mënyrat e mundshme.” Po ashtu, Jusufi përmendi edhe masakrat e krimet serbe në Kosovë, ku ndër tjerash tha: “Prej fillimit të luftës në Kosovë, e deri në përfundimin e saj, shteti serb përmes të gjitha forcave ushtarake e policore, përpos që zbatoi politikën e “tokës së



djegur”, nuk kurseu as pleq, plaka, gra, fëmijë; me një fjalë, nuk kursente asgjë nga popullata civile e paarmatosur. Janë të tmerrshme masakrat që i ka zhvilluar Serbia kundër shqiptarëve në Kosovë. Kjo do të tregojë më së miri në përshkrimin e secilës nga këto masakra, sa që për çdo masakër do të duhej shteti i Kosovës të inkurajonte njerëzit e vullnetit të mirë që të shkruajnë libra të veçantë për secilën nga këto masakra, pastaj edhe që të përktheheshin në gjuhët e huaja me qëllim të plasimit të së vërtetës. Sipas një studimi të përbashkët të kryer në vitin 2008 nga Qendra Ligjore Humanitare dhe Komisioni Ndërkombëtar i Njerëzve të Humbur, gjatë luftës në Kosovë u vranë 13.421 persona. Nga ky numër, 10.533 ishin shqiptarë, 2.238 serbë, 126 romë, 100 boshnjakë dhe të tjerë.”

Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ndër tjerash tha: “Sot përkujtojmë përvjetorin e 28-të të gjenocidit që ka ndodhur në zemër të Evropës, i cili për fat të keq nuk është gjykuar sa duhet. Shumë njerëz të pafajshëm humbën jetën, familje të tëra, të rinj. Është një veprim kriminal i ushtrisë serbe të asaj kohe. Apeloj te të gjithë shkrimtarët, të

mbledhin argumente, të shkruajnë, të dokumentojnë, në mënyrë që një veprim i tillë nuk mos të harrohet dhe kurrë më mos të përsëritet në këto trevat tona dhe askund tjetër në botë.”

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren, Besim ef. Berisha, ndër tjerash tha: “Sot edhe një herë jemi mbledhur në zemër të Prizrenit për t’i kujtuar viktimat e gjenocidit serb në Srebrenicë. Gjeneratave të reja t’ua mësojmë agresorin e vërtetë, t’ua mësojmë historinë reale dhe armikun kryesor tonin, serbin. Nuk dua me zgjat aspak ma tepër veç se me ju porosit për unitet dhe vëllazëllëk, gjithashtu me lut Allahun për të gjithë viktimat e Srebrenicës dhe Kosovës. Ishim, jemi dhe do të jemi pranë dhe me vëllezërit tanë boshnjak.”

Konsulli i Turqisë në Kosovë, Celal Doan, tha se: “Si shtet i kemi mallkuar ata gjithmonë, dhe vazhdojmë t’i mallkojmë. Fatkeqësisht, kjo masakër e realizuar mu në mes të Evropës, është e ngur thellësisht tonë. Një prej arsyeve që jemi këtu është që të mos përsëriten më masakra të tilla asnjëherë.

Azmir Jusufi

FOTOALBUM NGA HAXHI 2023





HIXHRETI I PEJGAMBERIT, A.S.

*Trembëdhjetë vjet tortura e mizori,
përshkoi Pejgamberi me sahabët e tij.
Por drita e besimit kurrë nuk u venit,
nji agim i ri rrinte duke prit...*

*Me emën të Allahut dita e re agoi,
rruga drejt fitores e sigurt filloi.
Nji adresë e re Pejgamberit iu dha,
të shkonte në Jethrib, atij iu tha.
Meken e dashur me mall e la.*

*Në shoqni të tij, ishte Ebu Bekiri,
që ndër sahabët ishte ma i miri.*

*Për në mirësi rrugën e shtroi,
fiset Aus e Hasrexh i pajtoi...
Pas shumë mundimeve në Jethrib arritën,
ku nga besimtarët me mall u pritën,
Lugina e male me të madhe ushtuan,
mirëseardhjen Pejgamberit ia uruan.*

*Prania e Pejgamberit ditë të re shënoi,
themelet e së ardhmes aty i ndërtoi.*

*Emri Jethrib mori emër të ri,
Medina e ndriçume u ba emri i tij.
Kalendar të ri iu dha ymetit,
filloi me ditën spikatse të Hixhretit.*

*Rrezet e Islamit u përhapën anembanë,
shpresë të re njerëzimit i dhanë.*

*Pejgamberi me shpirtin e vetëmohimit,
model të ri i dha njerëzimit.
Për ymetin e mbarë njerëzimin asht fener,
gjithmonë do të ndriçojë, s'do të shuhet asnjëherë!*

*Burhan Fili
Tiranë, 27.07.2023*



DITURIA ISLAME • Nr. 393 GUSHT 2023